



Bruksel, 8.10.2014
SWD(2014) 306 final

DOKUMENT PUNE I PERSONELIT TË KOMISIONIT

RAPORTI I PROGRESIT 2014 PËR KOSOVËN*

Në përcjellje të dokumentit

**KOMUNIKATA NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN
EVROPIAN, KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE
KOMITETIN E RAJONEVE**

Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2014-2015

{ COM(2014) 700 final }

* Ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e KS- të OKB-së 1244/199 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	Hyrje	3
1.1.	Parathënie.....	3
1.1.	Konteksti	3
1.2.	Marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës	3
1.3.	Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.....	5
2.	Kriteri Politik	6
2.1.	Demokracia dhe sundimi i ligjit.....	6
2.2.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	17
2.3.	Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare.....	23
3.	Kriteret Ekonomike	24
3.1.	Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut	25
3.2.	Kapaciteti për tu përballuar me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian	36
4.	Standardet Evropiane	37
4.1.	Tregu i brendshëm.....	37
4.1.1.	Lëvizja e lirë e mallrave	37
4.1.2.	Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit	38
4.1.3.	Lëvizja e lirë e kapitalit	39
4.1.4.	Doganat dhe tatimet	40
4.1.5.	Konkurrenca	41
4.1.6.	Prokurimi publik	42
4.1.7.	Ligji i pronësisë intelektuale	43
4.1.8.	Politikat e punësimit dhe ato sociale, politikat e shëndetit publik	43
4.1.9.	Arsimi dhe hulumtimi	44
4.1.10.	Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)	46
4.2.	Politikat sektoriale	47
4.2.1.	Industria dhe NVM-të	47
4.2.2.	Bujqësia dhe peshkataria	47
4.2.3.	Mjedisi dhe ndryshimet klimatike	48
4.2.4.	Politika e transportit	50
4.2.5.	Energjia	51
4.2.6.	Shoqëria Informative dhe media	53
4.2.7.	Kontrolli financiar	54
4.2.8.	Statistikat	54

4.3.	Drejtësia, liria dhe siguria	55
4.3.1.	Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi	55
4.3.2.	Shpëlarja e parave	58
4.3.3.	Droga	58
4.3.4.	Policia	59
4.3.5.	Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit	60
4.3.6.	Mbrojtja e të dhënave personale	61
SHTOJCA STATISTIKORE		63

1. HYRJE

1.1. Parathënie

Komisioni i raporton rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin që janë duke bërë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor drejt integritimit Evropian, duke vlerësuar përpjekjet e tyre për të përmbushur kriteret e Kopenhagës dhe kushtëzimet e Procesit të Stabilizimit Asociimit.

Ky raport i progresit, i cili në masë të madhe ndjek strukturën e njëjtë sikurse në vitet paraqarre:

- Shkurtimeisht përshkruan marrëdhëniet mes Kosovës* dhe Bashkimit Evropian;
- Analizon gjendjen në Kosovë në kontekst të kriterëve politike;
- Analizon gjendjen në Kosovë mbi bazën e kriterëve ekonomike;
- Shqyrton kapacitetin e Kosovës për të zbatuar standardet evropiane, d.m.th për përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave me ato të *acquis*, në përputhje me Procesin e Stabilizimit Asociimit

Ky raport mbulon periudhën nga tetori i vitit 2013 deri në shtator të vitit 2014. Progresi matet në bazë të vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar, si dhe masave të zbatuara. Si rregull, legjislacioni apo masat që janë në përgatitje apo në pritje të miratimit nga parlamenti nuk janë marrë parasysh. Kjo qasje siguron trajtim të barabartë në të gjitha raportet, si dhe mundëson një vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informatat e mbledhura dhe të analizuara nga Komisioni. Janë përdorur shumë burime tjera, duke përfshirë kontributet nga autoritetet e Kosovës, Shtetet Anëtare të BE-së, Misioni i BE-së për sundim të ligjit (EULEX), raportet e Parlamentit Evropian¹ si dhe informatat nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Komisioni nxjerr konkludime më të detajuara në lidhje me Kosovën në komunikatën e tij të veçantë për zgjerimin² në bazë të analizave teknike që janë paraqitur në këtë raport.

1.1. Konteksti

Deri më sot, Kosova është njohur nga 110 Shtete Anëtare të KB-së, përfshirë këtu 23 Shtete Anëtare të BE-së.

Gjatë periudhës së raportimit, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së ka vazhduar të lëshojë raporte të rregullta mbi zbatimin e misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Ai raportoi mbi progresin e arritur në zbatimin e *marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve* më 19 prill të vitit 2013, zgjedhjet lokale dhe zhvillimet në veri. Ai gjithashtu e mirëpriti vendimin e Këshillit për autorizimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit me Kosovën.

Forca e udhëhequr nga NATO (KFOR) ka vazhduar të ndihmoj në ruajtjen e sigurisë në Kosovë. Gjatë periudhës raportuese, ajo përbëhej nga një personel me rreth 5 000 veta.

1.2. Marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës

Negociatat për **Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA)** ndërmjet BE-së dhe Kosovës kanë filluar në tetor të vitit 2013 dhe përfunduan në maj të vitit 2014. Në korrik të vitit 2014, kryenegociatorët vendosën inicialet në marrëveshjen. Komisioni tani është duke përgatitur propozimet për vendimin e Këshillit për nënshkrimin dhe përfundimin e saj.

* Ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e KS-të OKB-së 1244/199 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

¹ Raportuesja për Kosovë është Znj. Ulrike Lunacek.

² Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2014-2015, COM(2014) 700.

MSA-ja e ardhshme do të jetë një marrëveshje 'vetëm për BE-në'. Elementet e saj kryesore janë rritja e tregtisë mes BE-së dhe Kosovës, obligimi i Kosovës që të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së në një gamë të gjerë të sektorëve dhe mundësinë për të zhvilluar një dialog politik mes BE-së dhe Kosovës. Zhvillimi i tregtisë dhe investimeve si dhe modernizimi i organizimit ligjor dhe institucional janë vendimtarë për ristrukturimin dhe modernizimin ekonomik të Kosovës. MSA-ja e vendosë Kosovën në kursin e marrëdhënieve të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe konfirmon perspektivën evropiane të Kosovës në kontekstin e kriterëve të Kopenhagës të vitit 1993.

Kosova ka vazhduar adresimin e prioritetëve të përcaktuara në raportin e progresit të vitit të kaluar dhe në studimin e fizibilitetit për një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit³. Në veçanti, është shënuar progres në procesin zgjedhor dhe në kërkesat e dialogut për liberalizimin e vizave. Është forcuar roli i Kuvendit dhe kapaciteti i qeverisë që të koordinojë negociatat komplekse të tilla si ato për MSA-në dhe çështjet tregtare. Megjithatë, fushatat elektorale që janë mbajtur gjatë gjithë vitit dhe procesi i ndërlikuar i formimit të qeverisë pas zgjedhjeve të qershorit ka ndikuar në arritjen e progresit në disa fusha.

Përkushtimi i Kosovës ndaj dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe normalizimi i marrëdhënieve me Beogradin ka qenë kyç në avancimin e ambicieve Evropiane. Kosova duhet të vazhdojë të përqendrohet në zbatimin e marrëveshjeve të arritura me Serbinë dhe në progresin në fushat e identifikuar nga studimi i fizibilitetit për të përmbushur obligimet e saj sipas MSA-së.

Në kontekst të **Procesit të Stabilizim Asociimit**, Kosova ka mbetur e angazhuar në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA). Ka vazhduar dialogu i strukturuar mbi sundimin e ligjit. Diskutimet janë fokusuar në ndërhyrjen politike në gjyqësor dhe në ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të Kosovës për marrjen e përgjegjësisë që do të transferohen nga EULEX-i.

Dialogu për **liberalizimin e vizave** ka qenë një nga prioritetet kyçe për Kosovën. Deri më tani, Komisioni ka lëshuar dy raporte mbi përpjekjet e Kosovës në këtë proces (shkurt të vitit 2013 dhe korrik të vitit 2014). Misioni i ekspertëve u mbajt në dhjetor të vitit 2013 dhe në mars të vitit 2014. Takimi i katërt i zyrtarëve të lartë u mbajt në qershor të vitit 2014.

Banka Evropiane për Investime ka diskutuar me qeverinë mbi projektet e investimeve publike. Në vitin 2014, ajo ka lansuar një skemë të granteve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) përmes një banke lokale private. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim mbështet NVM-të e Kosovës përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor. Kosova u bë anëtare e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës në muajin nëntor. Në muajin qershor, Kosova u bë anëtare e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës.

BE-ja ka ofruar **asistencën financiare** për Kosovën përmes Instrumentit të asistencës së Para-anëtarësimit (IPA) 2007-2013, me një alokim total prej 673.9 milion €. Përmes IPA-së në vitin 2013, janë siguruar 38.5 milion € shtesë për të mbështetur dialogun Prishtinë-Beograd, procesin e normalizimit dhe integrimin në Kosovë, duke e përfshirë këtu edhe dialogun e vizave. Sipas IPA II, Kosova do të vazhdojë të përfitojë nga asistencën për para-anëtarësim për vitet 2014-20, me një alokim të përgjithshëm indikativ prej 645.5 milion €. Më 20 gusht, Komisioni miratoi një dokument strategjikë indikativë për vitet 2014-20, i cili u hartua në partneritet me Kosovën dhe në Konsultim me të gjitha palët e interesit. Asistencën e IPA-së do të fokusohet në mbështetjen për sektorët e demokracisë dhe qeverisjes, sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore; konkurrencën dhe inovacionin, arsimin, punësimin dhe politikën sociale, energjinë, si dhe bujqësinë dhe zhvillimin rural. Kosova vazhdon të përfitojë nga asistencën sipas programeve shumë përfutuese dhe rajonale si dhe merr pjesë në tre programe bashkëpunuese ndër-kufitare me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimorë. Zbatimi i IPA-së menaxhohet nga zyra e BE-së në Kosovë.

³ COM(2012) 602 final.

Propozimi i komisionit që të nënshkruhet dhe arrihet marrëveshja kornizë mbi pjesëmarrjen e Kosovës në **programet e BE-së** është në pritje të miratimit nga Këshilli.

Në muajin prill, Kosova u pajtua për zgjatjen e mandatit të EULEX-it deri në qershor të vitit 2016 dhe themelimin e një gjykate speciale. Gjykata do të dëgjojë rastet të cilat dalin nga hetimi i udhëhequr nga Task Forca Huluntuose Speciale (SITF). Sipas mandati të ri të EULEX-it, të gjitha institucionet e sundimit të ligjit udhëhiqen nga zyrtarët e Kosovës. Gjyqtarët e dhe prokurorët e EULEX-it janë të përfshirë në institucionet e Kosovës, ndërsa panelet e përziera, në parim janë kryesisht të përbëra nga gjyqtarët e Kosovës, dhe udhëhiqen nga një gjyqtar i Kosovës. EULEX-i nuk ndërmerr hetime të reja përveç në rrethana të jashtëzakonshme. Gjatë periudhës raportuese, Kosova e ka mbështetur punën e EULEX-it dhe Task Forcës Huluntuose Speciale. Kjo duhet të vazhdojë përmes ndryshimit të legjislacionit kyç duke përfshirë edhe Kushtetutën, në mënyrë që të themelohet gjykata speciale dhe zyra e saj e prokurorisë.

1.3. Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë

Serbia dhe Kosova kanë qenë të angazhuara në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, por progresi është ngadalësuar ndjeshëm që marsi i vitit 2014. Zgjedhjet përgjithshme të parakohshme janë mbajtur në Serbi në muajin mars dhe në Kosovë në muajin qershor. Gjashtë takime të nivelit të lartë të ndjekura nga dy kryeministrat janë mbajtur mes shtatorit të vitit 2013 dhe marsit të vitit 2014. Në nivel teknik, puna ka vazhduar gjatë gjithë periudhës së raportimit.

Si rezultat i punës intensive në muajt e parë të periudhës raportuese, ka pasur progres në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në dialog, veçanërisht sa i përket *‘Marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve’* e arritur në muajin prill të vitit 2013. Për herë të parë, në nëntor të vitit 2013 me lehtësimin e OSBE-së janë mbajtur zgjedhjet lokale në të gjithë Kosovën (dhe janë përsëritur në Mitrovicën e Veriut në muajin shkurt të vitit 2014), dhe për herë të parë janë inauguruar komunat e veriut të Kosovës në përputhje me ligjin e Kosovës. Serbët e Kosovës nga veriu dhe jugu i lumit Ibër kanë marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme në qershor të vitit 2014. Themelimi i Asociacionit/komunitetit të komunave me shumicë serbe është ende në pritje. Është shënuar progres në shpërbërjen e strukturave ilegale Serbe të policisë dhe drejtësisë. Serbia mori masa për të lehtësuar integrimin e policisë dhe gjyqësorit, pas miratimit të një ligji mbi amnistinë nga ana e Kosovës. Integrimi është përfunduar për sa i përket zyrtarëve policorë, ndërsa integrimi i personelit tjetër të Ministrisë Serbe të punëve të brendshme është ende në pritje. Një marrëveshje në parim është arritur për sa i përket gjyqësorit, por finalizimi i dhe zbatimi i saj është ende në pritje. Gjithashtu, në pritje është edhe Integrimi i personelit të mbrojtjes civile.

Progres deri në një masë është arritur edhe në fushat e tjera të rëndësishme. Serbia ka luajtur një rolë konstruktivë në sigurimin e pjesëmarrjes së Kosovës në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore (SEECp) në samitin e Bukureshtit në qershor të vitit 2014. Megjithatë, zbatimi i marrëveshjes mbi përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në forumet rajonale vazhdon të mbetet problematik. Përgatitja për zbatimin e marrëveshjeve mbi energjinë dhe telekomunikacionin, e arritur në shtator të vitit 2013, ka dërguar drejt nënshkrimit të një marrëveshjeje Inter-OST në sektorin e energjisë, së bashku me miratimin e një plani të veprimit në shtator të vitit 2014.

Sa i përket veriut të Kosovës, është krijuar një fond për zhvillim për të mbledhur të ardhurat në pikë kalimet kufitare veriore. Ky fond ka marrë më shumë se 2.9 milion € deri më sot, por bordi mbetet të vendosë për përdorimin e tyre. Zbatimi i marrëveshjeve të lirisë së lëvizjes e ka lejuar përdorimin e dokumenteve të identitetit të Serbisë dhe Kosovës nga banorët për të hyrë dhe dalë, si në Serbi ashtu edhe në Kosovë. Është arritur marrëveshja e cila lejon qytetarët e Kosovës të përdorin dokumentet e tyre të identifikimit për të udhëtuar në vendet e treta përmes Serbisë përmes gjashtë pikë kalimeve kufitare. Vendosija e bllokadave të reja rrugore në anën veriore të urës kryesore të Mitrovicës, në qershor të vitit 2014, ka rritur edhe

më shumë tensionet. Pavarësisht marrëveshjes të arritur nga të dyja palët për nevojën e një zgjidhje të përbashkët, barrikatat e njohura si 'Parku i Paqes' janë ende të vendosura. Byrotë e sigurimit të Kosovës dhe Serbisë kanë përcaktuar parametrat për një marrëveshje komerciale në mbulimin e ndërsjellë të sigurimit të veturave në mesë të Serbisë dhe Kosovës. Ky progres duhet të konfirmohet përmes një marrëveshje me shkrim.

Zbatimi i marrëveshjeve të tjera ka vazhduar, ndonëse me një ritëm më të ngadaltë. Sa i përket MIK-ut, gjashtë pikë kalimet e përbashkëta të përkohshme kanë vazhduar të jenë operacionale si dhe janë arritur marrëveshjet teknike për lokacionet e sakta dhe mbi draft dizajnin e pikë kalimeve të përhershme të MIK-ut. Megjithatë, siç raportohet nga EULEX-i, rrugët ilegale të kalimit/anësore, në veçanti në veri të Kosovës, vazhdojnë të përdoren rregullisht për të kontrabanduar sasi të konsiderueshme të mallrave. Duhet të merren masa shtesë nga Serbia për të ndaluar kalimet ilegale.

Për sa i përket kadastrit, Serbia ka vazhduar të zbatojë pilot-projektin, por legjislacioni i nevojshëm për të zbatuar marrëveshjet është ende në pritje në Kosovë. Kopjimi i librave të regjistrave civil të Kosovës është përfunduar me sukses. Zbatimi i marrëveshjes mbi pranimin e diplomave të universitetit ka pasur rezultate të kufizuara. Certifikimi i diplomave nga Shoqata e Universiteteve Evropiane ka përparuar mirë dhe 387 diplomat janë certifikuar. Megjithatë, Serbia ka pranuar vetëm pesë diploma të vërtetuara deri më tani, pas një procesi shtesë të nostrifikimit. Vendosja e zyrtarëve ndërlidhës ka pasur ndikim të kufizuar.

Serbia ka vazhduar të bashkëpunoj me EULEX-in, sidomos për krimet e luftës, por bashkëpunimi ligjorë në luftën kundër krimit të organizuar duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme. Kritikën për trajtimin nga ana e EULEX-it të disa rasteve kriminale kundër serbëve të Kosovës është kundër-produktive. Autoritetet serbe duhet të përmbahen nga deklaratat të cilat e dëmtojnë sundimin e ligjit. Kosova duhet të vazhdojë bashkëpunimin e mirë me EULEX-in.

Gjykata Kushtetuese e Serbisë ka gjykuar formën në të cilën disa marrëveshje nga dialogu janë transpozuar në mënyrë jo-kushtetuese. Serbia duhet të gjejë zgjidhje ligjore për zbatimin e marrëveshjeve të cilat janë të qëndrueshme në aspektin kohorë dhe nuk janë të ndjeshme ndaj sfidave ligjore.

Në përgjithësi, Serbia dhe Kosova mbeten të angazhuara në dialog dhe të zotuar për zbatimin e marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve e arritur në prill të vitit 2013 dhe marrëveshjeve të tjera të arritura përmes dialogut, duke dërguar kështu në ndryshime të pakthyeshme në terren. Megjithatë, progresi është ngadalësuar. Zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme janë mbajtur në Serbi dhe në Kosovë. Duhet të krijohet një momentum i ri për të trajtuar çështjet kyçe të cilat kanë mbetur dhe të hapim një fazë të re në normalizimin e marrëdhënieve. Progresi në këtë fushë mbetet thelbësor për avancimin e të ardhmes evropiane si për Serbinë ashtu edhe për Kosovën.

2. Kriteri Politik

Ky seksion shqyrton progresin e Kosovës drejt përmbushjes së kriterëve politike të Kopenhagës, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Po ashtu monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore me vendet në zgjerim dhe Shtetet Anëtare dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, të tilla si bashkëpunimi me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

Kushtetuta

Asnjë amandamentim nuk i është bërë Kushtetutës gjatë periudhës së raportimit. Kosova duhet të ndryshoj Kushtetutën e saj që në mënyrë që të pasqyroj zotimet e sajë për themelimin e

gjykatës speciale. Kushtetuta gjithashtu duhet të modifikohet në mënyrë që të sigurojë së shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të zgjedhën nga kolegët e vetë, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Zgjedhjet

Viti i kaluar u shënuar nga zgjedhjet për kryetar komune dhe zgjedhjet komunale në vjeshtë të vitit 2013, si dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare në 8 qershorit të vitit 2014. Për herë të parë zgjedhjet e përgjithshme u mbajtën në tërë Kosovën, duke përfshirë këtu edhe katër komunat veriore.

Zgjedhjet për kryetar të komunës dhe ansamblet komunale janë mbajtur në të gjithë Kosovën dhe sipas ligjeve të Kosovës. Zgjedhjet në veri ishin të lehtësuara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në përputhje me Marrëveshje e parë për parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. Me përjashtim të Kosovës veriore, ku kishte disa incidente që përfshinin edhe dhunën, nuk është raportuar asnjë parregullsi tjetër. Përsëritja e zgjedhjeve ishte e nevojshme në Mitrovicën e Veriut pasi që u gjet se kutitë e votimit ishin shkatërruar. Më 11 janar, anëtarët e kuvendit komunal në katër komunat e veriut i bënë betimet e tyre zyrtare dhe zyrtarisht u themeluan organet komunale. I zgjedhuri për kryetar komune në Mitrovicë të Veriut refuzoi që të bëjë betimin, duke e bërë kështu të nevojshëm përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar komune më 23 shkurt.

Pjesëmarrja e përgjithshme në zgjedhjet për kryetar komune dhe komunale ishte mbi 46% (mbi 45% në zgjedhjet e vitit 2009). Pjesëmarrja e përgjithshme në katër komunat e veriut ishte 25%. Kandidatët nga Iniciativa qytetare Srpska fituan pozitën e kryetarit të komunës në të katër komunat.

Votimi dhe numërimi për zgjedhjet parlamentare ishte transparente dhe i organizuara mirë, duke konsoliduar trendin pozitiv të përcaktuar nga zgjedhjet komunale të vitit 2013. Dita e zgjedhjeve kaloi pa ndonjë incident dhe votuesit ishin në gjendje të votojnë në mënyrë të lirë. Pjesëmarrja ra nga 46% sa ishte në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 në vetëm 42%. Partia Demokratike e Kosovës - PDK mori mbi 30%, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) rreth 25%, Vetëvendosje (VV) mbi 13%, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) mbi 9% si dhe Iniciativa për Kosovën (NISMA) dhe Lista Srpska morën nga 5% secila.

Megjithatë, zgjedhjet e përgjithshme u mbajtën në një afat kohor përgatitore shumë të ngjeshur. Koha e shkurtër përgatitore (30 ditë) ndikoi negativisht në aspekte të caktuara të procesit teknik, siç ishte rritja e ndërjegjësimit të votuesve. Kjo gjithashtu e zvogëloi kohën e cila ishte në dispozicion për të paraqitur ankesat dhe parashtrirat para ditës së zgjedhjeve. Zgjedhjet u mbajtën sipas kornizës legjislative ekzistuese (2008). Mbeten që të adresohen një sërë mangësish, duke përfshirë edhe përafrimin më të mirë të legjislacionit primar dhe sekondar mbi zgjedhjet, afatet e duhura kohore për ankesa dhe parashtrira, saktësinë e listave të votuesve në mënyrë që sa më mirë të pasqyrojnë praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Anëtarësimi i kohëve të fundit i Kosovës në Komisionin e Venecias mund të ndihmojë në këtë drejtim.

Në përgjithësi, Kosova organizoi zgjedhje të suksesshme të përgjithshme dhe lokale. Procesi zgjedhor në të dy rastet është përmirësuar në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i menaxhoi mirë përgjegjësitë e tij, duke marrë parasysh orarin kohor sfidues të zgjedhjeve të përgjithshme dhe kontekstin politik në të cilin u zhvilluan zgjedhjet lokale. Megjithatë, Kosova ende ka nevojë për një reformë të plotë zgjedhore për të adresuar rekomandimet nga misionet dhe ekspertët për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Parlamenti

Kuvendi vazhdoi të mbështesë përpjekjet e Kosovës për Integrim Evropian si dhe ka treguar unitet politik dhe institucional në disa çështje të rëndësishme kyçe, siç ishin dialogu me Serbinë,

mandati i EULEX-it dhe përpjekjet për reforma. Gjatë pjesës së parë të vitit 2014, fushata elektorale përpara zgjedhjeve të përgjithshme ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në punën e Kuvendit.

Kuvendi ka bërë progres në mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në konsultimet me shoqërinë civile. Numri i aktiviteteve monitoruese dhe niveli i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit është rritur.

Kuvendi në mënyrë të rregullt i ka rishikuar raportet e komisionit mbi zbatimin e ligjeve dhe ka miratuar rekomandimet për përmirësimin e zbatimit. Praktika e raportimit të ministrave në komisionet e Kuvendit është rritur. Është rritur numri i stafit mbështetës për komisionet. Kuvendi ka rritur numrin e konsultimeve me shoqërinë civile dhe me publikun përmes seancave. Kuvendi ka angazhuar një zyrtar ndërlidhës për OJQ-të.

Pas zgjedhjeve të qershorit, janë bërë disa përpjekje për të konstituuar Kuvendin dhe mundësuar fillimin e procesit të formimit të qeverisë. Mosmarrëveshjet se cila palë duhet të ketë të drejtën që të propozojë Kryesuesin e Kuvendit ka dërguar në një bllokadë politik. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese mbi rezultatin e seancës të parë konstituive nuk e ka thyer ngërçin politik.

Legjislatura e re duhet të vazhdoj hapat pozitivë të ndërmarrë nga ajo e mëparshme. Kuvendi duhet të shmang dështimet në arritjen e kuorumit dhe bojkotet e seancave plenare, të cilat rezultojnë me vonesa në marrjen e vendimeve dhe miratimin e legjislacionit. Kuvendi dhe komisionet e tij ende duhet të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre me ministrinë e linjës në procesin legjislativ dhe mbikëqyrës për të përmirësuar cilësinë e legjislacionit dhe për të siguruar zbatimin e tij. Draft ligjet dhe amandamentimet e legjislacionit kanë nevojë për vlerësim më të mirë në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me *acquis*-in. Kuvendi duhet të zhvilloj edhe më tutje standardet për konsultime publike dhe komisionet e tij duhet t'i zbatojnë ato në mënyrë të vazhdueshme gjatë seancave.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme nga Kuvendi dhe komisionet e tij për të siguruar kontrollin e buxhetit sidomos në fusha siç është shëndetësia, bujqësia, asistencë sociale, kultura dhe arsimit. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet raportimeve të zyrës së auditorit të përgjithshëm. Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike duhet të zhvilloj një mekanizëm për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve të tij.

Kuvendi duhet të përmirësoj mbikëqyrjen e kompanive publike, institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullative. Në këtë drejtim, duhet të themelohen mekanizmat adekuate, të tilla si baza të qarta ligjore për raportim dhe llogaridhënie. Ndër sfidat kryesore të cilat duhet të adresohen janë vonesat në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve dhe autoriteteve dhe dështimi për të përcaktuar mekanizmat për llogaridhënie të anëtarëve të Bordit. Shumë emërimet janë bërë në bazë të preferencave politike dhe jo sipas kualifikimeve profesionale, ose janë shtyrë për shkak të mosmarrëveshjeve politike.

Legjislatura e re duhet të miratojë rregulloren e re të punës sa më shpejt që është e mundur. Këto rregulla duhet të jenë në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së dhe duhet të bazohen mbi rekomandimet e projektit të binjakëzimit të financuar nga BE-ja. Funkcionimi i komisionit për integrim në BE duhet të përmirësohet edhe më tej në mënyrë që të pasqyrojë rolin e tij kyç në procesin e Kosovës për integrim Evropian. Ende nuk është siguruar pavarësia e infrastrukturës së TI-së të Kuvendit. Përgatitjet e buxhetit vjetor duhet të pasqyrojnë domosdoshmërinë e pavarësisë buxhetore të Kuvendit. Legjislatura e re, duke e përfshirë edhe Ligjin për Kuvendin e Kosovës, do të ishin shumë të dobishëm në këtë drejtim.

Sekretariati i Kuvendit duhet të vazhdojë të ndërtojë ekspertizën e tij mbi çështjet teknike për të mbështetur politik-bërjen efektive dhe kapacitetin për të përmirësuar shqyrtimin e draft-legjislacionit dhe zbatimin e tij. Sekretariati duhet të sigurojë koordinim më të mirë të të dhënave nga departamente e tij të ndryshme mbi punën e komisionit. Megjithatë, lëvizjet e mëdha të stafit mbeten një çështje shqetësuese.

Në përgjithësi, Kuvendi ka vazhduar që gradualisht të ngrit kapacitetet e tij dhe ka përmirësuar rolin e tij në qeverisjen demokratike. Kuvendi i ri duhet të fokusohet në minimizimin e krizës politike dhe institucionale. Bojkotet e panumërta të seancave plenare janë bërë pengesë në këtë drejtim. Dështimi për të formuar legjislaturën e re në mënyrën e duhur dhe me kohë ka qenë një hapë mbrapa. Legjislatura e re ofron një mundësi të mirë për të përmirësuar mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe monitorimin e proceseve legislative. Kjo gjithashtu duhet të jetë një mundësi për të sqaruar rolin e Kuvendit sa i përket mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullative për të zhvilluar rregullore të qarta të punës dhe për të përmirësuar monitorimin e buxhetit.

Qeveria

Pas zgjedhjeve të përgjithshme dhe negociatave të zgjatura për formimin e qeverisë së re, qeveria e mëparshme mbeti në detyrë në kapacitetin e ushtruesit të detyrës.

Në rrjedhën e negociatave mbi MSA-në, qeveria dhe në veçanti Ministria për Integritet Evropian dhe ajo e Tregtisë dhe Industrisë, kanë treguar kapacitetet e tyre për të koordinuar negociatat komplekse teknike dhe ligjore me BE-në. Qeveria gjithashtu i është drejtuar Kuvendit dhe opozitës duke e ftuar kryesuesin e komisionit për Integritet Evropian që të marrë pjesë në negociata.

Qeveria vazhdoi të zbatojë prioritetet për integritet në BE. Për të mbështetur këtë proces, ka miratuar një planë të veprimit për MSA-në në muajin dhjetor. Këshilli kombëtar për Integritet Evropian ka vazhduar të takohet dhe të diskutojë objektivat kryesore dhe obligimet politike për integritet të mëtejshëm në BE. Komisionet ekzekutive përgjegjëse për koordinimin dhe zbatimin e konkludimeve të Dialogut të PSA-së kanë vazhduar të takohen. Qeveria ka prezantuar obligimin që të përgatisë një tabelë të përputhshmërisë për të krahasuar draft-legjislacionin me *Acquis* e BE-së dhe ka lëshuar një dokument udhëzues mbi përdorimin e tabelave. Megjithatë, qeveria duhet të bëjë më shumë për të përmirësuar planifikimin dhe koordinimin strategjik në mes të ministrive. Agjenda qeveritare duhet të pasqyroj më mirë burimet në dispozicion.

Kanë vazhduar përpjekjet për të përmirësuar më tej kapacitetin e qeverisjes lokale. Pas zgjedhjeve lokale, shumica e kuvendeve të reja komunale janë formuar me kohë dhe kanë filluar të kryejnë detyrat e tyre. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka përmirësuar udhëzimet e saj për komunat duke krahasuar përputhshmërinë e akteve komunale me kornizën e përgjithshme ligjore. Udhëzimi ligjorë është lehtësisht i qasshëm në faqen e internetit të ministrisë. MAPL-ja ka hartuar legjislacionin zbatues mbi thirrjen dhe mbajtjen e kuvendeve komunale dhe përbërjen e komiteteve të kuvendeve komunale. Gjithashtu ka përgatitur një udhëzim administrativë mbi rishikimin e akteve komunale në nivel qendrorë. Në veri, është siguruar përputhshmëria e statuteve komunale me ligjin e Kosovës. Megjithatë, integriteti i këtyre komunave në kornizën ligjore të Kosovës është duke shënuar përparim gradual.

Duhet të vazhdojnë përpjekjet komunale për të rritur transparencën në vendim-marrje. Udhëzimi i ri administrativë mbi transparencën në komuna është zbatuar vetëm në dy komuna. Në nivel komunal, kapaciteti për të buxhetuar në përputhje me politikat dhe planet e zbatimit ende mbetet i pazhvilluar, duke shkaktuar diversione nga shpenzimet e planifikuara. Përcaktimi i prioritetëve dhe alokimi i burimeve financiare, jo gjithmonë pasqyrojnë udhëzimet strategjike. Duhet të vazhdojë zbatimi i decentralizimit, duke siguruar mbështetje adekuate dhe buxhet për komunat. Komunat vazhdojnë të përballen me sfidat për sa i përket krijimit të kushteve për zhvillimin e suksesshëm ekonomik. Duhet të zhvillohet një kulturë e ofrimit të shërbimeve publike të afërta me qytetarin. Nevojiten udhëzime të mëtejshme nga niveli qendrorë mbi obligimet e komunave në procesin e integritetit evropian.

Në përgjithësi, Qeveria e Kosovës ka dëshmuar qartë aftësitë e saj për të koordinuar agjendën

e Integritimit Evropian, sidomos në lidhje me negociatat për MSA-në. Qeveria gjithashtu ka përmirësuar udhëzimet për komunat në zbatimin e legjislacionit. Pas zgjedhjeve komunale, janë vendosur të gjitha strukturat kryesore në nivel komunal në të gjithë Kosovën. Megjithatë, si në nivel lokal dhe qendrorë, Kosova duhet të fokusohet në përmirësimin e planifikimit strategjik dhe lidhjet në mesë planifikimit dhe buxhetimit në bazë të dhënave të mbledhura, koordinimit të politikave dhe vlerësimeve të ndikimit financiar. Ekzekutivi duhet të fokusohet që të sigurojë se legjislacioni dhe politikat janë zbatuar në praktikë. Komunikimi i mirë me kuvendin, duke përfshirë përgjigjet e rregullta të qeverisë ndaj pyetjeve parlamentare dhe koordinimi i fuqishëm ndërministrorë do të jenë shumë të rëndësishëm në këtë drejtim.

Administrata Publike

Kosova ka një **kornizë strategjike për reformën e administratës publike** e cila është vendosur përmes strategjisë për reformimin e administratës publike të vitit 2010 dhe planit të veprimit për periudhën 2012-14. Strategjia është gjithëpërfshirëse, duke përfshirë aspektet kryesore siç janë: menaxhimi i politikave, planifikimi dhe ekzekutimi buxhetorë, organizimi i administratës publike dhe menaxhimi i burimeve njerëzore. Qeveria ka miratuar një Udhërrëfyes për vitin 2014 në mënyrë që të adresoj sfidat kyçe të reformave të mbetura në planin aktual të veprimit. Struktura e koordinimit për zbatimin e strategjisë dhe mekanizmi i tij monitorues janë reformuar në vitin 2013 për të përmirësuar monitorimin e zbatimit të legjislacionit në këtë fushë. Një grup i veçantë për reformën e administratës publike, i themeluar si forum për dialogun politikë në mes të Komisionit Evropian dhe Kosovës, u takua në dhjetor që të diskutojë dhe monitoroj zbatimin e strategjisë për reformat.

Zbatimi i strategjisë ka qenë një sfidë e konsiderueshme dhe ka pasur rezultatet shumë të kufizuara. Në hartimin e strategjisë së re, qeveria e re duhet të caktojë objektiva më real. Këto duhet të mbështeten me përkrahje të fuqishme politike, zbatim të qartë dhe planifikim buxhetorë dhe duhet të mbështeten nga numrat adekuat të stafit të kualifikuar.

Kosova ka bërë përparime sa i përket **zhvillimit dhe koordinimit** të politikave. Ka përgatitur standarde për konsultim publik mbi legjislacionin dhe ka miratuar një rregullore mbi vlerësimin e ndikimit financiar. Gjithashtu ka prezantuar një plan të ri të veprimit për partneritetin për qeverisje të hapur (2014-16). Zyra e Kryeministrit dhe Ministria për Integritim Evropian janë bashkërisht përgjegjës për sigurimin e mjaftueshëm të koordinimit të politikave. Kjo strukturë siguron një nivel bazë të gatishmërisë për rritjen e vëllimit të punës në lidhje me procesin e integritimit evropian. Plani vjetor i punës i qeverisë është bërë një platformë e cila i mundëson qeverisë që të planifikojë dhe koordinojë agjendën e saj. Struktura e këtij dokumenti dhe të dhënat nga ministritë janë përmirësuar.

Megjithatë, plani duhet të jetë më strategjikë, informatat e përfshira në planin e punës duhet të jenë më mirë të lidhura me prioritetet e qeverisë, strategjitë sektoriale, kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetin në dispozicion. Kapaciteti i ministrive për të planifikuar, buxhetuar dhe shqyrtuar projekt-propozimet mbetet i kufizuar. Puna e Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe jo-diskriminim duhet të jetë më e efektshme. Sfidat kryesore për qeverinë dhe institucionet e tjera relevante mbeten zbatimi i politikave dhe legjislacionit, si dhe respektimi i zotimeve në kuadër të MSA-së në të ardhmen. Qeveria duhet të vazhdojë praktikën e mira të themelura gjatë negociatave të MSA-së për të adresuar këto sfida. Ndërlidhja e politikave dhe legjislacionit me buxhetet dhe disponueshmëria e stafit të kualifikuar janë esenciale në kryerjen e kësaj detyre. Në përgjithësi, mekanizmat e koordinimit ndër-institucional të cilat janë të vendosur duhet të përdoren më mirë dhe duhet të zbatohen rekomandimet e Grupit të Veçantë për Reformën e Administratës Publike.

Sa i përket **shërbimeve publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore**, ndërhyrja e politikës në administratën publike vazhdon, si në nivel qendrorë ashtu edhe në atë lokal. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të zbatuar plotësisht dispozitat relevante për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e integritetit në shërbimet civil, veçanërisht duke ofruar trajnim të caktuar për shërbyesit civil. Legjislacioni sekondarë i ligjeve mbi shërbimet civile ende mungon. Duke pritur përfundimin e katalogut klasifikimit të punëve, ka pasur vonesa të mëtejshme në zbatimin e ligjeve mbi shërbyesit civil dhe pagat e shërbyesve civil. Numri dhe sistemimi i shërbyesve civil të cilët i takojnë minoriteteve në ministri dhe institucione duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin. Një rritje e pagës prej 25% për të gjithë shërbyesit civil pa ndonjë vlerësim të performancës, siç ishte prezantuar në prag të zgjedhjeve të përgjithshme është çështje shqetësuese.

Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, rritja e pagave do të rezultojë me një presion të konsiderueshëm në buxhet.

Është bërë progres i kufizuar në përmirësimin e mëtejshëm të **ofrimit të shërbimeve dhe llogaridhënies**. Ligjet mbi procedurat administrative dhe aktet normative mbeten që të miratohen. Zbatimi i ligjit mbi qasjen në dokumentet publike mbetet i pakënaqshëm. Kosova duhet të rishikoj organizimin e administratës publike në nivel komunal, kryesisht kompetencat e deleguara dhe emërimin e drejtorëve.

Kosova nuk i ka adresuar sistematikisht **reformat e menaxhimit të financave publike**, si pjesë e një plani gjithëpërfshirës të reformave. Përkundrazi, ka pasur përpjekje të izoluara për reforma në nën-sisteme të ndryshme të financave publike, të tilla si në menaxhimin e të ardhurave apo në kontrollin e brendshëm të financave publike, me rezultate modeste. Në muajin prill, Kosova ka miratuar kornizën afatmesme të shpenzimeve, e cila i mbulon vitet 2015-17. Dokumentit i mungon një qasje strategjike. Procesi i buxhetimit vjetor është i bazuar në qasjen veçantë buxhetor "line-item". Politika për menaxhimin e borxhit ka dhënë disa rezultate, pasi që borxhi është i ulët dhe i qëndrueshëm, edhe pse huamarrja e brendshme është rritur. Zbatimi i kontrollit të brendshëm të financave publike është ende në fazën fillestare, pasi që parimi i llogaridhënies menaxheriale ende nuk është ngulitur në kulturën e menaxhimit. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, përmes raporteve të tij të auditimit, si një institucion i pavarur ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në nxitjen e ndryshimeve në menaxhimin e financave publike.

Në përgjithësi, progresi në këtë fushë ka qenë shumë i kufizuar. Qeveria e re duhet të bëjë një angazhim serioz politik për reformën e administratës publike. Ritmi i ngadalshëm i reformave në këtë fushë vazhdon të përbëjë një nga sfidat më të mëdha në procesin e integritetit evropian të Kosovës. Vendosija dhe struktura e institucioneve qendrore koordinuese, ofron vetëm një nivel themelorë të përgatitjes për rritjen e vëllimit të punës për shkak të zbatimit të MSA-së. Nevojitet planifikim më i mirë strategjik dhe lidhje të përmirësuara me buxhetimin. Kosova duhet të finalizoj kornizën ligjore për shërbimin civil dhe të sigurojë zbatimin e tij, në veçanti katalogun e punës dhe vlerësimin e performancës. Kosova duhet të miratojë dhe të zbatojë ligjin mbi procedurat e përgjithshme administrative. Kosova do të përfitonte nga angazhimi në një reformë më të plotë të menaxhimit të financave publike.

Avokati i Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka vazhduar të performoj dhe të veprojë si një mbrojtës i të drejtave të qytetarëve të Kosovës vis-a-vi administratës. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit thotë se janë pranuar 2 047 raste, 23% më shumë se vitin e kaluar. Qeveria ka ndërmarrë hapin pozitiv që të ndajë buxhetin për një ndërtesë të re që është shumë e nevojshme për këtë institucionin.

Politizimi i procedurave të përzgjedhjes e ka ndaluar emërimin e Avokatit të Popullit. Institucioni aktualisht udhëhiqet nga një ushtrues detyre i Avokatit të Popullit dhe mandatet e pesë zëvendësve do të përfundojnë në tetor të vitit 2014. Është rritur presioni në komuna që të

dëbojnë zyrat në terren të këtij institucioni nga ndërtesa komunale. Ky është një shqetësim serioz. Autoritetet e Kosovës, si në nivel qendrorë po ashtu edhe në atë lokal, duhet të sigurohen që rekomandimet dhe pyetjet e Avokatit të Popullit të përcillen në mënyrë adekuate. Qeveria e re duhet të sigurojë pavarësinë buxhetore të institucionit gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin e ardhshëm.

Në përgjithësi, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë ka vazhduar gradualisht të përmirësoj punën e tij në të gjithë Kosovën. Megjithatë, autoritetet dhe institucionet e tjera në Kosovë duhet të përmirësojnë cilësinë e përgjigjeve të tyre në pyetjet e institucionit. Avokati i ri i Popullit duhet të zgjidhet në bazë të një procesi të drejtë dhe të depolitizuar të përzgjedhjes. Gjithashtu duhet të sigurohet pavarësia buxhetore.

Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Ka pasur progres të moderuar në punën e Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Komisioni ka shtuar numrin e takimeve dhe anëtarët e tij ishin të përgatitur mirë. Ministrat u ftuan më shpesh në seanca publike dhe iu përgjigjën shqetësimeve të parlamentarëve. Komisioni gjithashtu ka përgatitur një raport të monitorimit për zbatimin e Ligjit për Policinë e Kosovës dhe mbi shpenzimet nga ana e policisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Agjencia e inteligjencës ende lëshon certifikata të sigurisë për anëtarët e komisionit, edhe pse komisioni është përgjegjës për mbikëqyrjen e agjencisë. Në përgjithësi, shqetësimet në lidhje me verifikimin joprofesional dhe partizan të sigurisë nga shërbimi mbeten prezent. Kuvendi duhet të rrisë kapacitetin e saj dhe përmirësoj ekspertizën e saj për të mbikëqyrur këtë zonë.

Shoqëria civile

Një shoqëri civile e fuqizuar është një komponent i rëndësishëm i një sistemi demokratik dhe duhet të njihet dhe të trajtohet si e tillë nga institucionet e Kosovës. Shoqëria civile ka vazhduar të marrë pjesë në punën e Këshillit Kombëtar për Integrim Evropian. Kuvendi emëroi një zyrtar ndërlidhës për OJQ-të, dhe janë përmirësuar marrëdhëniet e Kuvendit me shoqërinë civile. Kapaciteti i qeverisë për zbatimin e strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile (2013-17) është ende i dobët. Këshilli i përbashkët konsultativ i cili duhet të monitoroj zbatimin e tij posa sa ka filluar punë në prill të viti 2014. Qeveria ka emëruar pjesëmarrësit e saj në këshillin konsultativ dhe shoqëria civile ka bërë thirrje për shprehje të interesit. Bashkëpunimi dhe konsultimi në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve të Kosovës, sidomos me qeverinë, vazhdon të jetë ad hoc dhe i pakënaqshëm. Përfshirja e shoqërisë civile, nëse kërkohet, vjen në shprehje vetëm në fund të procesit legjislativ dhe rrallëherë në fillim të saj. Shoqëria civile nuk merr në mënyrë sistematike reagime mbi rekomandimet e saj. Kjo duhet të përmirësohet. Planet për të përfshirë dispozita në ligjin për pastrimin e parave, që detyron shoqërinë civile të kërkoj leje për të gjitha donacionet mbi 1000 € nga një burim i vetëm dhe për të gjitha shpenzimet mbi 5000 € nga një burim i vetëm, janë një arsye për shqetësim, veçanërisht pasi që kriteret për dhënien e lejeve nuk janë të përfshira.

Sistemi gjyqësor

Strukturat gjyqësore të Kosovës janë përshtatur mirë me reformën strukturore të vitit 2013. Në prill të vitit 2014, Kosova u pajtua për zgjatjen e mandatit të ri të EULEX-it. Si rregull, panelet e përziera (gjykatësit e EULEX-it dhe të Kosovës), tani përbëhen nga shumica e gjyqtarëve të Kosovës dhe nga një gjyqtar kryesues i Kosovës. Në pritje të integritetit të plotë të sistemit gjyqësor në veri, gjykimet në gjykatën themelore të Mitrovicës kanë vazhduar të mbahen me panele të përbëra ekskluzivisht nga gjyqtarë të EULEX-it dhe ndjekjet penale bëhen vetëm nga prokurorët e EULEX-it.

Në korrik, Gjykata Kushtetuese vendosi se procesi i përzgjedhjes së kryeprokurorit të ri të shtetit i cili ishte finalizuar në qershor, duhej të përsëritet. Është emëruar një ushtrues detyre i Kryeprokurorit të shtetit pas daljes në pension të kryeprokurorit të shtetit të mëparshëm në

muajin gusht. Duhet të prezantohen mjetet e duhura ligjore kundër vendimeve të këshillit prokurorial dhe gjyqësor për të shmangur që mundësia e vetme kundër këtyre vendimeve të jetë Gjykata Kushtetuese.

Gjetjet paraprake të shqyrtimit të drejtësisë penale të iniciuar nga Ministria e Drejtësisë erdhën në përfundim se mospërputhjet apo boshllëqe në ligjet e ndryshme penale do të përcjellën në raportin e dytë para se të bëhet vendimi për ndryshimet e mundshme. Në bashkëpunim me të gjithë palët e interesit, Ministria e Drejtësisë ka përgatitur një strategji për asistencë në sundimin e ligjit.

Lidhur me **pavarësinë** e gjyqësorit, buxhetet për të dy këshillat janë rritur në krahasim me vitin e kaluar. Buxheti i vitit 2014 për këshillin gjyqësor është 20.8 milion € dhe për këshillin prokurorial 6.8 milion €

Deklaratat publike të politikanëve rreth rasteve të nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimeve të luftës kanë rënë, sidomos pas një diskutimi të hapur në dialog të strukturuar mbi sundimin e ligjit. Ngacmimi i gjykatësve dhe prokurorëve në media dhe mungesa e një përgjigje efektive nga institucionet përkatëse vazhdon të jetë një shqetësim serioz. Përpjekjet për të ndikuar në hetimet dhe rastet gjyqësore të cilat janë në vazhdim duhet të sanksionohen në mënyrë efektive. Kjo duhet të mbështetet fuqimisht nga vullneti politik.

Legjislatura e re duhet të siguroj emërimin e anëtarëve të këshillit gjyqësor. Legjislatura e kaluar nuk e ka përmbushur detyrimin e saj kushtetues për të emëruar dy anëtarët e fundit të këshillit, duke e lënë këshillin me njëmbëdhjetë në vend të trembëdhjetë anëtarëve. Në gusht të vitit 2014 mandati i tre anëtarëve shtesë të këshillit ka skaduar. Këshilli është tani pa kuorum ligjorë, i cili kërkon nëntë anëtarëve. Kuvendi duhet të emërojë urgjentisht pesë anëtarë të këshillit. Shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor duhet të zgjidhen nga kolegët e tyre, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Në lidhje me funksionimin dhe **llogaridhënien** e gjyqësorit, Këshilli Gjyqësor ka miratuar rregulloren për punën e komisionit të tij disiplinor në promovimin e gjyqtarëve dhe në planin e tij strategjik 2014-19. Këshilli prokuroria, po ashtu ka miratuar rregulloren për vlerësimin e punës së prokurorëve.

Duhet bërë më shumë për të siguruar funksionimin dhe llogaridhënien e gjyqësorit. Për të siguruar zbatimin e plotë të ligjeve për këshillin gjyqësor dhe prokurorial, të dy këshillat ende duhet të miratojnë disa pjesë të legjislacionit zbatues. Ligjet për gjykatat, prokurorin e shtetit, këshillin gjyqësor dhe këshillin prokurorial, gjithashtu duhet të harmonizohen për të adresuar mospërputhjet në çështje të tilla si shkarkimi, emërimi, transferimi, sistemi disiplinor dhe procedurat për rishikimin e vendimeve të marra nga këshillat. Zbatimi i rregulloreve mbi performancën dhe vlerësimin si dhe mbi procedurat disiplinore është e rëndësishme, siç janë nominimi transparent dhe i bazuar në meritë si dhe kriteret e përzgjedhjes.

Këshilli prokurorial përballet me vonesa në seancat dëgjimore të ankesave kundrejt vendimeve të komisionit disiplinor për shkak të vështirësive në arritjen e kuorumit. Vlerësim i legjislacionit mbi përbërjen, kryesimin dhe anëtarësimin e këshillit prokurorial mund të jetë i nevojshëm për t'i tejkaluar pengesat e tilla. Sistemi disiplinor për gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Edhe pse të obliguar me ligj, nuk ka publikim sistematik të vendimeve gjyqësore, apo zhvillim sistematik të jurisprudencës, që ngrit shqetësime për transparencën dhe llogaridhënien.

Sa i përket **efikasitetit**, këshilli gjyqësor ka miratuar një strategji të re për të zvogëluar numrin e rasteve të grumbulluara. Këshilli prokurorial ka rritur numrin e pozitave të prokurorëve vendorë në Zyrën e Prokurorisë Speciale për tre zyrtar duke dërguar në total të tetëmbëdhjetë zyrtareve, nga të cilit dymbëdhjetë pozita tashmë janë përmbushur. Një prokuror special

vendor është ushtrues detyre i udhëheqësit të zyrës, ndërsa prokurorët e EULEX-it marrin hetime të reja vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Katër gjykatat themelore dhe gjykata të apelit janë të pajisura me dhoma të veçanta për dëshmitarët e mbrojtur.

Për sa i përket alternativave gjyqësore ndaj gjykatave, tani ka 68 noterë të certifikuar dhe të licencuar. Katërmbëdhjetë agjentët privatë të përmbarimit janë certifikuar. Gjithashtu, qendrat e ndërmjetësimit kanë pasur një ndikim pozitiv. Numri i rasteve të referuara tek qendrat e ndërmjetësimit është rritur në mënyrë të konsiderueshme (699 në periudhën shtator 2013-mars 2014, në krahasim me 104 raste në të njëjtën periudhë një vit më parë). E njëjta gjë vlen edhe për numrin e rasteve të zgjidhura (350 në krahasim me 38). Ndërgjegjësimi i publikut për ndërmjetësim dhe qendra të ndërmjetësimit duhet të përmirësohet.

Për shkak të dispozitave strikte ndaj shkeljeve zgjedhore në Kodin e ri Penal dhe qasjes shumë proaktive nga ana e prokurorisë para dhe gjatë kohës së zgjedhjeve, gjykatat kanë pranuar më pak raste në vitin 2013 (54) dhe 2014 (15). Këto raste janë trajtuar më me prioritet dhe në mënyrë më efektive sesa rastet e mashtrimeve zgjedhore të viti 2010, nga të cilat një numër i konsiderueshëm janë ende në pritje në gjykata.

Edhe pse gjykatat dhe zyrat e prokurorisë janë përshtatur mirë me ndryshime strukturore të vitit 2013, zbatimi i plotë i reformave që duhet të dërgoj në efikasitet më të madh është ende i mangët. Rastet e grumbulluara paraqesin një nga shqetësimet kyçe. Gjykatat nuk janë duke zbatuar udhëzimin e KGJK-së për prioritizimin e lëndëve të grumbulluara.

Në fund të vitit 2013, gjykatat kanë përfunduar 419,422 raste duke lënë 466,255 raste të pazgjidhura (një normë e efikasitet prej 80.3%). Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë është themeluar në janar të vitit 2014 dhe ende nuk është plotësisht funksional. Ky divizion tashmë po përballet me një numër të konsiderueshëm të ankesave kundër vendimeve të sektorit të doganës për ankesa. Efektiviteti i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS), që trajton rastet e privatizimit, duhet të përmirësohet. Për shkak të mungesës së gjyqtarëve, ka vonesa në punën e DHPGJS-së; Numri i rasteve aktive është rreth 18000 raste.

Nuk ekziston sistemi i TI-së për ndarjen e rasteve e as sistemi për menaxhimin e rasteve, dhe nuk ka asnjë bazë të centralizuar të të dhënave penale e cila pengon efikasitetin e sistemit gjyqësor. Aftësitë e hartimit, arsyetimit kritik, dhe argumentimit ligjor duhet të përmirësohen dhe ka mungesë të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushat kyçe të specializuara si krimet financiare dhe prokurimi, krimet e luftës dhe dhuna seksuale. Vështirësia për të rekrutuar prokurorët dhe gjyqtarët nga komunitetet pakicë i lë ato komunitete të nën-përfaqësuara në gjykata dhe zyra të prokurorisë, në të gjitha nivelet.

Për sa i përket **qasjes në drejtësi**, nga gjithsej trembëdhjetë zyra të ndihmës juridike, janë mbyllur tetë zyra që më parë janë sponsorizuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Autoritetet e Kosovës duhet t'i shtojnë përpjekjet për të përmirësuar qasjen në drejtësi për fëmijët, gratë dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Legjislacioni zbatues për certifikimin e përkthyesve dhe interpretuesve gjyqësor duhet të miratohet.

Kosova ka themeluar një rrjet të pikave kontaktuese për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar i përbërë nga tetë prokurorë dhe shtatë gjyqtarë. Është miratuar legjislacioni zbatues për ndihmën juridike. Janë lidhur marrëveshje bilaterale për bashkëpunim juridik me pesë shtete, si dhe bashkëpunimi i bazuar në reciprocitet ekziston edhe me shumë të tjerë. Bashkëpunimi me vendet që nuk e kane njohur Kosovë lehtësohet nga EULEX-i.

Në përgjithësi, duhet thënë se për sa i përket gjyqësorit ka pasur pak progres. Kosova ka filluar të adresojë disa nga prioritetet, por vazhdon të ketë shqetësime serioze lidhur me pavarësinë, përgjegjshmërinë, paanësinë dhe efikasitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sfidat tjera përfshijnë përgatitjet për kalimin e përgjegjësive nga EULEX-i tek institucionet e Kosovës, integrimin e sistemit gjyqësor në veri në struktura institucionale të Kosovës, si dhe nevojën për specializimin dhe përmirësim e cilësisë së performancës. Gjyqësori i Kosovës duhet të trajtoj rastet e grumbulluara dhe pavarësisht nga opinioni publik ose politik, të ngrit aktakuza në bazë të provave të mbledhura të pranueshme dhe të japë gjykime të arsyetuara në kohë të duhur. Rekrutimi dhe vlerësimi transparent dhe i bazuar në merita i gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe mekanizmi disiplinor i cili funksionon në mënyrë të duhur, janë hapa të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të funksionimit të gjyqësorit.

Lufta kundër korrupsionit

Këshilli kundër-korrupsionit i Presidentes është takuar katër herë gjatë periudhës raportuese. Të gjitha institucionet dhe autoritetet e përfshira në luftën kundër korrupsionit, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile janë pjesë e këshillit. Pas komenteve në raportin e vitit të kaluar, mbledhjet e tij nuk janë mbajtur në publik. Rekomandimet e këtij Këshilli i japin merita monitorimit sistematik për të siguruar një qasje të harmonizuar dhe efektive në luftën kundër korrupsionit.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër-korrupsionit dështoi të gjenerojë rezultate efektive, për shkak të mbështetjes së dobët politike. Raporti vjetor tregon që për periudhën qershor-dhjetor 2013, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), ka vlerësuar se vetëm 54% e veprimeve janë duke u zbatuar, ose janë zbatuar pjesërisht. Funksioni i mbikëqyrjes së AKK-së në lidhje me zbatimin e strategjisë duhet të forcohet.

Agjencisë i mungon kapaciteti i nevojshëm analitik për të kryer vlerësimin e rrezikut në sektorët e ndjeshëm ndaj korrupsionit. Cilësia e raporteve të para-hetimore duhet të përmirësohet për të siguruar përcjellje më të mirë, dhe prokuroria duhet të vazhdojë të siguroj dhe të ofroj reagime tek AKK-ja.

Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të të gjithë zyrtarëve të lartë publikë është harmonizuar me Kodin Penal ashtu që tani mos deklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rrejtshëm klasifikohet si vepër penale. Zyrtarët e lartë publik detyrohen të deklarojnë pasurinë e tyre në AKK para 31 Marsit të çdo viti. Deklaratat janë po ashtu të nevojshme edhe kur të fillojnë ose largohen nga detyra, ose në qoftë se agjencia e kërkon këtë. Nga një total prej 3869 zyrtarëve të lartë publik që janë të detyruar të bëjnë këtë, 99.25% prej tyre e kanë bërë këtë deklaram. Agjencia ka kapacitet për të verifikuar origjinën dhe vërtetësinë e pasurisë së deklaruar.

Për sa i përket korrupsionit në prokurim, Agjencia Kundër-Korrupsionit përzgjedh dhe inspekton rastet e prokurimit dhe ka dhënë 28 opinione për autoritetet kontraktuese (institucionet publike) në vitin 2013. Të gjitha rekomandimet e dhëna të agjencisë për rastet e inspektuara ishin marrë parasysht dhe aktivitetet e prokurimit janë ndërprerë.

Agjencia, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe komunat, ka zhvilluar një "linjë kontaktuese" për të raportuar korrupsionin në ueb-faqet e komunave. Agjencia duhet të organizojë më shumë fushata të ndërgjegjësimit për të inkurajuar qytetarët që të raportojnë korrupsionin.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik ende nuk është harmonizuar me Kodin Penal. Në vitin 2013, AKK gjeti mbi 1400 raste të zyrtarëve të lartë që mbajnë funksione të shumta të financuara nga buxheti i Kosovës, duke përfshirë edhe pozita të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike. Kjo nuk është një vepër penale në vetvete, por mund të paraqesë një rrezik potencial të konfliktit të interesit, veçanërisht për gjyqtarë, prokurorë dhe zyrtarë të lartë. Sa i përket Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, numri i dënimeve është i ulët dhe

sanksionet e imponuara nuk e ka parandaluar këtë fenomen. Duhet të hartohet formulari i standardizuar i deklarimeve dhe udhëzimet e verifikimit me kritere objektive. Sasia e mostrave duhet të rritet, duke i dhënë prioritet 'grupeve të rrezikut'.

Partitë politike në përgjithësi nuk i përmbushin detyrimet e tyre në bazë të Ligjit për Financimin e Partive Politike. Zbatimi dhe ekzekutimi i ligjit është i dobët. Zyra e Komisionit Qendror Zgjedhor e cila është e ngarkuar me monitorimin e zbatimit ka mungesë të kapaciteteve dhe burimeve.

Marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve penale hetimore dhe AKK-së janë përmirësuar. Në shumicën e rasteve, AKK-ja ka pranuar konfirmimin nga prokuroria dhe Policia e Kosovës, për iniciimin e procedurave penale mbi rastet e raportuara nga ana e AKK-së.

Me përfshirjen e palëve të interesit, Këshilli prokurorial ka zhvilluar një mekanizëm për përcjelljen e rasteve të veprave penale dhe ka publikuar raportin e parë vjetor në vitin 2013 duke përfshirë edhe rastet e korrupsionit. Raporti që mbulon periudhën janar-qershor 2014 po ashtu ka përfshirë edhe krimet ekonomike. Kryeprokurori i Shtetit ka miratuar një udhëzim që përcakton 'korrupsionin e nivelit të lartë' dhe ka caktuar zyrën e posaçme hetimore për t'u marrë me raste të tilla. Në nëntor të vitit 2013, Këshilli i Prokurorial mori një vendim për të prioritetizuar rastet e korrupsionit dhe ka caktuar pikat kontaktuese kundër-korrupsionit në secilën zyre të prokurorisë. Këshilli gjyqësor lëshoi një udhëzim të ngjashëm tek gjykatat.

Task forca kundër-korrupsionit, që përbëhet nga katër zyrtar të Policisë së Kosovës dhe tre prokurorë special, ka referuar vetëm pesë raste të reja penale tek Zyra e Prokurorisë Speciale. Shumica e rasteve të korrupsionit trajtohen në zyrën e prokurorisë dhe në gjykatën themelore në Prishtinë. Është e rëndësishme që këto zyra të kenë staf të mjaftueshëm dhe të gatshëm për të trajtuar këtë ngarkesë shtesë të rasteve, sidomos atyre rasteve të korrupsionit me prioritet të lartë. Pavarësisht prioritetit të lartë, rezultatet kanë qenë të kufizuara, me shumë pak raste të korrupsionit që rezultojnë në vendime gjyqësore.

Gjatë procedurës së emërimit të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, Kuvendi nuk ka marr parasysh rekomandimin e Bordit të Pavarur Përzgjedhës, që kishin shqetësime për listën e të emëruarve, duke përfshirë një hetim aktual të korrupsionit.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë progres të kufizuar dhe është në një fazë të hershme në luftën kundër korrupsionit. Edhe pse këshilli gjyqësor dhe këshilli prokurorial i Kosovës ka prioritetizuar rastet e korrupsionit, nuk ka asnjë evidencë për ndonjë dënim. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha, duke përfshirë prokurimin publik, dhe vazhdon të jetë një problem serioz që duhet të adresohet urgjentisht. Nevojitet angazhim i shtuar politik për të shndërruar përpjekjet në rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit. Po ashtu duhet të ketë fuqizohet bashkëpunimi ndërinstitucional. Gjyqësorit duhet t'i krijohet mundësia që të luftoj këtë fenomen në mënyrë efektive. Në të njëjtën kohë prokurorët dhe gjyqtarët duhet të tregojnë më shumë përgjegjshmëri duke i trajtuar rastet në mënyrë më efikase dhe duke dhënë rezultate.

Lufta kundër krimit të organizuar

Kosova ka ndërmarrë disa hapa për të përmirësuar luftën kundër krimit të organizuar. Ajo ka vazhduar të përmirësoj kornizën e saj legjislativ, posaçërisht duke miratuar legjislacionin zbatues për pastrimin e parave. Kapacitetet hetimore të policisë në përgjithësi janë të mira. Bashkëpunimi me EULEX-in është intensifikuar dhe është vlerësuar si shumë i mirë. Numri i hetimeve të krimeve të lidhura me drogën ka shënuar rritje dhe disa grupe të trafikut njerëzor janë shpërbërë.

Kosova është në një fazë të hershme të arritjes së rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar, i cili vazhdon të jetë një sfidë serioze. Numri i përgjithshëm i aktakuzave dhe aktgjykimeve për rastet e trafikimit të narkotikëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore mbetet i ulët. Agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kanë qenë të gatshme t'i fillojnë hetimet financiare. Si

rezultat i kësaj, numri i konfiskimeve dhe sekuestrimeve të urdhëruara nga gjyqësori dhe të ekzekutuara nga policia vazhdon të jetë i ulët. Në mesin e prokurorëve dhe gjyqtarëve ka një mungesë të ekspertizës në fusha të specializuara të tilla si krimi financiar dhe mashtrimi në prokurim. Kjo ekspertizë është e domosdoshme për të trajtuar korrupsionin.

Për një analizë të hollësishme të zhvillimeve në luftën kundër krimit të organizuar, *shih 4.3 - Drejtësia, liria dhe siguria.*

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Nëpërmjet Kushtetutës së saj, shumë **instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut** drejtpërdrejt janë të zbatueshme në Kosovë dhe formojnë pjesë integrale të kornizës së saj legjislative. Raportimi i Kosovës mbetet ad hoc, pasi nuk është anëtare në ndonjë prej instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e as anëtare e Këshillit të Evropës.

Hapat e ardhshëm të Kosovës për **promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut** duhet të bazohen në propozimin e reformave për institucionet jo-gjyqësore të të drejtave të njeriut nga një projekt i përbashkët i BE-së/ Këshillit të Evropës. Kosova duhet të thjeshtësoj kornizën institucionale, t'i ngrit kapacitetet e saj dhe t'i qartësoj rolet e akterëve të ndryshëm të shërbimit civil dhe publik, të përforcoj Institucionin e Avokatit të Popullit dhe të sigurojë mekanizma efektive dhe të qëndrueshëm të monitorimit dhe raportimit, duke përfshirë edhe ato të shoqërisë civile. Kosova duhet të miratojë ligjet kundër diskriminimit, të Avokatit të Popullit dhe barazisë gjinore si një pako të vetme, në mënyrë që të sigurojë koherencë dhe plotësueshmëri në legjislacionin për të drejtat e njeriut. Strategjia për të drejtat e njeriut duhet të azhurnohet, duke i përfshirë mekanizmat e zbatimit të përcaktuar në pakon ligjore për të drejtat e njeriut, për të siguruar një qasje strategjike afatgjatë dhe të qëndrueshme. Çështjet e të drejtave të njeriut në të gjitha nivelet duhet të vendosen më lart në agjendën politike, veçanërisht për sa i përket zbatimit. Qeveria duhet të bëhet më pak e varur nga donatorët në këtë sektor.

Për sa i përket **parandalimit të torturës dhe keqtrajttimeve** në burgje, është themeluar një program inspektimi që monitoron punën e shërbimeve korrektuese. Nuk janë identifikuar shkelje kundër standardeve të njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në periudhën raportuese. Nuk ka keqtrajtim sistematik të të burgosurve në **sistemin e burgjeve**. Zbatimi i legjislacionit është harmonizuar me standardet e BE-së.

Burgu i parë i sigurisë së lartë është vënë në përdorim zyrtar në maj të vitit 2014. Paraburgimi i zgjatur dhe i pajustificuar vazhdon të jetë një sfidë për sistemin e drejtësisë penale. EULEX-i mori përsipër tri raste, pasi që gjyqësori vendor nuk i kishte finalizuar procedurat brenda afatit ligjor të paraburgimit. Qendra e paraburgimit në Mitrovicë ende përdoret si një burg. Korrupsioni në shërbimet korrektuese është një shqetësim në rritje. Qeveria duhet të marrë veprim vendimtar për të trajtuar atë. Disa të paraburgosur vazhdojnë të gëzojnë 'privilegje', për shembull duke zgjedhur vendosjen në spitale të rregullta jashtë institucionit korrektues. Këto ngjarje patën një ndikim negativ në raste të rëndësishme gjyqësore. Hetime të brendshme kundër stafit korrektues të përfshirë kanë dërguar në sanksione disiplinore.

Sa i përket **lirisë së shprehjes**, pluralizmi elementar i spektrit mediatik ofrohet nga të përditshmet e pavarura dhe disa transmetues. Kuvendi miratoi një ligj për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë dhe ka emëruar katër anëtarë të rinj të bordit të Komisionit të Pavarur për Media, duke i dhënë bordit në total, pesë anëtarë, nga shtatë të paraparë. Kjo i ofron bordit kuorumin e kërkuar për të kryer detyrat e tij. Kandidatët e përzgjedhur plotësojnë kërkesat ligjore, edhe në qoftë se procesi i emërimit favorizonte përkatësinë politike sesa pavarësinë. Këto emëime përfunduan pothuajse para dy viteve gjatë së cilës komisioni ishte pa qeverisje të duhur, i cili kishte kompromentuar autoritetin dhe aftësinë e tij për të siguruar transparencën e tregut. Gjithashtu vonoi një sërë vendimesh kyçe, të tilla si digjitalizimi i transmetuesve analog.

Një vendim ishte arritur në rastin 'Kosova 2.0', ku ishte sulmuar një ceremoni inauguruese për

një edicion të veçantë të revistës për seks, orientim seksual dhe identitet gjinor. Të tre të pandehurit u shpallën fajtorë dhe morën dënime ndëshkuese. Një nga akuzat ishte tërhequr pasi ajo ishte e mbuluar nga ligji për amnistinë. Ka pasur disa raste për shpifje, por gazetarët e përfshirë janë liruar.

Ka pasur një ndryshim në udhëheqjen e organizatës së gazetarëve vendor. Kjo ka potencial për të përmirësuar reputacionin e organizatës. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës është e njohur si një platformë e aftë për të zhvilluar më tej vetë-rregullimin profesional.

Megjithatë, korniza legjislative dhe institucionale në këtë fushë mbetet e fragmentuar dhe jo efektive. Çështjet e tilla siç është autonomia e gazetarëve dhe redaktorëve, mbrojtja e standardeve profesionale në gazetari, e drejta për kundërshtim të ndërgjegjshëm për gazetarët, dhe e drejta për përgjigje dhe korigjim për publikun mbeten të parregulluara me ligj. Kodet e mirësjelljes editoriale të mediave individuale do të jenë të dobishme në këtë drejtim. Ende vazhdojnë kërcënimet dhe sulmet, edhe nga zyrtarët e policisë dhe ata publik ndaj gazetarëve. Raste të gjuhës së urrejtjes vazhdojnë të jene prezentë, kryesisht në internet, duke përfshirë edhe ato në media sociale.

Qëndrueshmëria ekonomike e mediave nuk është e siguruar. Kosova nuk ka rregulla efektive për transparencën e pronësisë së medias. Kjo rezulton në përqendrim të tepruar dhe shkelje të pavarësisë. Reklamat qeveritare kanë pasur ndikim në politikat redaktuese të disa mediave. Qëndrueshmëria afatgjatë financiare e transmetuesit publik të Kosovës (RTK), vazhdon të jetë e paqartë. Financimi i tij i tanishëm vjen kryesisht nga buxheti i shtetit, i cili dëmton pavarësinë editoriale. Sindikata e RTK-së ka vënë në dukje korrupsionin dhe mungesën e transparencës në politika të punësimit dhe rekrutimit të RTK-së. *(Shih po ashtu 4.2.6 — Shoqëria informative dhe mediat)*

Qytetarët e Kosovës kanë vazhduar të ushtrojnë **lirinë e tyre të tubimit dhe organizimit** në tërë Kosovën. Ka pasur disa protesta publike kundër niveleve të ndryshme të qeverisë gjatë periudhës raportuese.

Ka pasur progres të vazhdueshëm në fushën e **lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë**. Shkolla për priftërinj ortodoks vazhdon të funksionojë mire në ambientet e saj historike në Prizren, dhe numri i studentëve të saj është në rritje. Kosova mbetet e gatshme të mbështes rindërtimin e objekteve të Kishave Ortodokse Serbe të papërfunduara nga Komisioni për Zbatim dhe Rindërtim.

Bashkëveprimi midis krerëve fetarë të të gjitha përkatësive fetare është bërë më i rregullt. Nuk ka pasur raporte të incidenteve të rënda të ndërlidhura me mbrojtjen e objekteve historike dhe fetare, për të cilën Policia e Kosovës ka marrë përgjegjësinë nga KFOR-i. Është raportuar një incident në Manastirin e Deçanit, i cila ende është i mbrojtur nga KFOR-i. Vonesa në gjetjen e zgjidhjes për një mosmarrëveshje aktuale të tokës në mes të komunës së Deçanit dhe Manastirit të Deçanit paraqet një shqetësim. Kjo i kontribuon tensioneve të vazhdueshme në mes të manastirit, komunës dhe komunitetit lokal. Incidente të shumta të vjedhjeve të vogla dhe vandalizmit në objektet e trashëgimisë fetare, duke përfshirë manastiret dhe kishat ortodokse serbe dhe varrezat ortodokse dhe myslimane, vazhdojnë të jenë një sfidë për autoritetet e Kosovës. Këto incidente duhet të monitorohen në mënyrë sistematike dhe adekuate. Duhet të miratohet ligji për lirinë fetare.

Sa i përket të **drejtave të grave dhe barazisë gjinore**, në muajin janar qeveria miratoi një plan veprimi për zbatimin e rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Në muajin mars, Kuvendi ka ndryshuar legjislacionin me qëllim të përfshirjes së të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në këtë legjislacion. Në shtator të vitit 2013, u krijuan procedurat standarde të operimit për mbrojtjen nga dhuna në familje nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe nga Koordinatori Kombëtar kundër Dhunës në Familje. Në mars të vitit 2014, Zyra për Qeverisje të Mirë ka lansuar një protokoll për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar. Tri komuna kanë themeluar mekanizmat

koordinues për dhunën familjare me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Çështja e dhunës seksuale gjatë luftës është duke marrë më shumë vëmendje nga politika dhe publiku. Një peticion për dhunën seksuale gjatë luftës, që kërkon nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për të raportuar në lidhje me këto krime, është nënshkruar nga më shumë se 100000 persona.

Sfidat mbeten në fushën e dhunës familjare dhe dhunës me bazë gjinore. Kosova duhet të krijoj një sistem për mbledhje të rregullt të të dhënave mbi dhunën në bazë gjinore në të gjitha institucionet. Qasja praktike e grave në trashëgiminë e pronës mbetet një sfidë, edhe pse ligji e parasheh këtë. Zyrtaret kadastral dhe të regjistrimit duhet të regjistrojnë të gjithë bashkëpronarët e pronës, duke i përfshirë edhe gratë, për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kosova duhet të zhvillojë një program afatgjatë të ri-integrimit për t'i adresuar nevojat e grave (dhe fëmijëve), duke përfshirë rivendosjen, banimin e subvencionuar, punësimin dhe këshillimin. Përfaqësimi i grave mbetet i ulët, sidomos në pozita të larta, si në sektorin publik ashtu edhe atë privat. Ekziston gjithashtu një nevojë për trajnim të mëtejshëm dhe ngritje të vetëdijes, sidomos në zonat rurale. Ligji për barazinë gjinore duhet të miratohet si pjesë e pakos ligjore të të drejtave të njeriut.

Për sa i përket të **drejtave të fëmijëve**, departamentet për të miturit, të krijuar në gjykata dhe zyra të prokurorisë janë funksionale. Kjo kontribuon në një trend të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të përdorimit të masave alternative arsimore nga ana e shërbimit sprovues. Duhet të përshkallëzohen tryezat e rrumbullakëta dhe mekanizmat koordinues të menaxhimit të rasteve për mbrojtjen e fëmijëve. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve kanë nevojë për më shumë buxhet komunal për të ndihmuar në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës. Qeveria duhet të marrë parasysh rekomandimet nga projekti i përbashkët i BE-së/UNICEF-it mbi drejtësinë për të miturve. Qeveria nuk duhet t'i vonoj pagesat për skemat sociale të dedikuara për fëmijët në strehim familjar dhe për fëmijët me aftësi të përhershme të kufizuara. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të siguroj disponueshmërinë e asistentëve personal për fëmijët me aftësi të kufizuara, në përputhje me zotimet e bëra në strategjinë e saj.

Kosova e ka përmirësuar kornizën e saj ligjor për personat **e marginalizuar social dhe / ose personat me aftësi të kufizuara**. Në muajin dhjetor, qeveria miratoi një program për ofrimin e gjuhës së shenjave (2013-16). Ligji mbi paraplegjikët dhe tetraplegjikët pritet të miratohet. Qasja e barabartë në arsim cilësor për personat me aftësi të kufizuara dhe personat nga komunitete rom shkali dhe egjiptas mbetet shumë i kufizuar, pavarësisht nga angazhimi për arsimin gjithëpërfshirës. Për shkak të mungesës së objekteve adekuate mjekësore, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet e rehabilitimit janë të pamjaftueshme për personat me të ardhura shumë të ulëta, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit që jetojnë në varfëri. Legjislacioni zbatues mbi ligjin për personat e verbër ende duhet të miratohet. Qeveria duhet të adresoj mungesën e mësuesve asistente për fëmijët me nevoja të veçanta. Me mbështetje më të fortë nga Zyra për Qeverisje të Mirë, këshilli për persona me aftësi të kufizuara duhet të përmirësojë rolin e tij koordinues në zbatimin e strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2013-23) dhe planit të veprimit (2013-15).

Ligji **kundër diskriminimit** duhet të miratohet dhe të harmonizohet me ligjet për Avokatin e Popullit dhe atë të barazisë gjinore. Rastet e gjuhës së urrejtjes, që shënjestrojnë kryesisht anëtarët e minoriteteve etnike dhe komuniteteve më përcaktime të ndryshme seksuale, shumë rrallë hetohen. Mbeten të pakta masat parandaluese siç është rritja e ndërjegjësimin. Liderët politikë të Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të promovuar tolerancën.

Në muajin dhjetor, qeveria miratoi vendimin për krijimin e një grupi këshillues dhe koordinues për të drejtat e komunitetit të **lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transjinoreve dhe interseksualeve (LGBTI)**. Grupi ende duhet të dëshmoj ndikimin e tij praktik. Ende vazhdojnë të jenë prezentë kërcënimet ndaj aktivistëve LGBTI. Shëtitja e parë e krenarisë u mbajt në Prishtinë më 17 maj për të shënuar ditën kundër homofobisë.

Në fushën e të **drejtave të sindikatave të punës**, qeveria dhe Këshilli Ekonomiko-Social

nënshkroi Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive që përcakton të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe punonjësit. Inspektorati i punës, me burime të kufizuara njerëzore (50 inspektorë që mbulojnë çështjet e sigurisë në punë dhe shëndetit) ka kryer mbi 8000 inspektime dhe ka lëshuar më shumë se 120 gjopa që arrijnë shumën e 274 000 € për vitin 2013. Ky numër është shumë i ulët, duke pasur parasysh numrin e bizneseve aktive të regjistruara në Kosovë (53 335). Zbatimi i Ligjit të punës mbetet i pakënaqshëm. Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore është e ulët dhe vazhdon të ketë diskriminim në lidhje me pushimin e lehonisë. Zbatimi i Ligjit për Grevat gjithashtu mbetet i pakënaqshëm, për shkak të mungesës së komunikimit mes organizatorëve të grevave dhe autoriteteve. Përfaqësimi i të punësuarve në Këshillin Ekonomiko-Social nuk ka mbështetjen e shumicës dërrmuese të sindikatave dhe për këtë arsye nuk është përfaqësues. (*Shih po ashtu 4.1.8 — Politikat sociale dhe të punësimit, politikat e shëndetit publik*)

Progresi në të **drejtat e pronës** mbetet i ultë. Është fuqizuar zyra e koordinatorit të të drejtave pronësore. Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje është nxjerr në muajin dhjetor. Ka pasur disa përmirësime sa i përket përputhshmërisë me detyrimet ligjore gjatë procesit të shpronësimit. Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ka zgjedhur kërkesat pronësore që kanë rezultuar nga konflikti i armatosur, ku prej 42 684 kërkesave në total, 1 357 kërkesa mbeten të shqyrtohen nga Komisioni për Kërkesa Pronësore. Numri i vendimeve të zbatuara është 29871. Vendimet zbatuese në raste të vështira (dmth ku ndodhën ndërtimet e paligjshme) është problematik. AKP-ja, siç theksohet në një rast të Gjykatës Kushtetuese, duhet të zhvilloj mekanizma dhe procedura ligjore për zgjidhjen e rasteve të tilla. Mbeten të pakryera më shumë se 900 dëbime, nga të cilat mbi 350 nuk mund të ekzekutohen për shkak se ato janë në veri të Kosovës. Ri-uzurpimi i paligjshëm i pronave mbetet një sfidë e rëndësishme. Financimi i AKP-së vazhdon të jetë i paqëndrueshëm.

Ende nuk është themeluar skema e kompensimit për kundërshtimin e ankesave të suksesshme të parapara sipas regjimit të paraardhësit të AKP-së, duke ngritur shqetësime për të drejtat e njeriut duke marr parasysh se shumica e rasteve janë parashtruar dhe vendosur shumë vite më parë.

Ende duhet të miratohet strategjia për rregullimin e vendbanimeve joformale. Ligji i ri për Krahasimin dhe Verifikimin e pronës së Agjencisë Kosovare të Pronës është ende në pritje për tu miratuar.

Gjykatat (civile) rregullisht hedhin poshtë shumë kërkesa për kompensim të pronës së pazgjidhur ('raste të pezulluara') duke iu referuar konfliktit të armatosur. Mosmarrëveshjet tjera pronësore shpesh dërgohen tek niveli i shkallës së parë për rigjykim. Kontestet pronësore ndëretnike janë padrejtësisht të zgjatura. Në përgjithësi, gjykatat janë të mbingarkuara nga numri i madh i rasteve në pritje.

Në përgjithësi, Kosova ka shënuar progres në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Komisioni i Pavarur për Media u bë funksional pas një periudhe gati dy vjeçare pa udhëheqje të duhur.

Autorët e dhunës kundër portalit Kosova 2.0 janë dënuar. Në përgjithësi, të drejtat themelore të njeriut vazhdojnë të jenë të garantuara në masë të gjerë në Kosovë. Megjithatë, sfida kryesore është zbatimi i kornizës ligjore, duke përfshirë edhe atë në nivel lokal. Duhet të vendosen kushtet për lirinë e shprehjes dhe medias. Kosova ka nevojë të adresoj në mënyrë efektive kërcënimet e vazhdueshme dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe aktivistëve të LGBTI-së. Të drejtat e pronës duhet të zbatohen në mënyrë efektive. Pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut duhet të miratohet. Kosova ka nevojë urgjente të thjeshtojë sistemin e organeve dhe institucioneve të shumta që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Respektimi dhe mbrojtja e minoriteteve dhe të drejtave kulturore

Kosova ka një kornizë të mirë ligjore për ruajtjen dhe mbrojtjen e **pakicave** të saj, por zbatimi duhet të përmirësohet. Në gusht të vitit 2014 u emëruan anëtarët e rinj të Këshillit Konsultativ

për Komunitet pranë Zyrës së Presidentes. Ata duhet të vazhdojnë të takohen në baza të rregullta për të diskutuar dhe adresuar çështjet kryesore që prekin komunitetet në Kosovë. Kanali i transmetuesit publik në gjuhën serbe (RTK 2) ka vazhduar transmetimin e tij. Kanali gjithashtu raportoi objektivisht zgjedhjet komunale dhe i dha kohë të barabartë secilës parti politike, siç parashihet në Ligjin për Zgjedhjet dhe siç raportohet nga Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian. Zyra për Çështje të Komuniteteve duhet të vazhdoj procesin për përmirësimin e punësimit të komuniteteve jo-shumicë në kuadër të shërbimit civil dhe ndërmarrjeve publike të Kosovës. Zyra ka lansuar një proces për të adresuar çështjen e pranimit të diplomave nga Universiteti në Mitrovicë për nëpunësit e mundshëm publike apo punonjësit e kompanive publike.

Zyra e Komisionerit të gjuhëve ka vazhduar të funksionoj. Zyra tashmë ka pranuar 45 ankesa për vitin 2014, në raport me dymbëdhjetë sa ishin në vitin 2013; 36 raste janë zgjidhur me ndërmjetësim. Zyra ka ofruar kurse të gjuhës në gjuhën shqipe dhe serbe për nëpunësit civilë në katërbëdhjetë komuna, me qëllim të përmirësimit të shërbimit ndaj publikut. Duhet të miratohen masat e politikave të gjuhës. Autoritetet e Kosovës në nivel qendror dhe lokal duhet të fokusohen në përmirësime të mëtejshme për zbatimin e përgjithshëm të ligjit për përdorimin e gjuhëve. Kjo duhet të përforcohet nga një mbështetje e fortë politike.

Gjendja e sigurisë për komunitetet jo-shumicë ka mbetur stabile. Megjithatë, shumica e incidenteve me motive etnike shënjestrojnë serbët e Kosovës. Vjedhjet dhe dëmtimi i pronave janë raportuar si llojet më të shpeshta të incidenteve, ndërsa ato që përfshijnë direkt personat, janë zvogëluar. Në zonat ku janë kthyer serbet e Kosovës, mbetet një çështje shqetësuese kërcënimi i perceptuar ose real për siguri, veçanërisht në disa komunitete rurale. Autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për t'i sjellë autorët e incidenteve ndër-etnike para drejtësisë. Janë themeluar Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi në të gjithë Kosovën. Funksionimi dhe efikasiteti i tyre ndryshon në masë të madhe. Këshillat duhet të bëjnë më shumë për t'i adresuar shqetësimet e sigurisë dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve etnike dhe fetare.

Në muajin nëntor është mbajtur një konferencë për komunitetet **Rom, Ashkali dhe Egjiptas**. Kosova tani ka nevojë të përshpejtoj zbatimin e planit të veprimit të strategjisë (2009-15), duke marrë parasysh prioritetet e identifikuara në Kornizën e Prioriteteve (2014-15) të muajit prill dhe konkluzionet e konferencës së Nëntorit. Kjo përfshin zbatimin e një kornize të re duke mundësuar monitorimin e bazuar në prova të rezultateve të arritura dhe zhvillimin e angazhimeve të reja politike për periudhën përtej vitit 2015. Në dhjetor të vitit 2013, është mbyllur ndërtesa kryesore e kampit Leposaviq, pas rivendosjes së 31 familjeve.

Në përgjithësi, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha, veçanërisht me rrethana të vështira socio-ekonomike, mungesë të arsimit, kujdesit të dobët shëndetësor dhe diskriminimit. Për sa i përket qasjes së barabartë në arsim cilësor, studentët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas kanë shkallë më të ulët të regjistrimit, normë më të larta të braktisjes, dhe nivel të ulët të performancës akademike. Statistikat mbi normat e braktisjes duhet të bëhen më të besueshme.

Ndërmjetësuesit kanë vazhduar të angazhohen me këto komunitete për të reduktuar numrin e braktisjeve nëpër shkolla, sidomos në shkolla me një përqendrim më të lartë të nxënësve nga këto komunitete. Qasja në regjistrimin civil vazhdon të mbetet shqetësuese dhe duhet të sigurohet kjo qasje. Kosova ka nevojë të fuqizoj koordinimin dhe bashkëpunimin ndër-institucional në nivel qendror si dhe në mes të nivelit qendror dhe lokal. Autoritetet kanë nevojë të shfrytëzojnë më mirë ekspertizën e grupeve përkatëse të shoqërisë civile. Është i nevojshëm alokim adekuat i buxhetit për të bërë progres të dukshëm në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit. Ndarjes e tokës nëpër komuna për të kthyerit e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas është thelbësor për integrimin e tyre të suksesshëm.

Ka pasur progres sa i përket **refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit** (PZHBV). Në vitin 2014, komuna e Klinës dhe Gjakovës ka ndarë parcela të tokës për disa

nga personat e zhvendosur nga kampi Konik i Malit të Zi. Kjo duhet të pasohet me fonde shtesë të qeverisë për të lehtësuar kthimin dhe ri-integrimin e familjeve në fjalë. Miratimi i strategjisë për komunitete dhe kthim (2014-2018), dhe trajnimet pasuese për zyrtarët komunal, kanë shënuar një zhvillim pozitiv drejt zgjidhjeve të qëndrueshme për të kthyerit. Kthimi dhe ri-integrimi në disa komuna të menaxhuara nga minoritetet (si Novobërda, Parteshi dhe Shtërpca) kanë treguar se familjet e kthyerat e kanë më të lehtë ri-integrimin në komunitete të tilla.

Megjithatë, numri i kthimeve vullnetare është ulur në vitin 2013 (afër 800, në krahasim me 1040 në vitin 2012). Numri i ulët i të kthyerve gjatë vitit 2013 mund t'i atribuohet kryesisht mungesës së financimit dhe perspektivës socio-ekonomike në Kosovë. Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrtar Komunale për Komunitete dhe Kthim ende nuk grumbullojnë dhe ruajnë të dhëna mbi numrin dhe vendndodhjen e të kthyerve.

Lidhur me të **drejtat kulturore**, Këshilli për Implementim dhe Monitorim vazhdon të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe. Takimet kanë vazhduar të mbahen, edhe pse jo gjithmonë të rregullta. Shqetësimet e Kishës dhe autoriteteve të Kosovës janë trajtuar duke rezultuar në një numër të veprimeve konkrete. Një sfidë e vazhdueshme për Këshillin është ndërtimi mbi këto rezultate të arritura për të krijuar besim të qëndrueshëm në mes të palëve. Për këtë qëllim, është me rëndësi kyçe që çështjet konfidenciale të mos shfrytëzohen për përfitime politike nga të dyja anët. Është themeluar baza e të dhënave në internet për trashëgiminë kulturore, që ofron informacion mbi monumentet, vendet arkeologjike, trashëgimisë shpirtërore dhe të luajtshme.

Njësia speciale e policisë e angazhuar për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë vazhdon të funksionojë mirë, dhe mbulon katër rajone dhe ka në radhët e saj 203 zyrtar të Policisë së Kosovës. Sfidat e menjëhershme me të cilat përballet ky njësit janë përmirësimi i komunikimit me klerikët rezident ortodoks në manastire dhe në sigurimin e disponueshmërisë së pajisjeve të mjaftueshme dhe të përshtatshme, siç janë: automjetet, kamera vëzhguese, gjeneratorët dhe ndriçimi.

Zbatimi i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është penguar nga mungesa e përkrahjes nga komuna. Këshilli i Trashëgimisë Kulturore zhvilloi disa mbledhje dhe ka arritur një numër të vendimeve që kanë të bëjnë me lejet e ndërtimit. Megjithatë, komuna duhet t'i ofroj Këshillit kompensim, pajisje dhe personel të nevojshëm, në mënyrë që ajo të funksionojë siç është paraparë me ligj. Task Forca e themeluar kohëve të fundit, e krijuar për t'u marrë në mënyrë specifike me ndërtimet e paligjshme në Prizren është inkurajuese, por efikasiteti i saj ende duhet të dëshmohet. Nuk ka pasur progres në zbatimin e Ligjit për fshatin Hoça e Madhe. Këshilli i fshatit ende duhet të krijohet dhe është vendosur në muajin gusht për të shtyrë më tej zbatimin e ligjit, edhe pse afati fillestar për implementim ishte shkurti i vitit 2013. Janë shpërndarë udhëzimet administrative për të dy komunat në muajin prill për t'iu ndihmuar në zbatimin e dy ligjeve. Nevojiten udhëzime të vazhdueshme nga niveli qendror për të siguruar zbatimin e plotë të këtyre ligjeve, pasi që kapaciteti në nivel komunal është i dobët.

Në përgjithësi, shkeljet e shpeshta të legjislacionit në të gjithë Kosovën të cilat ndikojnë negativisht në vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore kanë vazhduar. Zbatimi i kornizës së përgjithshme legjislative që rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore mbetet i dobët. Ndërtimi ilegal është një shqetësim i madh, veçanërisht në kuadër të Zonave të Veçanta të Mbrojtura. Masat ndëshkimore ndaj atyre që shkelin ligjet duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme, dhe ndërtimet e paligjshme të cilat tashmë kanë ndodhur duhet të trajtohen në përputhje me ligjin. Autoritetet e Kosovës, veçanërisht në nivel lokal, duhet të demonstrojnë një angazhim të fortë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Qeveria e re duhet të angazhohet në mënyrë aktive në këtë proces.

Në përgjithësi, ka pasur një progres në fushën e respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve. Toka është ndarë për disa persona të zhvendosur nga Mali i Zi. Këshilli për Implementim dhe Monitorim ka lehtësuar mbrojtjen më të mirë të trashëgimisë kulturore dhe fetare të Kishës

Ortodokse Serbe. Megjithatë, Kosova duhet të shtojë përpjekjet e saj për të siguruar zbatimin e kornizës legjislative dhe të politikave, siç janë, ligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligji i Hoçës së Madhe si dhe planin e veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas. Duhet të zhvillohen angazhimet e politikave realiste për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas përtej vitit 2015. Incidentet e sigurisë dhe krimet që shënjestrojnë pjesëtarët e pakicave dhe pronat e tyre, duhet të hetohen dhe të ndiqen penalisht në mënyrë të plotë dhe të menjëhershme.

2.3. Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare

Në lidhje me **krimet e luftës**, më 24 prill, Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar shkëmbimin e letrave ndërmjet Presidentes dhe Përfaqësueses së Lartë Ashton mbi mandatin e EULEX-it. Gjithashtu ka parashikuar zhvendosjen e procedurave të ndjeshme gjyqësore për të dëgjuar rastet që dalin nga hetimi i udhëhequr nga Task Forca Hulumtuese Speciale, që adreson pretendimet e raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës së vitit 2011. Ndryshimet në legjislacionin kyç, përfshirë edhe në Kushtetutë, duhet të miratohen nga legjislatura e re për të themeluar gjykatën speciale dhe zyrën e saj të prokurorisë. EULEX-i ka vazhduar të hetoj dhe të ndjekë penalisht krimet e luftës. Gjyqësori vendor ende nuk është në gjendje të ndjek plotësisht rastet e këtij lloji. Ka vazhduar bashkëpunimi me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të luftës.

Qeveria duhet të miratojë rregulloren e punës së grupit punues ndërministror për ballafaqim me të kaluarën dhe pajtim dhe duhet të miratojë një strategji për drejtësinë tranzicionale. Në përgjithësi, vazhdon të ketë mbështetje jo të mjaftueshme politike dhe një mungesë të mekanizmave të duhur për të mbledhur informacion relevant për hetimet në lidhje me krimet e luftës dhe personat e zhdukur. Frikësimi i dëshmitarëve vazhdon të jetë një shqetësim, edhe pse policia ka bërë progres të duhur në krijimin e drejtoratit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Fati i pazgjedhur i **personave të zhdukur** nga konfliktet e viteve 90-ta mbetet një shqetësim humanitar në Ballkanin Perëndimor. Situata e muajit gusht tregon se 11.155 persona janë ende të zhdukur sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK). Nga këto raste, 7282 raste kanë të bëjnë me konfliktin në Bosnjë dhe Hercegovinë, 2163 me konfliktin në Kroaci dhe 1710 me konfliktin në Kosovë. Zbulimi i fatit të personave të pagjetur mbetet jetik për pajtimin dhe stabilitet në rajon. Nevojitet angazhim më i madh politik si dhe përpjekje të reja.

Grupi i punës për personat e zhdukur, i kryesuar nga KNKK-ja, mbetet korniza në kuadër të së cilës Kosova ka ndjekur angazhimet dhe ka mbajtur dialog me Beogradin. Që nga tetori i vitit 2013, të dy delegacionet janë takuar tri herë. Zhvarrosjet në Rudnicë, Rashkë (Serbi) kanë filluar në muajin prill dhe janë kryer më 22 gusht 2014. Pritet që një numër i rasteve shtese të persona të zhdukur të zgjidhet këtë vit. Dorëzimi i mbetjeve të identifikuar njerëzore tek familjet në fjalë duhet të jetë i shpejtë dhe profesional.

Mungesa e informacionit mbi vendet e reja si dhe vështirësitë në identifikimin e mbetjeve të zhvarrosura mortore të njerëzve vazhdojnë të jenë pengesa kyçe. Mungesa e mbështetjes politike duket se e nënvizon faktin se asnjë informacion i ri mbi fatin dhe vendndodhjen e personave të zhdukur nuk është dhënë nga komisioni qeveritar për personat e pagjetur.

Delegacioni i Kosovës në grupin e punës duhet të angazhohet në mënyrë më proaktive.

Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) i Kosovës nuk ka kapacitet të plotë për të përmbushur standardet e kërkuara për praktika të qëndrueshme ligjore. Qeveria ka nevojë të rekrutojë dhe të zhvillojë ekspertizën e nevojshme. Nevojiten hapa konkrete për të identifikuar mbetjet mortore të ruajtura në morgun e Prishtinës. Duhet të ketë koordinim me të madh dhe më të mirë si dhe bashkëpunim në mes të Zyrës për Persona të Zhdukur dhe DML-së. Nevojiten përpjekje të veçanta për integrimin e stafit nga minoritetet jo-shqiptare në të dy departamentet. Miratimi i legjislacionit zbatues për krijimin e një regjistri qendror, dhe për mbylljen e rasteve, është një çështje urgjente.

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore formojnë një pjesë thelbësore të procesit të Kosovës drejt anëtarësimit në BE. Autoritetet e Kosovës kanë vazhduar të jenë aktive në këtë drejtim. Që nga muaji qershor, Kosova merr pjesë në Iniciativën Rajonale për

Migram, Azil, dhe Refugjatë. Kosova merr pjesë në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Kosova merr pjesë në një sërë takimesh rajonale në përputhje me marrëveshjet për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e saj rajonale rënë dakord mes Prishtinës dhe Beogradit në vitin 2012. Për shembull, Kosova merr pjesë në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal dhe është ftuar të marrë pjesë në mbledhjet e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës juglindore në të gjitha nivelet në mënyrë të përhershme dhe me kushte të barabarta. Megjithatë, formula e dakorduar nuk ka shpjer në përfshirjen e Kosovës në të gjitha organizatat dhe forumet rajonale.

Sa i përket **marrëdhënieve bilaterale me vendet tjera në zgjerim**, Kosova ka vazhduar të ketë marrëdhënie shumë të mira me *Shqipërinë*, me të cilën ka nënshkruar një deklaratë për bashkëpunim dhe partneritet strategjik me qëllim të nxitjes së rritjes ekonomike. Janë lidhur marrëveshje bilaterale në fushën e shëndetësisë, turizmit, kulturës, tatimeve, në përdorimin e pikave të përbashkëta doganore dhe kufitare, energjisë, në unifikimin e tregut të punësimit, në hapjen e zyrave të përbashkëta konsullore, dhe në fushën e bashkëpunimit për shfrytëzimin e *acquis-it* të përkthyer të BE-së në gjuhën shqipe.

Bosnja dhe Hercegovina nuk e ka ndryshuar qëndrimin e saj për njohjen e Kosovës. Vizat për qëndrim të shkurtër për shtetasit e Kosovës lëshohen vetëm me ftesë nga misionet e huaja diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Bosnjë dhe Hercegovinë, ose për arsye humanitare. Si një masë reciproke, Kosova ka vendosur një regjim të vizave për qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës që nga muaji janar. Në muajin gusht, Kosova ka bllokuar importet e ushqimeve me origjinë shtazore nga Bosnja dhe Hercegovina; në këtë drejtim, Kosova nuk duhet të vendosë kërkesa që shkojnë përtej atyre të pajtuara në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Bashkëpunimi me *ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë* ka vazhduar në bazë të një numri të madh të marrëveshjeve bilaterale. Marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të pensioneve dhe për forcimin e bashkëpunimit kulturor kanë hyrë në fuqi. Ishte ratifikuar një marrëveshje për hapjen e një pike të re kufitare të përbashkët në Belanovcë-Stanqiq.

Sa i përket *Malit të Zi*, është nënshkruar në muajin dhjetor një marrëveshje për njohjen e të drejtave të pensionit, ndërsa marrëveshjet për bashkëpunim policor, për hapjen e kalimeve të përbashkëta kufitare, për trafikun kufitar lokal, si dhe protokollet për patrullimin e përbashkët të kufirit dhe bashkëpunimit kufitar ishin nënshkruar në muajin mars. Komisioni i përbashkët për demarkacionin e kufirit vazhdoi punën e tij. Një protokoll për bashkëpunim në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore u nënshkrua në muajin prill.

Kosova ka mbajtur marrëdhënie shumë të ngushta me *Turqinë*.

Në përgjithësi, është arritur pak progres për krimet e luftës dhe për personat e zhdukur, sidomos sa i përket gërmimeve në Rudnicë, Rashkë (Serbi). Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur mbetet jetike për pajtim dhe stabilitet në rajon. Është i nevojshëm një angazhim më i madh politik dhe një angazhim proaktiv. Në lidhje me bashkëpunimin rajonal, Kosova ka bërë progres të mëtjshëm dhe ka mbajtur marrëdhënie të mira me fqinjët e saj. Kosova duhet të vazhdojë të jetë pragmatike dhe konstruktive në këto përpjekje. Duhet të finalizohet përcaktimi i kufirit me Malin e Zi.

3. KRITERET EKONOMIKE

Sa i përket ekzaminimit të zhvillimeve ekonomike në Kosovë, qasja e Komisionit është udhëzuar nga konkluzionet e Këshillit të Evropës në Kopenhagë në qershor të vitit 1993, e cila ka deklaruar se anëtarësimi në Bashkimin Evropian kërkon ekzistencën e një ekonomie funksional të tregut dhe kapacitet për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian.

Monitorimi i kritereve ekonomike duhet të shihet në kontekstin e rolit të rritur të qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit, siç është mirëpritur nga Këshilli për Çështje të Përgjithshme të datës 17 dhjetor 2013 dhe nga Konkluzionet e Këshillit të datës 18 shkurt 2008, ku Këshilli kërkoi nga Komisioni të përdor instrumente të komunitetit për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe politik për Kosovën.

3.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Edhe pse ekonomia e Kosovës shënoi rritje pa ndërprerje që nga viti 2001, shumica e rritjes së saj mund t'i atribuohet efekteve të ulëta bazë, pasi që burimet e vërteta të rritjes së qëndrueshme ende mungojnë. Pabarazitë e larta dhe të vazhdueshme të jashtme, të zbutura disi nga fluksi i konsiderueshëm i dërgesave të remitancave, shfaqin një bazë të dobët të prodhimit dhe mungesë të konkurrencës ndërkombëtare. Sektorin publik të Kosovës e karakterizojnë NP-të joefikase dhe shumë të subvencionuara si dhe vendimmarrja ad hoc. Megjithëse janë miratuar masat e tilla si futja e rregullores fiskale, mekanizmat e tyre përforcuese mbeten ende të dobëta. Tregu i punës karakterizohet me pjesëmarrje të ulët dhe norma të larta të papunësisë. Pjesa e mëdha e rinisë, të papunësuar afatgjatë dhe të pakualifikuar tregon një ngurtësi të thelle strukturore. Ekonomia e përhapur joformale, sundimi i dobët i ligjit dhe mungesa e parashikueshmërisë fiskale mbeten pengesa të mëdha për të bërë biznes dhe në përmirësimin e konkurrencës dhe produktivitetit në ekonomi. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të zhvilluar një sektor konkurrues privat dhe për të vendosur qëndrueshmëri fiskale.


Politika ekonomike

Ne përgjithësi është ruajtur konsensusi mbi thelbet e politikave kyçe ekonomike, edhe pse mospajtimi mes koalicionit qeverisës dhe opozitës për procesin e privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), çoi në një qorrsokak dymujor në Kuvend dhe po ashtu vonoi miratimin e buxheti të qeverisë për vitin 2014. Përpjekjet për t'i zhvilluar marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare financiare ishin të qëndrueshme. Banka Evropiane e Investimeve ri-filloi operacionet e saj në gjysmën e dytë të vitit 2013 dhe Kosova u bë anëtare e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës në nëntor të vitit 2013. Marrëveshja parandaluese 20-mujorëshe e FMN-së (SBA) u mbyll me sukses në dhjetor të vitit 2013. Plani i buxhetit të vitit 2014 ishte i pari që u hartua në përputhje me rregulloren fiskale. Megjithatë, vendimi i qeverisë para zgjedhjeve në mars të vitit 2014 për t'i rritur pagat, pensionet dhe përfitimet tjera në nivele shumë më të larta se sa ishte parashikuar në buxhetin fillestar ka ndryshuar strukturën e shpenzimeve në kurriz të rritjes-përmirësimit të shpenzimeve kapitale dhe ka ngritur pyetje në lidhje me transparencën dhe kredibilitetin e politikës fiskale. ***Në përgjithësi, ndjekja e politikave ekonomike të orientuar në treg është ngadalësuar dhe parashikueshmëria e politikave ekonomike është dobësuar si rezultat i politik-bërjes ad hoc.***

Stabiliteti makroekonomik

Në vitin 2013 u shënuar një rritje ekonomike prej 3.4% nga 2.8% sa ishte në vitin 2012, e nxitur nga konsumi privat dhe përmirësimi marginal i eksporteve neto, me një kontribut të papërfillshëm nga investimet. Për shkak të performancës më të mirë ekonomike të vendeve kryesore të diasporës, remitencat më të larta kanë mbështetur konsumin privat. Kontributi pozitiv i eksporteve neto ishte ndikuar nga kërkesa e brendshme e ulet sesa nga përmirësimi në konkurrencën ndërkombëtare, pasi që importet janë kontraktuar në mënyre të ndjeshme.

Figura 1: BPV-ja reale dhe papunësia




Një bazë e ngushtë dhe ndërkombëtarisht jo konkurruese e prodhimit, infrastruktura e mangët, sidomos në sektorin e energjisë, dekurajimi i mjedisit të biznesit dhe boshllëqet e konsiderueshme të kualifikimeve në tregun e punës kanë penguar krijimin e vendeve të punës, pavarësisht rritjes së vazhdueshme pozitive. BPV-ja për kokë banori⁴ arriti vlerën e 2800 € në vitin 2013, e barabartë me 11% të mesatares së 28 vendeve anëtare të BE-së.

Në përgjithësi, rritja ekonomike e Kosovës është përsheptuar, por mungojnë burimet afatgjata të qëndrueshme të rritjes.

Llogaritë e jashtme janë përmirësuar në vitin 2013, por kanë mbete shumë të zbalancuara. Deficiti i llogarisë aktuale u ngushtua në 6.4% të BPV-së, 1.1 pikë të përqindjes më e ulët sesa që ishte në vitin 2012.

Deficiti tregtar ishte ulur në 31.6% të BPV-së (2.5 pikë e përqindjes më e ulët se në vitin 2012) si rezultat i kontraktimit të importeve për shkak të kërkesës së dobët të brendshme, çmimeve më të ulëta të energjisë dhe për shkak të rritjes deri diku të eksporteve të mallrave. Shqetësimet se ngushtimi i deficitit tregtar ishte vetëm i përkohshëm e jo i natyrës strukturore janë përforcuar në vitin 2014 pasi që eksportet e mallrave janë ulur për 0.4% dhe importet janë rritur për 1.2% duke rritur kështu me 1.4% deficitin tregtar në shtatë muajt e parë të vitit.

Figura 2: Pozita e jashtme



Remitencat e punëtorëve u rriten për 6.4% dhe së bashku me transferet aktuale më të larta në sektorin jo-qeveritar kanë ndihmuar në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Financimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse varet kryesisht nga investimet e huaja të drejtpërdrejta neto, të cilat arritën në 4.5% të BPV-së, nga 4.2% të BPV-së sa ishte në vitin 2012. Pasiguria ekonomike, forcimi i kreditit, dhe rritja e investimeve jashtë vendit çoi në një rrjedhje neto të portfolios dhe investimeve tjera në 2.9% të BPV-së në krahasim me hyrjen e 3.6% të BPV-së në vitin 2012. Gabimet dhe lëshimet neto, edhe pse janë përmirësuar ndjeshëm (1.3 pikë përqindje më e ulët se sa në vitin 2012), qëndroi në 3.4% të BPV-së por ende mbulon një pjesë të konsiderueshme të deficitit të përgjithshëm të llogarisë rrjedhëse. *Në përgjithësi, pavarësisht përmirësimeve në deficitin tregtar, kanë vazhduar të jene prezentë pabarazitë w konsiderueshme, kryesisht për shkak të një bazë të dobët të prodhimit.*

⁴Masa që përdor standardet e fuqisë blerëse nuk është në dispozicion për Kosovën

Sipas anketës së fuqisë punëtore të vitit 2013, shkalla e pjesëmarrjes në punë nga ana e popullsisë në moshë pune u rrit në një masë, por ende mbetet në nivel të ulët që është i papranueshëm në 40.5%, duke treguar mundësi të kufizuara të punësimit, së bashku me të ardhura të ulëta të kapitalit njerëzor.

Papunësia ka rënë paksa në 30%, por mbetet më e larta në Evropë. Numri i përgjithshëm i punëkërkuarve të regjistruar megjithatë u rrit për 3.1% në vitin 2013 dhe me 1.5% në Qershor të vitit 2014. Pjesa e punëtorëve të pakualifikuar në mesin e totalit të papunësuarve (57.2% në qershor të vitit 2014), tregon një nevojë urgjente për politika më aktive të tregut të punës, skema të para-kualifikimit dhe trajnime profesionale. Në dhjetor të vitit 2013 u miratua ligji për Agjencinë e Punësimit (detyra kryesore e të cilit është përcaktuar si zbatues i politikave të punësimit dhe aftësimit profesional). Megjithatë, nuk ka pasur alokim të buxhetit për këtë agjenci për vitin 2014. Statistikat lidhur me tregun e punës kanë mbetur të papërshtatshme dhe të vjetruara, duke penguar një analizë të shëndoshë të situatës.


Në përgjithësi, ka pasur përpjekje të kufizuara për të përmirësuar kushtet e tregut të punës. Duhet të bëhen më shumë përpjekje dhe financim për mbështetjen e politikave aktive të tregut të punës, të cilat mbetën të pamjaftueshme, dhe gjenerimin e të dhëna të mjaftueshme për punësimin.

Fushëveprimi i mjeteve të politikës monetare është i kufizuar, pasi që Kosova përdor euron si valutë ligjore, pa qasje në lehtësimet e Bankës Qendrore Evropiane. Totali i aseteve të sistemit financiar, (me përjashtim të aseteve të Bankës Qendrore të Kosovës) u zgjerua për 10.5% dhe ka arritur 83% të BPV-së në vitin 2013 nga 78% të një viti më parë. Për shkak të rënies së kërkesës dhe standardeve më të forta bankare, rritja e kredisë u ngadalësua deri në 2.4% në fund të vitit 2013 nga 3.8% sa ishte një vit më parë. Rritja e depozitave ka vazhduar në një normë prej 8.3%. Raporti kredi - depozita ka rënë nga 77.4% në vitin 2012 në 73.7% në vitin 2013 duke u drejtuar tek fushëveprimi i rëndësishëm për ndërmjetësim më të thellë financiare dhe në bollëk të likuiditetit në sektorin bankar. Norma mesatare e interesit të kredive dhe depozitave ka rënë gjatë viteve 2013 dhe 2014, duke arritur në 10.8%, përkatësisht 0.7% në korrik të vitit 2014.

Norma mesatare vjetore e inflacionit vazhdoi të jete e moderuar në 1.8% në vitin 2013, për shkak të çmimeve të ushqimit dhe të energjisë. Inflacioni bazë (jo-ushqimor, jo-energjia) ka mbetur e pandryshuar në 1.2%. Trendi i disinflacionit vazhdoi në vitin 2014, duke e ulur normën vjetore të inflacionit në 1% deri në muajin gusht.

Edhe pse performanca fiskale është përkeqësuar në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012, deficitin buxhetor mbeti nën planin fillestar dhe qëndroi në 3.1% të BPV-së. Të ardhurat totale pësuan rënie për 0.7%,

Figura 3: Zhvillimet fiskale



pasi që të ardhurat nga taksat kufitare janë kontraktuar, për shkak të vëllimit të ulët të importeve, si dhe burimeve tjera vetanake të të ardhurave joperformuese (taksat administrative, gjobat dhe dënimet, tarifatat e pjesëmarrjes, licencat etj) Shpenzimet e përgjithshme u rriten për 1.6%, pasi që ulja e shpenzimeve kryesisht në kurriz të shpenzimit kapitalë që nuk lidhen me autostradën kanë zhvendosur efektin e rritjes së shpenzimeve rrjedhëse. Si rezultat, shpenzimet kapitalë që nuk lidhen me autostradën kanë qëndruar në pothuajse 25% nën nivelin e tij të parashikuar. Shpenzimet kapitalë kanë pësuar rënie në 9.9% të BPV-së nga 10.9% e BPV-së në vitin 2012.

Për të financuar një pjesë të deficitit, dhe për të përfituar nga likuiditeti i tepërt në sektorin bankar, qeveria vazhdoi lëshimin e bonove vendase të thesarit me maturim progresivisht më të gjatë. Në mars të vitit 2013, për here të pare janë lëshuar bonot me maturim dyvjeçar. Kështu, raporti i tërësishëm i borxhit publik (i brendshëm dhe i jashtëm) u rrit për 0.8 pikë të përqindjes në 8.9% të BPV-së në fund të vitit 2013 sipas të dhënave kombëtare. Pasi që privatizimi i PTK-së nuk u materializua, që në mënyrë efektive i hoqi qeverisë afro 277 milionë euro, deficitin buxhetor është financuar pjesërisht përmes tërheqjes së depozitave të qeverisë, të cilat ishin reduktuar në 2.9% të BPV-së, në nivelin e tyre më të ulët që nga viti 2008, dhe ishin më ulëta se 4.5% e pagut të nënkuptuar të BPV-së nga rregulla fiskale.

Buxheti i vitit 2014 do të ishte buxheti i pari i rregulluar sipas rregullës së re fiskale që kufizon deficitin e përgjithshëm në 2% të BPV-së. Megjithatë, në muajin mars, qeveria miratoi një vendim për të rritur pagat e të gjithë shërbyesve civilë dhe pensionet sociale me 25% (dhe për minatorët e pensionuar të Trepçës për 50%) e ndjekur nga iniciativat e shpenzimeve për ish të burgosurve politikë dhe veteranët e luftës. Këto rritje në paga dhe pensione, në mënyrë të konsiderueshme më të larta se sa janë parashikuar në buxhetin e miratuar, duhet të financohen nga shtesat e pagave, shkurtimet në shpenzimet për mallra dhe shërbime, dhe duke i ri-caktuar fondet e dedikuara për reformën e shërbimit civil. Pasi që financimi i këtyre iniciativave mbështetet në një masë të konsiderueshme mbi efektet e njëhershme, në kurriz të vonimit të reformave të rëndësishme, ajo ngre shqetësime lidhur me akumulimin e borxheve të qeverisë dhe rritjen e deficitit qeveritar në të ardhmen.

Këto masa mund të dëmtojnë konkurrencën e çmimeve të Kosovës duke ngritur kostot e punës në të gjithë ekonominë.

Në përgjithësi, stabiliteti makroekonomik dhe fiskal ishte ruajtur në vitin 2013, por modeli i paekuilibruar i politikave të pagave të sektorit publik me rritje të mëdha ad hoc që zakonisht ndodhin në vitet zgjedhore përkeqëson rëndë transparencën, parashikueshmërinë dhe besueshmërinë e politikës fiskale, e komplikon planifikimin fiskal dhe ndërron përbërjen e shpenzimeve drejt shpenzimeve të zhvillimit më të vogël. Rregulli fiskal duhet të forcohet me mekanizma më të rrepta të zbatimit për të shmangur një përsëritje të mbishpenzimeve para-zgjedhore në të ardhmen.

Ndërveprimi i forcave të tregut

Pjesa e sektorit privat në BPV ka mbetur e pandryshuar në rreth 70% në vitin 2013. Në mes të kritikave të korrupsionit dhe mungesës së transparencës në shitjen e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) vazhdon të zbatojë mandatin e vet në përshpejtimin e shitjes dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e saj. Në vitin 2013, AKP-ja finalizoi vetëm dy procese të likuidimit dhe gjashtë procese tjera të likuidimit në vitin 2014 (deri në muajin mars). Pas një përpjekje të dështuar, dhe disa vonesave në vitin 2013, privatizimi i PTK-së u anulua në dhjetor të vitit 2013, mes akuzave të shumta për korrupsion dhe kundërshtim të shtuar nga ana e disa partive të opozitës dhe shoqërisë civile. Për më tepër, aftësia e AKP-së për të vepruar në mënyrë efikase dhe në përputhje me mandatin e tij u sollën në dyshim, kur deri në gusht të vitit 2014 një seri e dorëheqjeve të anëtarëve të bordit dhe përfundimet e mandateve, të cilat nuk janë adresuar në mënyrë adekuate nga Kuvendi i Kosovës, kanë rezultuar në mungesën e një kuorumi të bordit.

Në mesin e ndërmarrjeve të menaxhuara nga qendra, vetëm Korporata Energjetike e Kosovës dhe PTK-ja kanë vazhduar të operojë me një fitim në vitin 2013. Subvencionet për ndërmarrjet publike (NP) në fushën e importeve të energjisë, ngrohjes qendrore, transportit dhe ujit arritën në 0.5% të BPV-së, një ulje prej 0.25 përqind krahasuar me vitin 2012. Kontrolli dhe rregullimi qeveritar i çmimeve të shërbimeve për energjinë elektrike, ngrohjen qendrore, furnizimin me ujë dhe menaxhimin e mbeturinave, dhe post-telekomunikacionit, nëpërmjet agjencive të pavarura mbeti i pandryshuar.

Në përgjithësi, është arritur progres shumë i kufizuar në privatizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve në portofolin e AKP-së. Dështimi i privatizimit të PTK-së dhe pasiguria ligjore rreth AKP-së ngre shqetësime lidhur me të ardhmen dhe transparencën e agjendës së privatizimit. Disa përmirësime marginale janë ilustruar nga reduktimi i subvencioneve për NP-të.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Rregulloret e miratuara në vitin 2013, dhe themelimi i zyrave për shërbim të qytetareve kanë reduktuar kohën e nevojshme për regjistrimin e kompanisë për një ditë për bizneset individuale, dhe në tri ditë për kompanitë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare. Kosova do të përfitojë nga adresimi i pengesave tjera të shumta për zhvillimin e sektorit privat, siç është kapaciteti i dobët administrativ, mungesa e qasjes në financa, infrastruktura e pazhvilluar sidomos në furnizim me energji elektrike, sundimi i dobët i ligjit, ekonomia e gjerë joformale dhe edukimi i pamjaftueshëm profesional. Gjatë vitit 2013, numri i bizneseve të reja të regjistruara ka rënë për 1.8% në 9421, ndërsa numri i daljeve nga tregu u rrit për 28% në 1508 në krahasim me vitin e kaluar. Numri i përgjithshëm i bizneseve aktive të regjistruara ishte 68309 në shtator të vitit 2014. ***Në përgjithësi, përveç disa përparimeve në thjeshtimin e regjistrimit të biznesit, zhvillimi i sektorit privat vazhdon të pengohet nga pengesa të shumta.***

Sistemi ligjor

Korniza bazë ligjore për blerjen e pasurive të paluajtshme nga të huajt është në përputhje me rregullat e BE-së. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rishikuar kodin civil, dhe praktikat administrative janë ende një pengesë për trajtim të barabartë. Sa i përket zbatimit të marrëveshjeve në kuadër të dialogut Prishtinë-Beograd, të gjitha kopjet e certifikuara të librave të regjistrimit civil që gjendeshin në Serbi i janë dorëzuar Kosovës. Legjislacioni i kërkuar për të zbatuar marrëveshjen për kadastrë ende duhet të miratohet. Megjithëse procedurat e shpronësimit zbatohen në mënyrë të kënaqshme, autoritetet nuk kryejnë konsultime të duhura me pronarët e zhvendosur të pronave. Sistemi gjyqësor ka vazhduar të vuaj nga qasshmëria e dobët, jo-efikasiteti, vonesa dhe nga numri në rritje i rasteve të pazgjydhura. ***Në përgjithësi, edhe përkundër progresit të bërë në regjistrin civil dhe në të dhënat kadastrale, korniza gjyqësore, dhe sidomos zbatimi i saj, mbetet i pakënaqshëm. Sigurimi i një sistemi funksional të gjyqësorit mbetet një detyrë e rëndësishme. Kapaciteti i dobët institucional për zbatimin ligjor, vonesat në gjykata dhe korrupsioni i përhapur kanë vazhduar të pengojnë mjedisin e biznesit.***

Zhvillimi i sektorit financiar

Sistemi financiar i Kosovës dominohet nga sektori bankar, i cili mban 72.3% të totalit të aseteve të sektorit financiar. Ritmi i shpejtë i rritjes së aseteve të bankave të vogla ka kontribuar në rënie të shkallës së përqendrimit të sektorit. Likuiditeti dhe kapitali mbulues i sektorit bankar janë forcuar më tej dhe mbetet në nivel më të lartë se kërkesat e tyre minimale rregullative. Nga ana tjetër, raporti i kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive është rritur në 8.2% deri në korrik të vitit 2014, krahasuar me 7.5% në fund të vitit 2012. Rritja kishte pjesërisht të bënte me ngadalësimin e rritjes së kredive dhe rritjen relativisht të ulët në dy vitet e fundit, e cila si rezultat ka ndikuar në kapacitetin e huamarrësve për t'i shlyer kreditë. Futja e lajmëruar e kodeve SWIFT dhe IBAN për të gjitha llogaritë bankare në bankat e Kosovës, në vitin 2015, duhet të mundësoj transfere më të lehtë dhe më të sigurta të parave, transparencë të plotë dhe një luftë më të efektshme kundër pastrimit të parave.

Në përgjithësi, shtrëngimi i standardeve të kredisë, së bashku me politikat e bankave të huaja drejt rritjes së raportit të kapitalizimit të bankave amë dhe rënies së kërkesës për kredi të ndërmarrjeve ka ngadalësuar aktivitetin e përgjithshëm të kredisë, dhe ka kontribuar në ruajtjen e pozitës së mire të likuiditetit pavarësisht nga rritja e raportit të kredive jo-performuese.

3.2. Kapaciteti për tu përballuar me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

Kapitali njerëzor dhe fizik

Është bërë përparim shumë i kufizuar në përmirësimin e cilësisë së sektorit të arsimit. Shpenzimet totale publike në arsim kanë pësuar një rënie të lehtë, me 0.1 pikë përqindje, në 3.8% të BPV-së në vitin 2013, që është ende më pak se mesatarja për vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme (4.3%). Përpjekjet për të adresuar qartë mospërputhjen e aftësive në tregun e punës janë bërë kur një kornizë ligjore për themelimin e Agjencisë për Arsim dhe Trajnim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve u vu në funksion. Megjithatë agjencia ende nuk është funksionale. Është zhvilluar një plan veprimi dhe një kornizë për sigurimin e cilësisë për të monitoruar cilësinë dhe performancën e shkollave të arsimit dhe aftësimit profesional. Për më tepër, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, një institucion publik i pavarur rregullativ përgjegjës për monitorimin e trajnimit dhe vlerësimit të instituteve ka vendosur procedura për validim dhe akreditim. ***Në përgjithësi, financimi i pamjaftueshëm, niveli i ulët i bashkëpunimit në mes të shkollave dhe ndërmarrjeve profesionale për të kryer mësimin praktik dhe vonesat në zbatimin e politikave për të siguruar aftësitë e kërkuara nga tregu i punës mbeten si probleme më të mëdha.***

Në vitin 2013, investimi i përgjithshëm shënoi rënie dhe mbeti në 27.6% të BPV-së (nga 29% e BPV-së sa ishte në vitin 2012) me rritje të pjesës private pasi që qeveria ka kontraktuar investimet e saj jo të lidhura me autostradë. Ndërtimi i autostradës për Tiranë ka përfunduar dhe punimet përgatitore për autostradën e re të Shkupit kanë filluar në korrik të vitit 2014. Investimet në rrjetet e transmisionit dhe shpërndarjes kanë përmirësuar stabilitetin e rrjetit dhe kanë reduktuar humbjet teknike. Ndërprerjet e energjisë janë bërë më të rralla, por një shpërthim në termocentralin që është shumë ndotës “Kosova A” në qershor të vitit 2014 rezultoi në një mbyllje të përkohshme të operacioneve të saj duke shkaktuar pasiguri shtesë në furnizim me energji elektrike. Gati gjysma e të gjithë investimeve të huaja të drejtpërdrejta shkoi në sektorin e patregtueshëm, në veçanti në pasuri të patundshme dhe në ndërtimtari, ndërsa pjesa e IHD-ve e synuar në prodhimtari ka rënë në vetëm 7% (nga 14% në vitin 2012). Nuk kishte asnjë investim në zonën e gjelbër (të pazhvilluar). ***Në përgjithësi, progresi ka qenë shumë i kufizuar në përmirësimin e kapitalit fizik përveç infrastrukturës rrugore. Prioritet më i lartë duhet t'i kushtohet sektorëve siç janë arsimi, eficientia e energjisë dhe distribuimi i ujit. Rrjedhja e IHD-ve, në shkallë të madhe, duket se financon konsumin më tepër sesa investimin i cila mund t'i jepte një ekuilibër problemeve të pagesave në të ardhmen.***

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Sektori privat i Kosovës duket të jetë i fragmentuar dhe me pamundësi që të përfitoj nga fitimet efikase të sjella nga eksplorimi i ekonomive të rangut të NVM-ve me më pak se 250 punonjës, të cilët llogariten të përbëjnë 97% të punësimit në përgjithësi. Tregtia me shumicë dhe pakicë vazhdon të jenë sektor dominant, me një pjesëmarrje prej 30.3% të të gjitha ndërmarrjeve të reja, e ndjekur nga sektori i shërbimeve dhe i pasurive të patundshme, me rreth 20%. Sektori i madh joformal i stimuluar nga dobësitë e politikave të taksave dhe zbatimi i ligjit vazhdon të pengoj konkurrencën e lirë dhe të dëmtoj mjedisin e biznesit. Po ashtu kjo pengon edhe përmirësimet në produktivitet duke kufizuar qasjen e sipërmarrësve në kapital, në tregje më të gjera dhe në teknologji. ***Në përgjithësi, sektori privat i Kosovës mbetet i pazhvilluar. Ekonomia e madhe joformale, qasja e ulët në financa dhe kostoja e saj e lartë vazhdojnë të paraqesin sfida të mëdha. Zvogëlimi i pjesës së ekonomisë joformale ende mbetet një sfidë.***

Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri

Qeveria ka zgjeruar skemën e granteve të përbëra nga pagesat e shoqëruara në sektorin e bujqësisë. Përveç skemave që kanë ekzistuar më parë, janë futur edhe pagesat e drejtpërdrejta

për bujqësi. Janë prezantuar skemat e granteve bashkë-financuese për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, me një vlerë totale prej 1 milion €. Në vitin 2014, qeveria shpalli tri zona të reja të lira ekonomike (Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Prizren). Megjithatë, kjo është bërë pa planin e kërkuar kombëtar dhe në baza ad hoc. Organizimi institucional për të kontrolluar, miratuar dhe monitoruar skemat ekzistuese dhe të planifikuara të ndihmës shtetërore ende nuk janë krijuar dhe nuk ka inventar të skemës së ndihmës shtetërore në dispozicion. Autoriteti përgjegjës i Konkurrencës për krijimin dhe sigurimin e një mjedisi konkurrues ende nuk është funksional. Në qershor të vitit 2013, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka lansuar një studim të fizibilitetit mbi skemën e garancisë së kredisë me qëllim të ofrimit të kredive për biznese me norma interesi të subvencionuara. Megjithatë, procesi i zbatimit ende nuk ka filluar për shkak të disa vonesave. ***Në përgjithësi, ndërhyrja e shtetit në ekonomi mbetet e lartë. Nuk ka pasur progres sa i përket kapaciteteve institucionale për të kontrolluar ndihmën shtetërore pasi që subvencionet janë ende duke u dhënë pa një strategji dhe vlerësimi të duhur. Autoriteti i Konkurrencës duhet të funksionalizohet për të mundësuar progres drejt krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues.***

Integrimi ekonomik me BE-në

Disponueshmëria e Kosovës për tregti ka rënë në vitin 2013, pasi që tregtia totale qëndroi në 66.4% të BPV-së në krahasim me 70.4% të BPV-së në vitin 2012. Shtetet e BE-së dhe shtetet e CEFTA-s vazhdojnë të jenë partnerët kryesorë tregtarë me pjesëmarrje të tregtisë së përgjithshme prej 43.8 % respektivisht 28.5%. Vendet e BE-së mbeten investitorët më të mëdhenj të huaj në Kosovë, me një pjesëmarrje prej 35% të investimit të përgjithshëm.

Në përgjithësi, BE-ja vazhdon të jetë partneri më i madh tregtar dhe i investimeve të Kosovës.

4. Standardet Evropiane

Ky seksion shqyrton kapacitetin e Kosovës për përafrim gradual të legjislacionit dhe politikave të saj me *acquis-in* në fushat e tregut të brendshëm, politikave sektoriale dhe drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, në kontekstin e Procesit të Stabilizim Asocimit. Kjo gjithashtu analizon kapacitetin administrativ të Kosovës. Në çdo sektor, vlerësimi i Komisionit mbulon progresin e arritur gjatë periudhës raportuese si dhe përmbledh nivelin e përgjithshëm të përgatitjes së Kosovës.

4.1. Tregu i brendshëm

4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka bërë një progres gradual drejt zbatimit të strategjisë për lëvizjen e lirë të mallrave, e cila është miratuar në shkurt të vitit 2013. Kosova ka vazhduar me ristrukturimin e brendshëm të Ministrisë, e cila është përgjegjëse për koordinimin horizontal. Organet përgjegjëse për metrologji, akreditim, standardizim dhe mbikëqyrje të tregut janë shndërruar në agjenci. Divizioni për infrastrukturë të cilësisë në ministri jep udhëzime dhe mbështetje të politikave për të harmonizuar legjislacionin e Kosovës me *acquis-in* e BE-së. Niveli i personelit duhet të rritet në të gjitha agjencitë.

Për sa i përket **standardizimit**, gjatë periudhës raportuese, 1575 standarde Evropiane (EN) janë adoptuar si standarde të Kosovës duke e sjell numrin e përgjithshëm të standardeve në 6520. Standardet janë blerë zakonisht nga Organi i njohur i Standardeve Kombëtare të Shqipërisë dhe janë miratuar me anë të metodës së shkresës përcjellëse. Kosova nuk është anëtare e ISO-së (Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim) dhe as e CEN/CENELEC (Komisioneve evropiane për standardizim dhe Standardizim Elektroteknik). Rritja e ndërgjegjësimit në sektorin privat për përdorimin dhe rëndësinë e standardeve duhet të përmirësohet.

Në lidhje me **vlerësimin e konformitetit**, Kosova ka miratuar rregulloret në fushën e sigurisë

së lodrave, makinerisë, shënjimit të konformitetit dhe pajisjeve elektrike shtëpiake. Në fushën e sigurisë së përgjithshme të produkteve, në muajin nëntor, është miratuar rregullorja për sistemin e shpejtë të shkëmbimit të informacionit për produktet që përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve. Një rregullore mbi miratimet teknike për produktet ndërtimore është miratuar në muajin nëntor dhe kërkesat themelore për punimet e ndërtimtarisë janë miratuar në muajin maj. Procedura e njoftimit, rregullorja për shkëmbim të informacionit dhe njoftim të rregullave teknike, procedurat dhe standardet e vlerësimit të konformitetit janë miratuar dhe janë në përdorim që nga muaji prill.

Për sa i përket **akreditimit**, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës (DAK) është shndërruar në një agjenci. Vlerësimi i DAK-ut i kryer nga Bashkëpunimi Evropian për Akreditim në vitin 2012 ka identifikuar një numër çështjesh që nuk kane të bëjnë me konformitet të cilat tashmë janë adresuar. Deri më tani, nuk pasur ende një vlerësim të plotë të DAK-it. Katër trupa inspektuese, 22 laboratorë testues dhe një laborator i kalibrimi janë akredituar nga Drejtoria e Akreditimit të Kosovës. Një akreditim është tërhequr në periudhën raportuese për shkak të mos-konformitetit. Tarifat për akreditim shkojnë në buxhetin e përgjithshëm dhe nuk kanalizohen drejtpërdrejt në buxhetin e DAK-ut.

Në lidhje me **metrologjinë**, janë funksional laboratorët për masën, rrjedhën dhe vëllimin, matjen elektrike, metaleve të çmuar dhe termo-metrike. Agjencia e Metrologjisë ka përmirësuar kapacitetin e saj për të përmbushur funksionet e veta të mbikëqyrjes. Laboratorët për kohën dhe shpeshtësinë, si dhe për gjatësi dhe forcë, janë pjesërisht funksional. Në përgjithësi, niveli i kapaciteteve operacionale të laboratorëve duhet të ngritët për të përmbushur standardet e nevojshme të cilësisë.

Në lidhje me **mbikëqyrjen e tregut**, janë miratuar dy udhëzime administrative dhe janë ndërmarrë një numër i konsiderueshëm i inspektimeve nga inspektoratet e tregut. Disa mijëra mallra (duke përfshirë lodra, pajisje elektrike dhe mekanike si dhe pajisje sportive) janë konfiskuar për shkak të mos-përputhjes së tyre me kërkesat e sigurisë.

Mekanizmat e komunikimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut në Kosovë duhet të përmirësohen si dhe duhet të sqarohen procedurat në lidhje me zbatimin. Krijimi i Këshillit Kombëtar të Inspektimit është shtyrë për më vonë.

Sa i përket **mbrojtjes së konsumatorit**, Kosova ka miratuar dispozitat zbatuese për etiketimin, prezantimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore në mënyrë që të zbatohet ligjin e miratuar në vitin 2012.

Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit, i përbërë nga përfaqësuesit e qeverisë, të sektorit privat dhe organizatat e shoqërisë civile, është themeluar dhe mbledhet një herë në muaj. Ai është përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Programit Kombëtar për Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe këshillon mbi çështjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e tregut. Janë kryer një sërë aktivitetesh ndërgjegjësimi duke përfshirë edhe transmetimet në kanal televiziv publik (RTK) si dhe në radiostacione kryesore. Në periudhën raportuese, janë paraqitur 149 ankesa tek Departamenti i Mbrojtjes së Konsumatorit, nga të cilat 99 janë zgjidhur.

Në përgjithësi, Kosova ka vazhduar të përmirësojë harmonizimin e legjisllacionit të saj me acquis-in në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Kapaciteti i saj administrativ gjithashtu është përmirësuar, sidomos nëpërmjet riorganizimit të MTI-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për forcimin e kapaciteteve administrative në sigurimin e zbatimit të legjisllacionit, si dhe për të ofruar shërbime të vlefshme për industrinë. Koordinimi në mes të ministrive dhe agjencive të ndryshme duhet të përmirësohet.

4.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit

Sa i përket **lëvizjes së personave**, Kosova ka arritur një marrëveshje me Malin e Zi për periudhat e sigurimit mbi të drejtën për të përfutur nga të drejtat e pensionit.

Sa i përket **lirisë për të ofruar shërbime**, Kuvendi në nëntor të vitit 2013 miratoi ligjin mbi sistemin e licencave dhe lejes, duke vendosur rregulla të përgjithshme për lëshimin dhe certifikimin e lejeve dhe licencimin profesional. Është përmirësuar baza e të dhënave e vendosur në MTI për tregtinë e shërbimeve. Ligji horizontal për shërbime ende mbetet të miratohet dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për tu siguruar që legjislacioni sektorial nuk e shkel *acquis*-in në fushën e lëvizjes së lirë të shërbimeve.

Në lidhje me *shërbimet postare*, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka miratuar listën e çmimeve për shërbimet postare universale për tregun ndërkombëtar dhe atë të Kosovës. Dy operatorët të shërbimeve postare janë licencuar në vitin 2014.

Lidhur me *njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale*, vetëm katër profesione (kontabilistë, arkitektë, inxhinierë dhe juristë) aktualisht janë të rregulluara me ligj. Kualifikimet e huaja profesionale janë të njohura përderisa ato janë të certifikuara nga një autoritet i akredituar në vendin e origjinës. Harmonizimi me *acquis*-in në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale dhe programeve të aftësimit profesional është në një fazë të hershme.

Në fushën e **shërbimeve financiare**, është miratuar Ligji për Letrat me Vlerë. Kosova ende duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me rregullat e tanishme për sigurimet dhe pensionet profesionale (Aftësia paguese I). Banka qendrore ka vazhduar rishikimin e legjislacionit ekzistues, duke përfshirë edhe vlerësimin e pajtueshmërisë me kërkesat e Basel II dhe III. Tregu për shërbime financiare është në një fazë të hershme të zhvillimit.

Sa i përket **ligjit për korporatat**, në dhjetor të vitit 2013, Kosova ka miratuar ligjin për investimet e huaja që mundëson trajtim të barabartë në mes të investitorëve të huaj dhe vendas dhe nuk ka diskriminim ndaj investitorëve të huaj në bazë të shtetësisë, prejardhjes, vendbanimit dhe vendit të themelimit të biznesit apo vendit të kontrollit. Regjistrimi i biznesit është thjeshtuar edhe më tej. Korniza ligjore për *kontabilitetin dhe auditimin e korporatave* është e dobët; kjo ndikon në kapacitetin e kompanive për të marrë kredi si dhe ngadalëson zhvillimin e tregut financiar. Kosova ka nevojë të harmonizoj kërkesat që kanë të bëjnë me kontabilitetin dhe raportimin sipas standardeve ndërkombëtare.

Në përgjithësi, në këtë fushë ka pasur një progres të përzier. Harmonizimi me standardet evropiane në fushën e lëvizjes së personave, shërbimeve dhe në të drejtën e themelimit, si dhe ligji mbi korporatat mbeten në një fazë të hershme. Kosova duhet të përqendrohet në analizën e mangësive dhe në harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me *acquis*-in e BE-së, në veçanti në fushën e lëvizjes së lirë të shërbimeve. Kosova duhet të miratojë dhe të zbatojë legjislacionin mbi raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e korporatave. Kjo do të kontribuojë në rritjen e saj ekonomike.

4.1.3. *Lëvizja e lirë e kapitalit*

Në Kosovë, **lëvizjet e kapitalit** janë liberalizuar në masë të madhe. Rregulloret për mbikëqyrjen e institucioneve mikro-financiare janë miratuar në shtator të vitit 2013. Këto rregullore adresojnë boshllëqet në kornizën legjislative. Numri i bankave me pronësi të huaj në tregun bankar të Kosovës ka mbetur i njëjtë, me nëntë banka të huaja që kontrollojnë pothuajse 90% të sektorit bankar të Kosovës. Sa i përket blerjes së pasurive të patundshme, duke përfshirë edhe blerjen e tokës nga personat që nuk janë shtetas të Kosovës, korniza ligjore kushtetuese i mundëson të huajve të blejnë pasuri të patundshme. Megjithatë, dispozitat në ligjet sektoriale dhe praktikat administrative i parandalojnë ata nga ushtrimi i kësaj të drejte. Identifikimi i këtyre pengesave nga ana e Kosovës është në vazhdim e sipër dhe heqja e tyre do të ndihmojë në rritjen e investimeve të huaja.

Lidhur me **sistemin e pagesave**, janë miratuar dy rregullore, ajo për kliringun dhe funksionimin e llogarive për shlyerje si rregullorja për skemën e debitimit direkt të sistemit elektronik të kliringut ndërbankar, me qëllim të zbatimit të ligjit të miratuar në prill të vitit

2013. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të vazhduar harmonizimin me *acquis*-in në fushën e shërbimeve të pagesave. Në qershor të vitit 2013, SWIFT-i ka caktuar një kod shtetëror për Kosovën dhe në dhjetor të vitit 2013, Banka Qendrore e Kosovës është lidhur me SWIFT-in. Në muajin gusht, Kosovës i janë caktuar numrat e regjistrimit të formatit IBAN.

Sa i përket **luftës kundër shpëlarjes së parave** dhe financimit të terrorizmit, është bere progres i kufizuar. Në përgjithësi, strukturat legjislative dhe operative janë të vendosura, por mungojnë rezultate e dukshme në luftën kundër krimeve ekonomike dhe financiare.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres veçanërisht në lidhje me institucionet mikro-financiare. Lëvizjet e kapitalit mbeten kryesisht të lira, nuk ka kufizime në lidhje me pronësinë apo investimet e huaja në sektorin financiar dhe kapaciteti i bankës qendrore për mbikëqyrjen e këtij sektorit është i mjaftueshëm. Megjithatë, dispozitat në aktet administrative, aktet zbatuese si dhe procedurat administrative parandalojnë të huajt nga blerja e pasurive të patundshme. Kosova duhet të identifikoj këto pengesa dhe të filloj me mënjanimin e tyre.

4.1.4. Doganat dhe tatimet

Për sa i përket **doganave**, Kosova ka miratuar legjislacionin mbi procedurat e lehtësimit doganor dhe kundërvajtës. Administrata ka vazhduar të përmirësojë kapacitetin e saj administrativ dhe organizativ.

Administrata tatimore dhe ajo doganore kanë bashkuar departamentet e tyre hetimore. Kontrollat në kuadër të strukturës së re organizative janë strukturuar në janar për të parandaluar korrupsionin dhe për të lehtësuar tregtinë. Kjo qasje e re ka rezultuar në grumbullimin e një shume shtesë prej 18 milionë € në krahasim me tre muajt e parë të vitit 2013, pavarësisht ritmeve të reduktuara dhe tregtisë më të ulët. Marrëdhëniet në mes të doganës, institucioneve tjera të sundimit të ligjit dhe komunitetit të biznesit janë forcuar.

Në mes të 1 janarit dhe 31 korrikut 2014, Dogana e Kosovës hapi 18 raste të reja të hetimeve të brendshme që preku 50 anëtarë të stafit të saj. Sistemi i përpunimit të deklarimeve doganore (ASYCUDA) është plotësisht funksional dhe mbështet deklaratimet doganore pa përdorim të letrës, ka thjeshtuar procedurat dhe operacionet e transitit, edhe në pikat e kalimit kufitar në veri të Kosovës. Megjithatë, regjistrimi i tregtarëve në institucionet relevante të Kosovës në veri mbeten të ulëta. Kosova dhe Shqipëria u pajtuan të ndërmarrin veprime të përbashkëta për të luftuar tregtinë e paligjshme dhe për të lehtësuar tregtinë e ligjshme. Që nga muaji dhjetor, u bë operacional Sistemi Elektronik i Shkëmbimit Sistemik të të Dhënave (SEED) në mes të doganës së Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, ende ka mospërputhje në mes të Kodit Doganor dhe Akcizave me Kodin Penal i cili pengon luftën kundër krimit doganor. Vija kufitare mes Kosovës dhe Serbisë mbetet e ndjeshme ndaj aktiviteteve të paligjshme, duke përfshirë kontrabandën, veçanërisht në veri të Kosovës.

Në fushën e **tatimeve**, në muajin janar është miratuar strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe luftën kundër ekonomisë joformale, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit 2014-18.

Sa i përket kapaciteteve administrative dhe operacionale, administrata tatimore ka forcuar kapacitetin e saj administrativ, njerëzor dhe të TI-së. Shërbimet elektronike janë zhvilluar edhe më tej, duke përfshirë dorëzimin elektronik të aplikacionit për kthimin e tatimeve, verifikimin elektronik të tatimeve dhe pagesat elektronike të tatimeve së bashku me Qendrat e Regjistrimit të Biznesit (zyrat për shërbim të qytetarëve). Gjithsej 19070 biznese janë pajisur me arka/pajisje fiskale. Megjithatë, pasi që ekonomia joformale vlerësohet të përfaqësoj 30 deri 35% të BPV-së, administrata tatimore duhet të modernizoj platformën e saj të TI-së dhe procedurat e saj në mënyrë që të përmirësoj efikasitetin.

TVSH-ja dhe tatimi i korporatave përfaqësojnë gati 49% respektivisht 22% të të ardhurave tatimore. Të ardhurat totale të tatimeve të mbledhura nga administrata tatimore ishin 4% të BPV-së për vitin 2013. Në muajin dhjetor u miratua një plan i detajuar i reagimit ndaj rrezikut

për vitin 2014, me qëllim të rritjes së proporcionit të të ardhurave direkte tatimore. Edhe pse mbledhja e tatimeve direkte është rritur, ajo ende nuk është e qëndrueshme dhe në vitin 2013, borxhi tatimor mbetet shumë i lartë, me më shumë se 279 milion € e cila është 54% e totalit të të ardhurave të mbledhura. Mbledhja e tatimeve në veri të Kosovës bëhet në baza vullnetare. Janë ofruar kurse të trajnimit pa shkëputje nga puna si dhe kurse të brendshme për punonjësit e institucioneve dhe agjencive tjera të Kosovës. Në muajin dhjetor, mandati i Bordit të Pavarur Shqyrtues është zgjatur edhe për një vit, me qëllim të adresimit të rasteve të grumbulluara të procedurave administrative të apelit.

Në përgjithësi, ka pasur progres të kufizuar në dogana dhe në tatime. Legjislacioni doganor i Kosovës është kryesisht në përputhje me Kodin Doganor të BE-së. Megjithatë, mospërputhjet në mes të Kodit Doganor dhe Akcizave me Kodin Penal duhet të adresohen urgjentisht. Luftës kundër ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal duhet t'i jepet prioritet si dhe të rritet efikasiteti i tij në mënyrë të konsiderueshme, duke përfshirë këtu edhe veriun e Kosovës. Administrata tatimore ka nevojë për një platformë të re të TI-së për të përmirësuar performancën e saj. Autoritetet doganore dhe tatimore duhet të ndërmarrin hapa për të parandaluar çdo ndikim të tepruar politik mbi institucionet e tyre.

4.1.5. Konkurrenca

Sa i përket **anti-trustit dhe bashkimeve**, Ligji për mbrojtjen e konkurrencës është ndryshuar në muajin shkurt në mënyrë që të harmonizoj edhe me tej legjislacionin e Kosovës me *acquis-in* e BE-së. Janë ndryshuar dispozitat për bashkimet dhe blerjet, si dhe perkufizimi i abuzimit të pozitës dominuese dhe fushëveprimi për përjashtime në bllok.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) është riorganizuar dhe përfshin një trup vendimmarrës, Komisionin i Konkurrencës dhe Sekretariatit i tij, si organi administrativ dhe hetimor. Në vitin 2013, AKK-ja ka kryer hetime mbi marrëveshjet dhe ka dyshuar për shpërdorim të pozitës dominuese në fusha të ndryshme, duke përfshirë çmimet e biletave të transportit ndër-urban, tregut të çimentos dhe transmetuesve. Dy vendimet e AKK-së në rastet që kanë të bëjnë me sektorin e sigurimeve dhe sektorin e arkave fiskale janë parashtruar pranë gjykatës themelore në Prishtinë. Gjykata i fuqizoi vendimet e AKK-së dhe shqiptoi një gjobë prej 1.2 milion € për kompanitë e përfshira.

Komisioni i Konkurrencës nuk ka qenë funksional që nga nëntori i vitit 2013 për shkak të vonesave në emërimin e katër prej pesë anëtarëve të tij, mandati i të cilëve kishte përfunduar. Në mungesë të kuorumit (të paktën tre anëtarë) të Komisionit të Konkurrencës, AKK-ja nuk ka qenë në gjendje të përmbushë mandatin e saj. AKK-ja nuk ka staf adekuate dhe shumica e pozitave në strukturën organizative mbeten që të plotësohen. Stafit nuk ka trajnim të duhur, veçanërisht në hetimin e tregut. AKK-ja është e vendosur në ambientet e Kuvendit, gjë e cila vë kufizime serioze në aktivitetet e saj. Përveç plotësimit të nevojave të saj thelbësore, AKK-ja gjithashtu ka nevojë për sisteme adekuate të kontrollit të brendshëm dhe sisteme të informimit për të siguruar informacion cilësor në mënyrë që të mbështes vendim-marrjen e menaxhmentit dhe të siguroj që informacioni është i klasifikuar, regjistruar, mirëmbajtur dhe raportuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Ligji mbi ndihmën shtetërore, i miratuar në fillim të vitit 2013, kërkon ndryshime të mëtejshme për ta harmonizuar atë me standardet evropiane, në veçanti për të siguruar pavarësinë e Komisionit të Ndihmës Shtetërore. Komisioni i Ndihmës Shtetërore nuk ka shqyrtuar asnjë kërkesë në lidhje me ndihmën shtetërore edhe pse anëtarët e tij janë emëruar. Zyra e Ndihmës Shtetërore, e themeluar si departament i AKK-së ende nuk e ka stafin e mjaftueshëm në kuadër të saj.

Në të ardhmen priten që të bëhen emërimet, përderisa aktualisht zyrtarëve i'u mungon hapësira e duhur e punës. Si pasojë, Zyra nuk ka kapacitet për të kontrolluar skemat

ekzistuese të ndihmës. Ajo ende nuk merr informacione në mënyrë sistematike mbi skemat e ndihmës të dhëna nga administratat e tjera, qofshin ato qendrore apo lokale.

Në përgjithësi, ka pasur progres shumë të kufizuar në fushën e konkurrencës. Zbatimi i politikave anti-trust dhe të bashkimeve mbetet në një fazë të hershme dhe është më i dobët se sa në vitet e mëparshme. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ballafaqohet me sfida të konsiderueshme në aspektin e kapaciteteve hetuese dhe ato të vendimmarrjes. Ngjashëm, edhe politika e ndihmës shtetërore mbetet në një fazë shumë të hershme dhe nuk ka shënime për zbatimin e saj. Këto mangësi janë një shkak për shqetësim. Në funksion të një marrëveshje të ardhshme të Stabilizim Asociimit, nevojiten përpjekje të konsiderueshme në këto fusha. Çështjet që lidhen me personelin, objektet dhe trajnimet duhet të trajtohet si çështje prioritare.

4.1.6. Prokurimi publik

Në mars të vitit 2013, Kuvendi ndryshoi ligjin mbi prokurimin publik. Ligji i ri devijon nga *acquis*-i duke krijuar një preferencë prej 10 pikëve ndaj ofertuesve vendas në tenderët ku zbatohet kriteri i tenderit ekonomikisht më të favorshëm, dhe një preferencë e 15% të ofertuesve vendas në tenderët ku zbatohet kriteri i çmimit më të ulët të ofruar. Dispozitat zbatuese të këtyre ndryshimeve ende janë në pritje.

Gjatë periudhës raportuese, janë dhëne rreth 12 500 kontrata. Nga këto, pothuajse 90% e tyre u atribuohen procedurave të hapura. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) nuk ishte funksional që nga gushti i viti 2013 deri në mars të vitit 2014 kur Kuvendi emëroi anëtarët e rinj të bordit. Kuvendi nuk morri parasysh rekomandimin e Bordit të Pavarur Përzgjedhës, i cila kishte shqetësime lidhur me disa nga të emëruarit, duke përfshirë një hetimi aktual për korrupsion. Ndërkohë, pezullimi i operacioneve të OSHP-së ka krijuar vonesa të konsiderueshme dhe grumbullim të rasteve në procesim të ankesave. Nga 279 ankesa të paraqitura të operatorëve ekonomik në OSHP, derisa operacionet e saj ishin suspenduara, vetëm 24 janë shqyrtuar (pak më shumë se 8%), ndërsa 255 të tjera ishin hedhur poshtë, pasi që afati i fundit për procesimin e tyre kishte skaduar. Këto raste tani mund të trajtohen vetëm nga gjykatat e rregullta, të cilat gjithashtu hasin ne vonesa në gjykimin e lëndëve. Cilësia dhe transparenca e vendimeve të OSHP-së mbetet e diskutueshme.

Që nga rifillimi i operacioneve të saj, OSHP-ja ka pranuar 320 ankesa, nga të cilat 246 tashmë janë procesuar. Nga këto, 74 raste janë kthyer për rivlerësim, ndërsa në 52 raste, paneli shqyrtues vendosi të anulojë tërë procesin e tenderimit. Parregullsitë në dosjen e tenderit dhe në vlerësimet, konfirmojnë që specifikimet e paqarta teknike dhe kriteret e anuara të dhënies së kontratave vazhdojnë të jenë një çështje shqetësuese. Më shumë se tre vjet pas themelimit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), Ministria e Financave ende nuk ka miratuar listën e artikujve të përbashkëta që do të prokurohen, duke parandaluar kështu përmbushjen e mandatit kryesor të AQP-së. Drejtori i Agjencisë u emërua në qershor të vitit 2014. Në muajin prill u miratua nga Kuvendi raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013. Deri më tani, 5517 njoftime për dhënien e kontratës janë publikuar që nga tetori i vitit 2013. Në Kosovë janë 173 autoritete kontraktuese. Sistemi i trajnimit duhet të përmirësohet për t'iu mundësuar të gjithë zyrtarëve të prokurimit të përfitojnë nga aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve. Në maj të vitit 2013, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka filluar monitorimin ex-ante të njoftimeve të kontratave. Janë kontrolluar 289 njoftime që nga momenti i prezantimit të kësaj praktike.

Në përgjithësi, ka pasur progres shumë të kufizuar për prokurimin publik. Korniza ligjore është larguar nga standardet e BE-së me futjen e dispozitave të reja diskriminuese për ofertuesit e huaj. Prania e shumë subjekteve të përfshira në prokurim paraqet një rrezik të korrupsionit. Llogaridhënia dhe transparenca duhet të përmirësohet dhe korrupsioni duhet të adresohet në mënyrë efektive. Kapaciteti i të gjitha organeve të përfshira në sistemin e prokurimit duhet të forcohet. Sistemi i përmirësimit nuk ka qenë funksional dhe procedura e emërimit të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit ka ngritur shqetësime serioze.

Mos-procesimi i ankesave të parashtruara gjatë pezullimit të bordit ka ndikuar negativisht në besueshmërinë e sistemit të prokurimit.

4.1.7. *Ligji i pronësisë intelektuale*

Sa i përket të **drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta**, Ligji për të drejtat e autorit është ndryshuar dhe është harmonizuar edhe më tej me *acquis*-in. Megjithatë, ende kërkon dispozita zbatuese për skemat e kopjeve private dhe piraterisë digjitale. Task Forca e ngritur nga qeveria në vitin 2013 ka ushtruar aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ka konfiskuar disa mijëra mallra të falsifikuara. Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta ka personel të mjaftueshëm dhe është trajnuar për të kryer mandatin e saj. Ekzistojnë dy shoqata kolektive. Negociatat me transmetuesit mbi tarifatat nuk shpiten në një marrëveshje, pavarësisht përfshirjes së ndërmjetësve.

Në lidhje me të **drejtat e pronësisë industriale**, janë miratuar amendamentet në lidhje me patentat, dizajnet industriale dhe markat tregtare dhe janë harmonizuar edhe më tej me *acquis*-in. Korniza legjislative për treguesit gjeografike në përgjithësi është funksionale dhe Agjencia për Pronësinë Industriale ka pranuar aplikimet e para. Agjencia e Pronës Industriale tani ka më shumë personel, duke përfshirë një drejtor të ri, por ata ende kërkojnë trajnim adekuat për t'i kryer detyrat në mënyrë efektive dhe për të trajtuar ngarkesën aktuale të aplikacioneve të grumbulluara. Këshilli Kombëtar i Pronës Intelektuale u mbledh në muajin mars dhe ka më shumë se një vit që nga mbledhjen e tij e fundit.

Sa i përket **ekzekutimit**, një dhomë e veçantë në kuadër të departamentit tregtar të gjykatës themelore të Prishtinës është përgjegjëse për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë intelektuale. Dogana e Kosovës ka kryer operacione kundër mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale, si përgjigje ndaj kërkesave nga autorët e të drejtave dhe sipas detyrës zyrtare (ex-officio). Inspektorati i tregut po ashtu ka nisur edhe procedurën para gjykatës kompetente. Policia nuk ka një njësi të specializuar për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe ekspertiza e saj në këtë fushë është e kufizuar. Legjislacioni duhet të jetë e harmonizuar me rregulloren e re të BE-së për konfiskim, magazinim dhe shkatërrim të mallrave.

Në përgjithësi, korniza legjislative pjesërisht është në përputhje me *acquis*-in dhe nevojitet një veprim i mëtejshëm për të përafruar legjislacionin me zhvillimet e fundit në këtë sektor. Kosova duhet të fokusohet në ngritjen e burimeve njerëzore në ligjin për pronën intelektuale, përmirësimin e ekspertizës së tyre si dhe për koordinim në mes të autoriteteve zbatuese për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja në të ardhmen.

4.1.8. *Politikat e punësimit dhe ato sociale, politikat e shëndetit publik*

Sa i përket **politikave të punësimit**, duhet të miratohen Strategjia Sektoriale për Punësim 2014-2020 dhe plani i saj i veprimit.

Sipas anketës së fundit të Fuqisë Punëtore (AFP), Kosova vazhdon të përballet me një shkallë papunësisë prej rreth 30%, me një shkallë të ulët të pjesëmarrjes në tregun e punës dhe normë të ulët të punësimit, veçanërisht në mesin e femrave (respektivisht rreth 20% dhe 13%). Gati 70% e të papunëve janë të papunë afatgjatë. Shkalla e papunësisë në mesin e të rinjve të moshës 15-24 vjeçar është rreth 56%. Numri i të papunëve të regjistruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka mbetur i pandryshuar në rreth 270 000 persona, në gjysmën e parë të vitit 2014, një numër shumë më i lartë se sa ai i paraqitur nga AFP-ja. Numri i të diplomuarve universitar të papunë mbetet i lartë, që është 2.4% e numrit të përgjithshëm të punë kërkuësve të regjistruar, duke treguar një mospërputhje të konsiderueshme të aftësive. Shërbimi Publik i Punësimit ka ndihmuar në gjetjen e 4729 vendeve të punës për punë kërkuësit, nga të cilat 1590 për gjininë femërore. Numri i personave të trajnuar nga shërbimi i punësimit gjatë kësaj periudhe ishte 2093, prej të cilëve 945 (ose 45%) ishin femra. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur një rënie të lehtë në trajnim për shkak të mungesës së mbështetjes financiare në promovimin e punësimit.

Ligji mbi krijimin e Agjencisë së Punësimit është miratuar. Fondet për zbatimin e tij, që pritet të fillojë në vitin 2015, duhet të zotohen. Shërbimi Publik i Punësimit ka vazhduar me reformat e veta përgjatë vitit 2013. Sistemi Informativ për Menaxhim të Punësimit tani është i plotë dhe funksional në të gjitha zyrat e punësimit. Sistemi është integruar edhe në Administratën Tatimore të Kosovës. Kjo mundëson monitorimin e përmirësuar të statusit të personave në tregun e punës, administrimin e pagesave të ndihmës sociale dhe pozicionimin e atyre në nevojë në skemat përkatëse.

Kosova duhet të rrisë përpjekjet për aktivizimin e punëkërkuësve përmes masave aktive të tregut të punës për të reduktuar papunësinë strukturore. Buxheti për zgjerimin e masave aktive të tregut të punës ende mbetet i ulët dhe është i pamjaftueshëm për të adresuar nevojat në mënyrë efektive.

Në **politikat sociale**, zbatimi i Ligjit të punës mbetet i pakënaqshëm. Ligji duhet të ndryshohet, sidomos sa i përket kontratave të punës, pushimit të lehonisë, pushimit mjekësor dhe mbikëqyrjes së inspektoratit. Zbatimi efektiv i Ligjit për Shëndetësi dhe Sigurinë në Vendin e Punës është i nevojshëm për parandalimin e vdekjeve dhe lëndimeve të shumta në vendin e punës. Në vitin 2013, janë raportuar 54 aksidente në vendin e punës, nga të cilat 17 ishin fatale. Inspektorati i Punës duhet të reduktojë pjesën joformale të sektorit të ndërtimit në mënyrë më efikase.

Numri i inspektorëve të punës mbetet shumë i ulët. Vetëm 50 inspektorë mbulojnë zbatimin e ligjeve të punës, shëndetësisë dhe sigurisë në punë. Inspektorati i punës ka nevojë të forcohet më tej në aspektin e trajnimit, personelit dhe pajisjeve shtesë.

Në *dialogun social*, qeveria dhe Këshilli Socio-Ekonomik (KSE), kanë nënshkruar një Kontratë të Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila i përcakton të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve dhe të punëmarrësve. Nuk janë përfshi plane konkrete apo afate kohore për zbatimin e saj. Përfaqësimi i të punësuarve në kuadër të KSE-së nuk e ka mbështetjen e shumicës së sindikatave. Kriteret e zgjedhjeve dhe anëtarësimit duhet të ndryshohen, si dhe kapacitetet dhe funksionimi i KSE duhet të forcohet në mënyrë që të përmirësoj cilësinë e dialogut social.

Sa i përket *përfshirjes sociale*, Kosova duhet t'i japë përparësi më të madhe masave aktive të tregut të punës që shënjestrojnë grupet më të rrezikuara, duke përfshirë edhe masat e ndërlydhura me decentralizimin e shërbimeve sociale. Monitorimi i rregullt i cilësisë dhe ndikimit të këtyre masave është i nevojshëm.

Për *mbrojtjen sociale*, licencimi i ofruesve individual të shërbimeve sociale dhe familjare ka vazhduar si dhe kanë filluar përgatitjet për licencimin e subjekteve juridike/organizatave. Është miratuar Ligji për Skemat Pensionale të financuara nga shteti. Skemat e Mbrojtjes Sociale kanë ndikim të kufizuar në uljen e varfërisë për shkak të kufizimeve buxhetore. Decentralizimi i shërbimeve sociale ende nuk zbatohet plotësisht ose në mënyrë efektive nga komunat dhe formula e buxhetit për decentralizim, e zhvilluar në vitin 2012, ende nuk është funksionale. Grandet e dedikuara për të gjitha shërbimet sociale në buxhetet komunale duhet të alokohen për të siguruar mjete për decentralizimin efektiv të shërbimeve sociale. Koordinim më i mirë ndër-ministror i veprimeve dhe alokim të resurseve është i nevojshëm për të siguruar shërbimet efektive sociale.

Për *mundësit e barabarta*, dispozitat e pushimit të lehonisë në Ligjin e Punës duhet të zbatohet në mënyrë që të eliminohet diskriminimi ndaj gruas në vendin e punës. Kjo është konsideruar të ketë ndikim negativ në punësimin e grave, veçanërisht në sektorin privat. Agjencia për Barazi Gjinore duhet të përpilojë një raport mbi zbatimin e programit për barazinë gjinore (2008-13) para hartimit të programit të ri për vitin 2014 e tutje. Ligji për Barazi Gjinore duhet të ndryshohet dhe të miratohet si pjesë e të ashtuquajturës pako e ligjit

për të drejtat e njeriut. (*Shih gjithashtu 2.2 - Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve*).

Sa i përket **politikës së shëndetit publik**, janë miratuar Strategjia e Sektorit shëndetësor 2014-2020 dhe Ligji për Sigurime Shëndetësore. Janë nxjerrë Udhëzime Administrative mbi të dhënat shëndetësore, profesionistët shëndetësor, licencimin, marketingun dhe trajtimin mjekësor. Është themeluar Oda e Profesionistëve Shëndetësor. Sistemi i Informimit Shëndetësor është zhvilluar edhe më tej. Shpenzimet e shëndetit publik mbeten ndër më të ulëtat në rajon. Kjo pengon zbatimin dhe ekzekutimin e reformave dhe politikave sektoriale. Pagesat me para të gatshme vazhdojnë të pengojnë qasje në kujdesin shëndetësor për të gjithë. Vdekshmëria e fëmijëve mbetet ndër më të lartat në Evropë. Kosova nuk është anëtare e Rrjetit Shëndetësor të Evropës Juglindore.

Legjislacioni mbi *kontrollin e duhanit* zbatohet përmes inspektimeve. Sistemi i *sëmundjeve ngjithëse*, infrastruktura dhe nevoja për raportim duhet të zhvillohen edhe më tej. Përhapja e raportuar e HIV/AIDS mbetet një shqetësim, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme. Në lidhje me *gjakun, indet, qelizat dhe organet*, është miratuar Ligji për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave. *Sa i përket të drejtave të pacientit në kujdesin shëndetësor ndërkuftar*, aktivitetet fillestare duhet të zhvillohen edhe më tej. Në lidhje me *medikamentet*, janë miratuar ndryshimet e Ligjit për Produktet dhe Pajisjet Medicinale. Furnizimi i barnave në nivel sekondar dhe terciar tani është i decentralizuar.

Për *shëndetin mendor*, Instituti i Psikiatrisë Mjeko-ligjore tani është nën Ministrinë e Shëndetësisë. Duhet të përmirësohen shërbimet e shëndetit mendor dhe të kujdesit shëndetësor mendor të bazuara në komunitet që bazohen në udhëzimet e BE-së dhe praktikat më të mira. Në *parandalimin e abuzimit të drogës*, shërbimi i trajtimit të varësisë dhe terapia me metadon ofrohet në pesë spitale dhe dy burgje. Kosova bashkëpunon me Qendrën Evropiane Monitoruese për Drogat dhe Varësinë nga Droga. Fushatat e vaksinimit Shtëpi-për-Shtëpi, trajtimit të kontaminimit nga plumbi dhe fushatat informative janë përdorur për të trajtimin e *pabarazive shëndetësore* për romët, ashkallitë dhe egjiptasit. Sa i përket *të ushqyerit* kujdesi primar dhe kujdesi ndaj nënës dhe fëmijës duhet të zhvillohen edhe më tej. Në *kontrollin e kancerit*, aktivitetet fillestare duhet të zhvillohen më tej. Plani i veprimit për *sëmundjet e rralla 2013-15* duhet të zbatohet edhe më tej.

Në përgjithësi, ka pasur pak progres në fushën e politikave të punësimit, sociale dhe shëndetësore. Përgatitjet janë në fazën e hershme dhe sfidat e punësimit dhe ato sociale mbetën të konsiderueshme. Kosova ka nevojë për zbatimin dhe ekzekutimin e Ligjit të Punës. Kosova duhet të miratojë një strategji sektoriale të punësimit (2014-2020). Zbatimi i legjislacionit të inspektimit duhet të zhvillohet më tej. Sistemi i mbrojtjes sociale është ende i pazhvilluar. Në fushën e shëndetit publik, duhet të miratohet plani i veprimit të sektorit shëndetësor për zbatimin e strategjisë.

4.1.9. *Arsimi dhe hulumtimi*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka përcaktuar prioritetet e politikës së **arsimit** për periudhën 2014-2015 dhe ka plotësuar kornizën ligjore për zbatimin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për të mbështetur procesin e licencimit të mësimdhënësve. Zbatimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe kurrikulës bazë ka vazhduar në vitin 2013 në dhjetë pilot shkollat me qëllim të shtimit të 84 pilot shkollave tjera.

Vetëm 3% e fëmijëve vijnë shërbimet e arsimit parashkollor. Programet e arsimit dhe aftësimit (për nivelin e arsimit para-universitar dhe atij universitar) duhet të përmirësojnë mbështetjen për punën e aplikuar dhe praktike, të plotësojnë praktikat teorike të mësimdhënies dhe të nxënit. Qeveria ka marrë masa për të parandaluar braktisjen e shkollës, duke përfshirë punëtorin me prindërit, nxënësit dhe komunitetin e gjerë, por ende nevojiten përpjekje të mëtejshme. Studentët nga komunitetet pakicë kanë marrë mbështetje financiare.

Megjithatë, fëmijët nga komuniteti romë, ashkali, egjiptas dhe fëmijët me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me qasje të kufizuara në arsim cilësor.

Është bërë pak përparim në zhvillimin e një plani të qartë strategjik për institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Kredencialet e kontestuara akademike kanë çuar në protesta dhe dorëheqje të Rektoratit të Universitetit. Nevojitet një transparencë e përmirësuar e procedurave të rekrutimit të stafit akademik universitar. Përveç kësaj, cilësia e arsimit të lartë dhe ndërlihdja e tij në tregun e punës duhet të përmirësohet në masë të madhe. Saktësia dhe disponueshmëria e të dhënave në sektorin e arsimit mbetet një sfidë serioze.

Qeveria ka miratuar Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP). Sistemi aktual i AAP-së nuk i plotëson siç duhet nevojat e tregut të punës në Kosovë. Është zhvilluar një plan veprimi dhe korniza për sigurimin e cilësisë për monitorimin e cilësisë së shkollave të arsimit dhe aftësimin profesional. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka përcaktuar procedurat për validimin dhe akreditimin e programeve të aftësimin profesional dhe ka bërë përparime në krahasimin dhe përafrimin e kornizës kombëtare të kualifikimeve me kornizën evropiane të kualifikimeve, gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Aftësim të të Rriturve është bërë funksionale për mbështetje teknike gjatë pranverës së vitit 2014.

Si rezultat i marrëveshjes së dialogut për diplomat universitare, të diplomuarit nga universitetet e Kosovës dhe Serbisë mund ti certifikojnë diplomat e tyre të arsimit të lartë në Shoqatën e Universitetit Evropian. Kosova merr pjesë në mënyrë aktive në Platformën e Ballkanit Perëndimor për Arsim dhe Aftësim.

Programi “Rinia në Veprim” ka vazhduar përfshirjen e të rinjve nga Kosova në aktivitete rinore ndërkombëtare si shkëmbime rinore dhe Shërbim Vullnetar Evropian dhe iu ka ofruar punëtorëve rinor mundësi për të bashkëpunuar në kuadër të trajnimit dhe të rrjetit të aktiviteteve.

Kosova ka ndërmarrë veprime të kufizuara në forcimin e kapaciteteve të **hulumtimit dhe inovacionit**. Buxheti mbetet shumë i kufizuar për të krijuar konkurrueshmëri dhe zbatimi vuan nga kufizimet buxhetore ndërsa kapaciteti administrativ duhet të forcohet. Është hartuar një strategji për inovacion, por enda ka mbetur të miratohet. Pjesëmarrja e Kosovës në programin kornizë të BE-së për hulumtim (FP7) ka ngecë. Lidhjet në mes të hulumtimit dhe bizneseve janë shumë të dobëta. Në nëntor të vitit 2013, Kosova organizoi një ngjarje të suksesshme në Prishtinë për Programin e ri të BE-së për hulumtim dhe inovacion "Horizonti 2020", dhe ka shprehur interesim për tu anëtarësuar. Subjektet e hulumtimit dhe inovacionit nga Kosova kanë të drejtë për pjesëmarrje dhe financim si një vend i tretë. Pikat Kombëtare Kontaktuese të listës "Horizont 2020" janë njoftuar, gjë që tregon rritjen e kapaciteteve administrative. Në muajin mars, Kosova mori pjesë edhe në ngjarjen rajonale të lansimit të "Horizont 2020" në Budva (Mali i Zi). Kosova ka qenë aktive në bashkëpunimin në nivel rajonal dhe ka bashkë-nënshkruar Strategjinë Rajonale të Ballkanit Perëndimor R&D për Inovacion, të miratuar në tetor të vitit 2013.

Në përgjithësi, progresi në fushën e arsimit ka qenë i ngadalshëm. Nevojiten më shumë përpjekje për të përmirësuar qasjen në arsim cilësor për grupet e marginalizuara, përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Ndërlihdja me tregun e punës dhe cilësia e arsimit duhet të përmirësohen në masë të madhe. Nevojiten më shumë përpjekje për të forcuar kapacitetin hulumtues dhe të inovacionit në Kosovë përmes rritjes së investimeve në këtë sektor dhe duke marrë masa për të lehtësuar integrimin e Kosovës në Zonën Evropiane të Hulumtimit dhe kontributin e saj në Unionin e Inovacionit.

4.1.10. Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)

Kosova nuk është anëtare e OBT-së dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap formal për anëtarësim në OBT.

4.2. Politikat sektoriale

4.2.1. Industria dhe NVM-të

Sa i përket **politikës industriale** dhe **NVM-ve**, Kosova ka vazhduar thjeshtësimin e legjislacionit të saj. Në janar të vitit 2014, ka hyrë në fuqi Ligji i ri për Investimet e Huaja. Disa aspekte të mjedisit të biznesit janë përmirësuar gjatë viteve të fundit, në veçanti procedurat për krijimin e kompanive të reja. Regjistrimi përmes internetit i kompanive mundësohet në 28 qendra për shërbim të qytetarë. Regjistrimi i plotë i kompanive përmes internetit ende nuk është themeluar.

Duhet ti jetë prioritet zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël. Ky zbatim ende është në një fazë të hershme. Duhet të sigurohet dhe monitorohet zbatimi i strategjisë për zhvillim të sektorit privat (2013-17) dhe planit të veprimit (2013-15).

Konsultimi i komunitetit të biznesit gjatë hartimit të ligjeve, strategjive dhe vlerësimit të ndikimit është thelbësor. Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovës dhe Agjencia për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme është shkruar në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë. Mjedisi i biznesit në Kosovë mbetet sfidues. Pengesat kryesore për zhvillimin dhe rritjen e mëtejshme të NVM-ve janë qasja në financa, zbatimi i dobët i kontratave dhe rregullores së biznesit, konkurrenca dhe gjyqësori i dobët, si dhe ekonomia e madhe jo-formale dhe korrupsioni.

Në përgjithësi, është bërë përparim i kufizuar në politikën industriale dhe të NVM-ve. Për të përmirësuar mjedisin e biznesit, Kosova duhet të përmirësojë kushtet për zbatimin e kontratave, të reduktojë barrierat e panevojshme administrative, të promovojë luftën kundër ekonomisë jo-formale dhe korrupsionit, dhe të zhvillojë një treg financiar. Qeveria duhet të paraqes një vlerësim rregullativ të ndikimit. Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillim të NVM-ve duhet të bazohet në periudha të qarta kohore, zbatimi i të cilave duhet të sigurohet dhe monitorohet.

4.2.2. Bujqësia dhe peshkataria

Sa i përket **politikës bujqësore dhe zhvillimit rural**, qeveria ka vazhduar me skemën e saj të pagesave duke zgjeruar pagesat direkte për disa sektorë të rinj (sektorin e shpezëve, vreshtave dhe materialit fidanor). Vëllimi i pagesave direkte pothuajse është dyfishuar në krahasim me vitin 2012 dhe tani është 12 milion €

Kosova duhet të zbatojë sistematikisht standardet e veta kombëtare minimale që operatorët të përfitojnë nga skemat kombëtare të pagesave. Menaxhimi dhe kontrolli financiar i pagesave direkte dhe masat e zhvillimit rural duhet të forcohen duke përmirësuar dhe përditësuar Regjistrin e Fermave, Regjistrin e Kafshëve dhe Regjistrin e Vreshtave. Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të themelohet urgjentisht në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor.

Ligji i ri për Planifikim Hapësinor ka për qëllim riorganizimin e sistemit të caktimit të zonave urbane. Planet e menaxhimit të tokës rurale duhet të krijohen në nivel komunal. Koordinimi në mes të akterëve të përfshirë në lejet e ndërtimit dhe të zonimit duhet të forcohet për të shmangur ndryshimet e paligjshme të shfrytëzimit të tokës bujqësore. Efikasiteti i konsolidimit të tokës, duke krijuar një treg transparent të tokës, zbatimi i sanksioneve dhe parandalimi i ndërtimeve të paligjshme në tokat bujqësore ende mbeten pengesa për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor. Ka ende dallime mes statistikave të Eurostat-it dhe të Kosovës mbi tregtinë bujqësore. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin e Ligjit për Prodhimin Organik, dhe për krijimin e një autoriteti funksional të kontrollit dhe të një komisioni për prodhimin organik.

Në sektorin pyjor, janë bërë përpjekje për të vendosur sanksione për prerjet e paligjshme. Megjithatë, vëllimi i prerjeve të paligjshme është ende shumë i lartë për menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve. Ende nuk është dakorduar modeli institucional për këtë sektor.

Sa i përket **sigurisë së ushqimit** dhe kontrollit **veterinar**, pakoja e ligjeve (ligji për ushqim, ligji për veterinarin, ligji për inspektim sanitar dhe ligji për blegtori) ende nuk është miratuar. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) megjithatë i ka miratuar procedurat e gjëra standarde të operimit dhe udhëzimet për inspektorët. Zbatimi dhe ekzekutimi i legjislationit ekzistues nuk është sistematik. Plani vjetor i kontrollit është përfunduar dhe miratuar, por plani i kontrollit shumëvjeçar për sëmundjet e kafshëve është ende duke u hartuar.

Kompetencat e inspektimit ende nuk janë transferuar nga komunat tek AUVK-së; kjo më në fund do të bëhet prej 1 janarit të vitit 2015, pas një vonese tre vjeçare. Katër zyra rajonale të AUVK-së tashmë janë funksionale dhe duhet të krijohen edhe dy tjera. Ka pasur zhvillime të kufizuara për përmirësimin dhe sistematizimin e menaxhimit të të dhënave në bazën e të dhënave për identifikimin, lëvizjen, dhe regjistrimin e kafshëve.

Kosova duhet të bëjë regjistrimin e plotë të kafshëve të therura në thertore dhe në ferma, dhe të heqë nga baza e të dhënave të gjitha kafshët e ngordhura.

Dy automjete janë prokuruar për transferimin e mostrave nga kufiri tek laboratorët. Laboratori kryesor i AUVK-së ka përmirësuar kapacitetet teknike dhe ka marrë certifikimin ISO për një seri testesh. Ai është i pajisur mirë, por i mungon buxheti për kontratat e mirëmbajtjes dhe të furnizimit, si dhe për kalibrimin e makinave.

Tregtia e paligjshme, veçanërisht me kafshë nga Serbia, vazhdon të jetë një problem: 90% e kafshëve të vendosura në karantinë pas futjes së paligjshme në Kosovë ishin nga Serbia. BE-ja ka financuar punën përgatitore për të ndërtuar një fabrikë të asgjësimit të nënprodukteve të kafshëve dhe do të financojë ndërtimin e saj gjatë viteve të ardhshme. Kosova e ka siguruar bashkë-financimin dhe tani duhet të sigurojë masat shoqëruese, veçanërisht rrejtin e pikave të grumbullimit. Procesi i përmirësimit të ndërmarrjeve sipas standardeve të BE-së nuk ka filluar ende dhe nuk është miratuar strategjia e përmirësimit (duke përfshirë mbylljen e atyre që nuk janë në përputhje), edhe pse Kosova ka përfunduar vlerësimin e bazuar në rrezik të ndërmarrjeve agro-ushqimore të përpunimit të mishit, qumështit, thertoreve dhe magazinimit të ftohtë në vitin 2012.

Sa i përket **kontrollit fitosanitar**, ligji për mbrojtjen e bimëve është ndryshuar, dhe tani përfshin listën e sëmundjeve bimore që duhet regjistruar. Zbatimi i këtij ligji mbetet një sfidë. Për sa i përket **organizmave të modifikuar gjenetikisht (OMGJ)**, është pezulluar puna në ligjin kornizë. Në sektorin e **peshkatarisë**, shumica e standardeve evropiane nuk vlejné për Kosovën, e cila nuk ka peshkim detar.

Në përgjithësi, Kosova është ende në një fazë të hershme të harmonizimit me *acquis*-in në këto fusha. Kosova ka bërë progres të qëndrueshëm në zhvillimin dhe zgjerimin e skemave të saj të pagesave direkte. Korniza ligjore për sigurinë e ushqimit është kryesisht e vendosur dhe institucionet përkatëse funksionojné mirë, pavarësisht nga mjetet shumë të kufizuara. Duhet ti jepet prioritet themelimit të njësisë së auditimit të brendshëm në agjencinë e pagesave të Kosovës si dhe forcimit të menaxhimit të saj. Kosova duhet të zbatoj rregullat e planifikimit hapësinor dhe ndjek penalisht ndërtimin e paligjshëm në tokën bujqësore. Kosova duhet t'i transferojë kapacitetet e inspektimit veterinar dhe të ushqimit tek AUVK-ja në mënyrë që të ndihmojë sistematizimin dhe futjen e të dhënave të identifikimit, lëvizjes dhe regjistrimit të kafshëve në bazën e të dhënave. Ajo gjithashtu duhet të siguroj buxhetin për mirëmbajtjen, furnizimin dhe kalibrimin e laboratorit kryesor.

4.2.3. Mjedisit dhe ndryshimet klimatike

Sa i përket **mjedisit**, Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit është miratuar në muajin tetor të vitit 2013. Disa udhëzime administrative janë miratuar kohëve të fundit. Zbatimi i legjislationit për trajtimin e sfidave në rritje mjedisore në Kosovë mbetet jo i plotë.

Sa i përket *cilësisë së ajrit*, Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, i cili tani mbulon tërë Kosovën, është e pajisur plotësisht dhe përfshin një laborator të avancuar analitik. Megjithatë, raportet mujore mbi cilësinë e ajrit të cilat i publikon Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) që nga muaji mars i vitit 2014 ofron informata bazike për vetëm 10 vende. Nuk ka regjistër të ndotësve të ajrit dhe ndotja nga burimet kryesore duhet të matet me saktësi (në veçanti nga termocentrali Kosova A). Mungesa e mirëmbajtjes dhe kalibrimit rrezikon saktësinë e monitorimit të cilësisë së ajrit.

Ministria e Mjedisit është duke hartuar një plan kryesor për *menaxhimin e mbeturinave* dhe është duke e shqyrtuar përfshirjen e sektorit privat. Qeveria ka miratuar legjislacionin sekondar për gjendjen e katalogut të mbeturinave dhe kadastrën e ndotësve të mjedisit. Duhet të zhvillohen konceptet dhe përkufizimet themelore të menaxhimit të mbeturinave, përfshirë edhe riciklimin dhe ripërdorimin. Ekzistojnë sfida serioze për zbatimin e ligjit të vitit 2012, pasi që kapacitetet e komunave, operatorëve të mbeturinave dhe deponive si dhe financimi i përgjithshëm për investime është ende shumë i ulët.

Nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për ruajtjen ose trajtimin e mbeturinave të rrezikshme. Prandaj, Kosova i eksporton mbeturinave e rrezikshme ose i përzier ato me mbeturinat e amvisërisë në deponi.

Sa i përket fushës së cilësisë së *ujit*, Kosova nuk ka themeluar ende Autoritetin e Pellgjeve Lumore apo një autoritet të pavarur të menaxhimit të ujit (të paraparë në ligjin e vitit të kaluar). Nevojat për investime në sigurinë e ujit janë të konsiderueshme (humbjet nga rrjedhjet në tuba vlerësohen të jenë rreth 75% të ujit për furnizim). Shërbimet e furnizimit me ujë pengohen nga niveli i ulët i mbledhjes së pagesave. Sistemi i monitorimit të burimeve të ujit është jo i plotë. Kosova nuk ka një sistem të monitorimit të ujërave sipërfaqësore. Shumica e stacioneve të matjes së ujërave sipërfaqësore (disa të siguruara përmes asistencës së BE-së në të kaluarën) nuk janë më funksionale për shkak të vjedhjes dhe vandalizmit të pajisjeve. Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm është përmirësuar për shkak të rritjes së kapacitetit (gjithashtu i financuar nga BE-ja) në Institutin e Shëndetit Publik dhe të një udhëzimi administrativ për monitorimin e parametrave kimik të ujit të pijshëm. Megjithatë, instituti përballet me vështirësi për shkak të financimit të pamjaftueshëm për të vepruar dhe për të ruajtur pajisjet e dhuruara.

Në fushën e *mbrojtjes së natyrës* në vitin e kaluar janë miratuar dy ligje për parqet kombëtare, si dhe udhëzimet administrative dhe dokumentet e planifikimit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka filluar me masat për luftimin e aktiviteteve të ndërtimit të paligjshme në parkun kombëtar të 'Sharrit'. Nuk kanë filluar aktivitetet për themelimin e rrjetit të zonave të mbrojtura "Natyra 2000". Institucionet në këtë fushë mbeten të dobëta në aspektin e numrit dhe aftësive të nëpunësve civilë dhe inspektorëve shtetërorë për mbrojtjen e natyrës.

Udhëzimi i ri administrativ për kadastrin e ndotësve të mjedisit është miratuar në vitin 2013, duke shënuar progres modest në fushën e *ndotjes industriale dhe menaxhimin e rrezikut*. Vetëm një leje është lëshuar, për fabrikën kryesore të çimentos. Është miratuar Ligji për *Kimikate*.

Sa i përket **ndryshimeve klimatike**, ende nuk është miratuar strategjia kornizë për ndryshimet klimatike, që përbëhet nga strategjia e zhvillimit me emetim të ulët dhe nga strategjia e përshtatjes. Sa i përket zhvillimeve legjislative, aktet nënligjore për substancat që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serrë të fluoruara, dhe për informimin e konsumatorit për ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO₂ të makinave të reja të pasagjerëve janë miratuar. Prioritet duhet ti jepet bashkërenditjes me Rregulloren e Mekanizmit Monitorues. Raporti kombëtar mbi gazrat serrë (GS) është në përgatitje e sipër.

Duhet të krijohet një bashkëpunim ndërinstitucional ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të mundësuar miratimin dhe zbatimin e politikave për rritje të ulët të karbonit.

Kapaciteti administrativ në kuadër të sektorëve të mjedisit dhe klimës është i dobët. Kapaciteti i AMMK-së duhet të forcohet për të përmirësuar, ndër të tjera, cilësinë e regjistrimit të GS-ve dhe raporteve. Buxheti i ministrisë mbetet i pamjaftueshëm. Financimi për investime, në veçanti për sistemet e kanalizimit, trajtimit të ujërave të zeza dhe sistemeve për trajtimit dhe asgjësimin e mbeturinave, mbeten jashtë planeve të shpenzimeve të qeverisë. Nuk ka pasur progres në krijimin e një mekanizmi për të financuar projekte mjedisore, në veçanti shpenzimet e veprimit të institucioneve të mjedisit dhe investimet kapitale të monitorimit. Taksa ekologjike që mblidhet gjatë regjistrimit të makinave kontribuon në buxhetin e Kosovës dhe nuk është ndarë për asnjë projekt mjedisor.

Në përgjithësi, Kosova nuk ka përparuar përtej fazës fillestare të harmonizimit me *acquis*-in në këto fusha. Ka pasur pak progres në legjislacionin e ri dhe zbatimin e ligjeve ekzistuese. Mjedisi dhe klima duhet të bëhen prioritetet e qeverisë. Cilësia e raportimit mjedisor duhet të përmirësohet për të informuar më mirë politikatat qeveritare.

Kosova duhet urgjentisht të siguroj financimin e institucioneve monitoruese, në veçanti për të siguruar mirëmbajtjen e rrjeteve ekzistuese monitoruese të ajrit dhe të ujit, dhe për të krijuar një sistem për monitorimin dhe raportimin e GS-ve. Kosova duhet të miratojë një strategji dhe plan të veprimit për klimën, në përputhje me kornizën e pritshme të politikave të BE-së 2030 për klimën dhe energjinë.

4.2.4. *Politika e Transportit*

Sa i përket **rrjeteve të Transportit trans-evropian**, Kosova ka vazhduar të merr pjesë aktive në implementimin e memorandumit të mirëkuptimit të vitit 2004 për Zhvillimin e Rrjetit Qendror të Transportit Rajonal të Evropës Juglindore dhe në Observatorin e transportit të Evropës Jug-Lindore. Kosova duhet të përqendrohet në zhvillimin dhe priorizimin e projekteve në rrugët e përcaktuara në zgjerimin tregues të TEN-T në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Segmentet prej 1 deri 9 të autostradës Morinë-Merdare (Rruga 7) janë përruruar në muajin Nëntor. Financimi për segmentin e fundit deri në Merdare ende nuk është siguruar. Një kontratë prej 600 milion € për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Shkup (Rruga 6) është nënshkruar në muajin korrik. Terminali i ri në Aeroportin e Prishtinës është inauguruar në tetor të vitit 2013.

Buxheti për mirëmbajtjen e rrugëve kombëtare u rrit me 12% në vitin 2014, por ai është ende i pamjaftueshëm për të siguruar mirëmbajtjen rutine dhe periodike. Strategjia aktuale e transportit anon shumë drejt transportit rrugor, duke favorizuar në një mënyrë më pak ambientin, në dëm të hekurudhave. Ka plane për të rritur investimet në infrastrukturën hekurudhore (10 milion € në vit për 2014-16), por kjo është ende nën nivelin e nevojshëm. Strategjia e rishikuar shumë-modale e transportit (2012-21) dhe Plani i veprimit ende nuk janë miratuar.

Sa i përket **transportit rrugor**, strategjia e sigurisë rrugore dhe plani i saj i veprimit duhet të miratohet. Ligji për Sigurinë Rrugore duhet të harmonizohet me *acquis*-in. Kosova ka nevojë ta harmonizoj legjislacionin për qasjen e tregut dhe profesionin e operatorit të transportit rrugor, dhe takografët digjitale. Norma e aksidenteve të trafikut mbetet e lartë, veçanërisht për sa i përket viktimave fëmijë dhe këmbësorëve. Aftësitë e kufizuara të inspektimit, automjete të vjetruara, dhe cilësia e ulët e infrastrukturës jashtë rrugëve kryesore e pengojnë zbatimin e legjislacionit.

Në lidhje me **transportin hekurudhor**, Autoriteti Rregullativ Hekurudhor (ARH) tani është ne funksion por i mungon kapaciteti teknik si dhe pavarësia e nevojshme për procesin e licencimit dhe rregullimit të tregut. Disa anëtarë të bordit të ARH-së ende nuk janë emëruar. Rregullatori ka licencuar operator të ri në muajin mars por ka revokuar licencën për shkak të presionit nga operatorët aktual. Një grup hetuesish për sigurinë dhe aksidentet hekurudhore është caktuar në zyrën e Kryeministrit por kjo nuk është ende funksionale për shkak të mungesës së stafit. Hekurudhat e Kosovës vazhdojnë të jenë të prekura nga një mungesë serioze e burimeve njerëzore dhe financiare.

Në **transportin ajror**, zbatimi i kërkesave të fazës së parë të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit në legjislacionin kombëtar është pothuajse i kompletuar, ku gati të gjitha aktet ligjore mbeten që të transpozohen. Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës nuk është ende pjesë e Vlerësimit të Sigurisë së programit të jashtëm për aviacion. Në muajin mars, Kuvendi miratoi Ligjin për Agjencinë e shërbimeve të navigacionit ajror dhe vendosjen e kriterëve për rekrutimin e anëtarëve të saj. Legjislacioni zbatues duhet të miratohet për të siguruar profesionalizmin e navigacionit ajror dhe shërbimeve të sigurisë. Ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror ende nuk është certifikuar. Sektori i aviacionit në Kosovë vazhdon të vuajë nga kufizimet e imponuara nga Serbia për fluturimet që vijnë e dalin nga Prishtina. Kontrolli i hapësirës ajrore të Kosovës i`u është caktuar “Hungarocontrol”, dhe në prill të vitit 2014 hapësira ajrore është rihapur.

Nuk ka pasur sukses sa i përket transportit **ndër-modal**. Kosova duhet të zhvilloj një transport të balancuar dhe konkurrues ndër-modal miqësorë për mjedisin si dhe një sistem të lëvizshmërisë.

Në përgjithësi, është bërë pak progres në sektorin e transportit. Kosova është ende në një fazë të hershme të harmonizimit me *acquis*. Kosova ende nuk mund t'i bashkohet shumë prej organizatave ndërkombëtare ose evropiane që rregullojnë transportin apo shoqatave të sektorit përkatës. Institucionet rregullative duhet të jenë më të pavarura dhe të forcohen edhe më tej. Përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar sigurinë rrugore janë të nevojshme. Duhet të shtohen përpjekjet për përafrimin me *acquis* e transportit, veçanërisht në transportin rrugor. Vendimi për revokimin e licencës hekurudhore tashmë të dhënë ishte një regres përafrimin e Kosovës me standardet e BE-së sa i përket hekurudhave.

4.2.5. *Energjia*

Sektori i energjisë vazhdon të përballlet me probleme, edhe pse është shënuar progres në këtë drejtim, e sidomos në marrëdhëniet me Serbinë. Stabiliteti i energjisë elektrike është pothuajse konstant dhe ndërprerjet e rrymës tani janë të rralla. Ndihmuar nga një dimër i butë, importet e karburantit/naftës kanë rënë në 11.4% të kërkesave për furnizim. Pas privatizimit të distribucionit dhe furnizimit të energjisë elektrike, të dhënat për inkasimit nuk janë në dispozicion të publikut. As Strategjia e qeverisë për energjinë 2013-22 e as plani shoqëruar i veprimit 2014-16 nuk janë miratuar nga Kuvendi.

Sa i përket **sigurisë së furnizimit**, investimet dhe mirëmbajtja vazhdojnë të përmirësojnë besueshmërinë e sistemit të transimisionit të energjisë dhe të reduktojnë humbjet e transmisionit. Humbjet e rrjetit të distribucionit janë ulur gjithashtu, por ato ende mbeten të larta në gati 31%. Kosova nuk ka kornizë ligjore për të harmonizuar me *acquis* për rezervat e detyrueshme të naftës. Një divizion për rezervat e detyrueshme të naftës është themeluar në kuadër të Departamentit të Rezervave Shtetërore. Rezervat aktuale vlerësohet të korrespondojnë me vetëm katër ditë të konsumit. Në muajin korrik, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka iniciuar një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes kundrejt Kosovës për mbledhjen e taksave doganore për produktet e importuara të naftës. Kosova ka dhënë kontributin e saj në “Stres Testin” e sigurisë së energjisë të kryer nga Komisioni Evropian në kuadër të Strategjisë Evropiane të Sigurisë të Energjisë.

Pas marrëveshjes në dialogun e shtatorit të kaluar mbi energjinë, operatori i sistemit të transmissiionit të Kosovës (OST) KOSTT dhe homologu i tij serb, “Elektromreža Srbije” nënshkruan një marrëveshje kornizë në muajin shkurt. Një marrëveshje inter-OST u nënshkrua më 15 shtator që përfaqëson një hap të rëndësishëm në normalizimin e marrëdhënieve të energjisë mes Kosovës dhe Serbisë.

Sa i përket **tregut të brendshëm të energjisë**, tenderi për një termocentral të ri me linjit ka arritur një pikë kritike, ku thirrja për propozime është publikuar në muajin prill të vitit 2014. Në tetor të vitit 2013, qeveria miratoi një vendim për të çmontuar tre objekte (uzinat për ngrohje, kimikate dhe gazifikim) të termocentralit Kosova A. Përgatitjet për dekomisionim po vuajnë nga vonesa të konsiderueshme. Të tre grupet e punës të TC ‘Kosova A’ nuk e kanë kapacitetin teknik për të përgatitur planet e detajuara. Kosova ka shumë pak gjasa që të përmbush obligimet e veta sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë për të zbatuar Direktivën për impiantet me djegie të lartë dhe nuk e ka përgatitur planin kombëtar për emetim siç kërkohet me këtë direktivë. Në qershor, një shpërthim në laboratorin e hidrogjenit në TC ‘Kosova A’ vrau dy punëtorë. Dy nga tri njësitë janë ende jashtë funksionit, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në një boshllëk të madh të energjisë.

Ndarja e llogarive ndërmjet kategorive të konsumatorëve nuk është zbatuar dhe ndarja ligjore në mes të distribuimit të energjisë elektrike dhe furnizimit publik është ende në pritje. Shumë pak përparim është bërë në hapjen e tregut dhe në mundësimin e konsumatorëve shtëpiak që të zgjedhin furnizuesin e tyre deri më 1 Janar të vitit 2015. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) përfundoi procesin e rishikimit tarifar 2014 në korrik, me një rritje të tarifave të energjisë elektrike prej 4.75%. Një rritje tjetër prej 5.18% për të mbuluar importet e energjisë dhe kostot e riparimit të TC ‘Kosova A’, u futë në përdorim më 1 shtator. Pavarësimi i ZRRrE-së vazhdon të dëmtohet nga intervenimet dhe ndërhyrjet e qeverisë në procesin buxhetor të ZRRrE-së dhe nga dështimi për të emëruar e anëtarëve të bordit të ZRRrE-së. Qeveria nuk ka projektuar një mekanizëm për të mbështetur konsumatorët e cenueshëm.

Korniza ekzistuese e politikave për **energji të ripërtërishme** akoma nuk ka prodhuar rezultate të rëndësishme. Zyra e Rregullatorit ka autorizuar tre projekte të hidrocentraleve me 30 MË dhe një impiant të prodhimit të energjisë nga era me 0.9 MË, asnjë nga të cilat për momentin nuk prodhojnë energji. Procedura të ngarkuara të autorizimit dhe licencimit vazhdojnë të rrezikojnë Kosovën që të arrije objektivin e Komunitetit të Energjisë për të prodhuar 25% të energjisë nga burime të ripërtërishme deri më 2020. Kosova duhet të transponoj direktivën për energjinë e **ripërtërishme** të vitit 2009 dhe të krijoj një mekanizëm për të monitoruar progresin në arritjen e objektivat të saj në vitin 2020. Në muajin nëntor, Kosova ka miratuar një plan kombëtar veprimi për energji të ripërtërishme 2011-20. Nuk ka zhvillime në përmbushjen e kërkesave të BE për përdorimin e bio-karburanteve në transport. Kosova duhet të krijoj një skemë të certifikimit dhe një trup certifikues.

Ligji për **efiçencën e energjisë** duhet rishikuar me qëllim që të përputhet me *acquis* më të fundit të BE-së. Qeveria miratoi një plan afatmesëm të efiçencës së energjisë 2013-15 duke synuar një kursim prej 3%. Zbatimi i direktivës për performancën energjisë në ndërtesa ende mbetet një sfidë për shkak të bashkëpunimit të dobët mbi standardet e ndërtimitarisë në mes të Ministrive të Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ka ende pengesa për financimin e investimeve në efiçencën e energjisë, pavarësisht nga përfshirja e institucioneve financiare ndërkombëtare. Kosova ende nuk e ka themeluar fondin e saj kombëtar për efiçencë të energjisë. Projekti për kombinimin e ngrohjes dhe energjisë në termocentralin Kosova B është duke përparuar. Mungesa e statistikave të efiçencës së energjisë vazhdon të mbetet një pengesë në raportimin e kursimit të energjisë. Ka pas progres në planifikimin komunal për energji efiçente, por kapaciteti lokal ka nevojë për përforsim.

Sa i përket **sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi**, ligji i ri i planifikuar nuk është miratuar. Agjencioni rregullativ ka rritur numrin e personelit. Kapaciteti i tij për licencim dhe

inspektimit mbetet i kufizuar. Nuk ka monitorim të rrezatimit dhe po ashtu nuk ka plan emergjent radiologjik. Kosova nuk ka zgjedhur një vend për të ruajtur mbetjet radioaktive, pavarësisht marrjes së ndihmës së BE-së për këtë çështje.

Në përgjithësi, ka pasur shumë pak progres në procesin e përafrimit dhe Kosova është ende në fazën fillestare të harmonizimit me *acquis* në këtë fushë. Kosova duhet të fillojë zbatimin e *acquis* mbi sigurinë e furnizimit. Kosova duhet të vazhdojë përafrimin dhe zbatimin me *acquis* mbi energjinë elektrike, sigurinë e karburantet, sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi. Ajo duhet të shtojë përpjekjet për të zbatuar planet dhe objektivat e saj mbi efikasitetin e energjisë dhe energjinë e ripërtërishme. Kosova ka nevojë për forcimin e kapaciteteve institucionale në fushën e rregullimit të tregut të energjisë dhe sigurisë bërthamore, në veçanti në ruajtjen e pavarësisë së Rregullatorit të Energjisë dhe krijimin e mekanizmave transparente për të caktuar çmimet e energjisë.

4.2.6. *Shoqëria Informative dhe media*

Sa i përket **Komunikimit elektronik, teknologjive të informacionit dhe komunikimit**, Rregullorja për regjimin e autorizimit të përgjithshëm është aprovuar në muajin prill. Kosova po përparon në shfrytëzimin e kapacitetit shtesë të infrastrukturës ekzistuese të komunikimit të operatorëve të shërbimit publik (hekurudhat, operatorët e energjisë dhe infrastrukturës rrugore) për komunikimet elektronike. Në muajin dhjetor, rregullatori ka lejuar teknologjitë 3G/LTE të vendosen nga operatorët ekzistues dhe operatori aktual ka lajmëruar fillimin e shërbimeve 3G/LTE në shtator dhe 4G në dhjetor. Në fund të vitit 2013, privatizimi i 75% të aksioneve të operatorit aktual, Postes dhe Telekomunikacionit të Kosovës, ka dështuar për shkak të mungesës së miratimit të kontratës nga shumica parlamentare. Shkalla e shtrirjes së telefonisë fikse mbetet më e ulët në rajon dhe ka rënë në 4.16 % gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 (12 % më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013). Shkalla e shtrirjes së sistemit kabllor është rritur diku mbi 8 %.

Ankandi i parë për spektrin frekuencor të qasjes pa kablo (wireless) në brezin e gjerë kishte përfunduar në muajin dhjetor. Kosova po i zbaton marrëveshjet me fqinjët e saj në mënyrë që të harmonizoj frekuencat e radiove në zonat kufitare. Rregullatori vazhdon të merret me ankesa mbi shërbimet e komunikimit elektronik dhe ka vendosur sanksione ekonomike në katër raste. Rregullatori nuk ka parë ndonjë përmirësim në pavarësinë e tij financiare dhe organizative dhe ka përjetuar një shkurtime prej 15 % në buxhet (në përputhje me një vendim të përgjithshëm të qeverisë që të kompenson rritjen e pagave në sektorin publik me shkurtime në të gjitha organizatat buxhetore). Progresi në zbatimin e masave mbrojtëse konkurruese mbetet i ngadalësuar.

Kosova akoma nuk e ka kodin e vet shtetëror dhe vazhdon të përdor tre kode të ndryshme për telefoninë fikse dhe mobile. Marrëveshja e vitit të kaluar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për telekomin e cila parashihte që Kosovës do ti ndahet një kod tre shifror nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (UNT) akoma nuk është zbatuar pasi që Kosova nuk i pranon modalitetet e alokimit të këtij kodi nga UNT-ja .

Sa i përket **shërbimeve të shoqërisë informative**, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit është ende duke u konsoliduar. Qeverisja e Hapur dhe pjesëmarrja qytetare në internet është promovuar përmes projektit "Sot unë Vendosi". Kosova nuk është e aftë të prodhojë statistika kompaktibile me Eurostatin mbi teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Sa i përket **politikave audio-vizuale**, Komisioni i pavarur për media (KPM) nuk ka miratuar strategji për digjitalizim. Mungesa e aktivitetit të KPM-së pjesërisht është shkaktuar nga dështimi i emërimit të anëtarëve të këshillit të saj. Kosova duhet të rrisë përpjekjet për t'u përgatitur për procesin e kalimit në transmetim digjital në vitin 2015, duke përfshirë miratimin e legjislacionit dhe përgatitjet teknike. Pasi që Kosova nuk është anëtare e ITU, frekuencat e saj janë nën autoritetin e Serbisë. Transmetuesi publik, RTK-ja, mbetet e varur nga financimi shtetëror nga buxheti i Kosovës, i cili dëmton pavarësinë editoriale. Kosova

ende nuk e ka gjetur një mënyrë për të siguruar pavarësinë financiare të RTK-së. Bordi i RTK-së tani është i kompletuar edhe pse preferencat politike ishin kriteret kryesore gjatë procesit të zgjedhjes nga Kuvendi.

Në përgjithësi, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të kompletuar kornizën ligjore në këtë fushë. Ajo është ende në një fazë shumë të hershme të harmonizimit me *acquis*-in e shoqërisë informative dhe medie. Organet rregullative duhet të forcohen. Pavarësia dhe kapaciteti i rregullatorëve të telekomit dhe të medias janë sfiduar nga ndërhyrjet politike dhe mungesa e burimeve. Përveç kësaj, Komisioni i Pavarur për Media duhet të tregojë se mund t'i kryejë detyrat e veta. Si një çështje urgjente, Kosova duhet të zbatojë kalimin në transmetimet digjitale dhe të gjej një zgjidhje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik.

4.2.7. *Kontrolli financiar*

Sa i përket **kontrollit të brendshëm financiar publik**, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kosova ka shkrirë dy njësitë Qendrore të Harmonizimit (NJQH) në Ministrinë e Financave, (NJQH për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe NJQH për auditimin e brendshëm) në një njësi. Për të përmirësuar raportimin vjetor mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar, NJQH-ja lëshoi një listë të re kontrolluese mbi vetë-vlerësimin, e cila është përfunduar dhe rikthyer me 58 nga 96 institucione buxhetore në vitin 2013. Në vitin 2014, 60 auditorë të brendshëm janë certifikuar.

Sa i përket **auditimit të jashtëm**, Zyra Kombëtare e Auditimit luan një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e shpenzimeve publike dhe përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe të qeverisjes së mirë. Në Prill, një ligj i ri për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, me qëllim të përmirësimit të pavarësisë funksionale, financiare dhe operationale në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), nuk është miratuar nga Kuvendi, por kthehet për shqyrtim. Ligji do të kishte hapur rrugën për emërimin e një Auditori të ri të Përgjithshëm. Mandati i Auditorit të Përgjithshëm të mëparshëm ka skaduar në gusht.

Në përgjithësi, është arritur progres në zbatimin e kornizës ligjore për kontrollin e brendshëm financiar publik. Përpjekje të konsiderueshme janë ende të nevojshme për zbatimin e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe të auditimit të brendshëm të decentralizuar. Kapaciteti i Njësisë Qendrore të Harmonizimit duhet të forcohet. Kosova duhet të sigurojë miratimin e shpejtë të një ligji në përputhje me INTOSAI për zyrën kombëtare për auditim dhe emërimin e Auditorit të Përgjithshëm. Përgatitjet janë në një fazë të hershme në fushën e kontrollit të brendshëm publik financiar dhe auditimit të jashtëm dhe ende nuk kanë filluar në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së.

4.2.8. *Statistikat*

Sa i përket **infrastrukturës statistikore**, ristrukturimi i agjencisë statistikore është në rrugën e duhur. Në mars të vitit 2014, raporti i planit vjetor 2013 për statistikën është përfunduar, duke deklaruar se plani për vitin 2013 është zbatuar plotësisht, duke përfshirë edhe riorganizimin e agjencisë statistikore. Përveç procedurave të brendshme për matjen e produktivitetit që ishin tashmë në vend, vlerat bazë janë vendosur për kornizën e vlerësimin të performancës për produktivitetin në vitin 2013 dhe vlerave të synuara për vitin 2017. Kjo i mundëson menaxhmentit të vlerësoj progresin. Megjithatë, kapaciteti administrativ dhe burimet financiare të agjencisë statistikore mbeten të dobëta. Kjo parandalon agjencinë shfrytëzoi plotësisht mbështetjen ndërkombëtare në dispozicion dhe të pengon prodhimin e qëndrueshëm të produkteve bazë statistikore, në veçanti të dhënave ekonomike. I gjithë personeli i agjencisë, sidomos rekrutët e rinj, kanë nevojë për trajnime shtesë mbi çështjet e cilësisë dhe mjetet dhe metodave statistikore.

Në lidhje me klasifikimet dhe regjistrat, futja e klasifikimit evropian të aktiviteteve ekonomike NACE Rev 2 në regjistrin e biznesit ka përfunduar. Shkalla dhe cilësia e ri-

kodimit mes NACE 1.1 dhe NACE Rev 2 mbetet që të vlerësohet. Zgjidhja e TI-së për të trajtuar versione të ndryshme të regjistrimit të biznesit duhet të instalohet, së bashku me procedurat për rifreskimin dhe mirëmbajtjen e regjistrimit. Nuk ka personel të mjaftueshëm të për të mbajtur në mënyrë të duhur regjistrin.

Sa i përket **statistikave sektoriale**, regjistrimi bujqësor është shtyrë dy herë, për shkak të zgjedhjeve lokale dhe të përgjithshme. Ky regjistrim është planifikuar të mbahet në nëntor të vitit 2014. Ka pasur progres të kufizuar në statistikat e tjera sektoriale. Më shumë statistika janë publikuar në këtë drejtim. Llogaritë tremujore kombëtare janë prioritet i agjencisë statistikore edhe pse disa nga statistikat primare nuk janë në dispozicion në baza tremujore. Shumë të dhëna nuk janë të disponueshme për publikun e gjerë në format elektronik. Bashkëpunimi me prodhues të tjerë të statistikave zyrtare duhet të përmirësohet për të siguruar qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë.

Në përgjithësi, është bërë progres i paktë në organizimin dhe menaxhimin e brendshëm të agjencisë së statistikave. Në përgjithësi, Kosova është në një fazë të hershme në përafrimin e statistikave të saj me standardet evropiane. Agjencia vazhdon të ketë mungesa të burimeve për të prodhuar statistika të besueshme, në kohë dhe në përputhje me standardet evropiane dhe metodologjitë ndërkombëtare. Prodhimi i të dhënave thelbësore mbi gjendjen ekonomike dhe punësimin mbetet i kufizuar. Pavarësia e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe roli i saj koordinues duhet të përforcohet dhe të sigurohet në ligjin për Statistikat Zyrtare. Disponueshmëria e të dhënave themelore për politikën e bazuar në dëshmi duhet të trajtohet si prioritet dhe të dhënat duhet të reklamohen më mirë dhe shpërndahen për përdorim nga publikun i gjerë dhe investitorët.

4.3. Drejtësia, liria dhe siguria

4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi

Sa i përket politikës së vizave, nga korriku i vitit 2013 deri në korrik të vitit 2014 janë lëshuar gjithsej 1 076 viza, nga të cilat një numër i konsiderueshëm (113) janë lëshuar në njërin nga tetë pikë-kalimet kufitare, ku vizat mund të lëshohen ligjërisht vetëm në rrethana të veçanta. Për arsye reciprociteti, në muajin janar, Kosova ka shtuar Bosnjë dhe Hercegovinën në listën e vendeve që duhet të pajisen me vizë për të hyrë në Kosovë. Kjo masë nuk e ndihmon bashkëpunimin efikas dhe efektiv rajonal.

Kosova lëshon pasaporta biometrike dhe që nga dhjetori edhe letërnjoftime biometrike.

Procesi i dorëzimit të të gjitha kopjeve të certifikuar nga EULEXI të librave të regjistrimit civil (12,391) që ndodheshin në Serbi ka përfunduar në muajin mars. Cilësia e përmirësuar e të dhënave është e rëndësishme duke marrë parasysh përdorimin e tyre të vazhdueshëm (d.m.th. te sigurimi social, listat zgjedhore). Sistemi i Regjistrimit të Gjendjes Civile (SRGJC) i prezantuar në shkurt të vitit 2013 vazhdon të përmirësohet. Certifikatat e gjendjes civile lëshohen kryesisht në bazë të të dhënave që gjenden në SRGJC. Deri në shtator të vitit 2014 të dhënat lidhur me afro 1.3 milion persona janë kontrolluar në njërin nga zyrat komunale të regjistrimit të gjendjes civile. Kopjet e certifikuar që janë kthyer duhet të digjitalizohen dhe vendosen në sistem për të mundësuar verifikimin sistematik të të dhënave të regjistruara për gjendjen civile. Ministria e Punëve të Brendshme ka hartuar legjislacionin për zbatim duke paraqitur një kontroll më të mirë mbi keqpërdorimin e mundshëm me ndryshimin e emrave, dhe ka adoptuar procedurat standarde të operimit për të përmirësuar proceset e regjistrimit të lindjeve, martesave dhe vdekjeve.

Aktakuzat për korrupsion lidhur me kontraktimin e prodhimit të pasaportave biometrike janë ende para gjykatës. Në muajin shkurt, dhjetë persona, përfshirë edhe një anëtar të Kuvendit, janë arrestuar nën akuza për aktivitete kriminale lidhur me lëshimin e vizave në ambasadën italiane në Kosovë. Akuzat janë pasuar me një hetim të përbashkët të Policisë Kufitare të Kosovës dhe EULEX-i nën kujdesin e zyrës speciale të prokurorisë.

Nevojiten më shumë burime në Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) për të siguruar një mbikëqyrje të përmirësuar dhe sistematike, inspektim dhe auditim në vendngjarje. Llogaridhënia e menaxhmentit duhet zbatuar për tu siguruar që gabimet e regjistrimit civil të mos hyjnë në sistem. Komunikimi dhe bashkërendimi ndërmjet nivelit qendror dhe lokal duhet të përmirësohet ndërsa trajnimi për zyrtarët lokal të intensifikohet.

ARC dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës janë në proces të ndërlidhjes të secilit person me një adresë zyrtare. Të gjitha 17 komunat ende duhet të përmbushin obligimin e tyre ligjor për të emëruar rrugët e tyre.

Sa i përket menaxhimit të kufirit, kryesisht legjislacioni bazë duke e përfshirë legjislacionin dytësor, strategjitë dhe planet e veprimit dhe procedurat standarde të operimit tashmë janë vendosur. Plani zhvillimor (periudha 2014-17) për qendrën kombëtare për menaxhim të kufijve është miratuar në muajin prill. Një kurs i përbashkët trajnimi për disa agjenci mbi kodin e etikës në Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK) është mbajtur për punonjësit e pikëkalimeve kufitare. Është themeluar një Njësi i Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve me përfaqësues të të tri autoriteteve të MIK-ut.

Një pako e marrëveshjeve bilaterale dhe protokolleve në fushën e kontrollit kufitar është nënshkruar me Malin e Zi. Të tri marrëveshjet për kontroll të përbashkët kufitar të nënshkruara në vitin 2013 me Shqipërinë tashmë janë duke u zbatuar, ndërsa Qendrat e Përbashkëta të Bashkëpunimit Policor të ngritura në pikat kufitare me Shqipërinë janë tërësisht funksionale. Patrulla të përbashkëta janë bërë me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Të gjashtë PKK-të e MIK me Serbinë janë funksionale. Marrëveshja Teknike për vendndodhjen e tyre të saktë dhe për draft projektimet për ndërtimin e pikëkalimeve të përhershme të MIK është arritur. Pas hyrjes në fuqi më 20 mars 2013 të 'Procedurave për Ndhimë të Ndërsjellë Ligjore' (Aneks i Marrëveshjes për MIK), Kosova ka dërguar rreth 2 000 kërkesa në Serbi ndërsa ka pranuar 1 100 përgjigje. Kosova ka pranuar rreth 180 kërkesa nga Serbia dhe është përgjigjur në rreth 130.

Kontrollet kufitare të vijës së parë nuk bëhen gjithmonë sistematikisht dhe të dhënat biometrike shpesh nuk regjistrohen në sistem, qoftë për shkak të ndërprerjeve të rrymës ose internetit apo për shkak të vëllimit të trafikut. Kështu që Policia e Kosovës deri tani nuk ka arritur të lidhë një kontratë për mirëmbajtje të sistemit të TI-së për menaxhim të kufijve që financohet nga BE-ja, gjë që mund të pengojë kontrollin efektiv të kufijve. Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida në zhvillimin e analizave sistematike të rrezikut për të parandaluar dhe zbuluar në mënyrë efektive aktivitetet e jashtëligjshme kufitare. Duhet të ketë një komunikim më të mirë lidhur me kërkesat për inteligjencë nga niveli qendror në nivel rajonal dhe lokal. Qendra Kombëtare për Menaxhim të Kufijve ende mbetet që të bëhet tërësisht funksionale sipas Planit Zhvillimor. Demarkacioni kufitar me Malin e Zi ende nuk ka përfunduar.

Sa i përket azilit, është miratuar një pjesë e legjislacionit zbatues. Në gjysmën e parë të vitit 2014 ka pasur 50 kërkesa për azil (62 në vitin 2013). Azil-kërkuesit i referohen qendrës së azilit gjatë tërë kohës së procedurës. Ata gëzojnë liri të lëvizjes dhe kanë qasje në të gjitha shërbimet bazike, përfshirë përkujdesjen shëndetësore, ndihmën juridike dhe përkrahjen psiko-sociale. Periudha ndërmjet dorëzimit të aplikacionit dhe vendimit të shkallës së parë është shkurtuar nga mesatarisht dy muaj, që ishte më parë, në vetëm në tri javë. Autoritetet kosovare kanë ofruar mbrojtje shtesë në shkallën e parë për tre persona në vitin 2013 dhe për një person në vitin 2014. Shumica e aplikantëve largohen nga Kosova para se të përfundojë procedura.

Vlerësimet gjatë gjykimeve janë marrë pa prova të mjaftueshme. Duhet bërë më shumë për të identifikuar dhe profilizuar personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe për të ndihmuar dhe identifikuar vendin e origjinës së individëve që nuk kanë dokumente. Duhet siguruar përkthyes dhe duhet shqyrtuar mundësinë e përkthimit nga largësia. Sistemi i ankesave është funksional por procedurat e ankesës janë të gjata. Gjykatësit nuk janë të trajnuar që të merren me raste të ankesës për azil gjë që mund të paraqesë problem në rast të

një fluksi të shtuar të azilkërkuesve.

Ministria e Punëve të Brendshme menaxhon bazën e të dhënave për migrim dhe azil, që tani ekziston, por është vetëm pjesërisht funksionale, pasi që i mungon ndërveprimi me bazat tjera të të dhënave. Ekziston edhe një bazë tjetër e të dhënave për ripranim dhe riintegrim — Sistemi për Menaxhimin e Rasteve të Ri-integrimit. Kosova ka miratuar strategjinë dhe planin e veprimit për **migrim** si dhe profilin e migrimit.

Kosova ka nënshkruar marrëveshje për ri-pranim me 22 vende. Në vitin 2013 Kosova ka ripranuar 5,115 persona si dhe ka pasur 1,630 të kthyer vullnetarë. Deri në korrik të vitit 2014, Kosova ka ripranuar 2174 persona, nga të cilët 1,561 raste ishin kthime të detyruar ndërsa 613 janë kthyer vullnetarisht. Departamenti i avancuar për Ri-integrim të Personave të Riatdhesuar (DRPR) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, vitin 2013 ka rritur numrin e punonjësve të përhershëm në 14, me nëntë pozita shtesë të miratuara. Në vitin 2013, punonjësit e përkohshëm në DRPR ende paguheshin nga fondi për ri-integrim, duke zvogëluar kështu burimet në dispozicion për përkrahje të ri-integrimit. Emërimi i koordinatorëve rajonal ka kontribuar në bashkëpunim më të mirë ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal dhe ka mundësuar një shpërndarje më efektive të përgjegjësive. Rregullorja për ri-integrim ka prezantuar mekanizmat për përsheptimin e rishikimit të kërkesave për ndihmë. Kjo i ka mundësuar fondit të ri-integrimit që të zbatoj projekte afatmesme dhe afatgjata për masa të qëndrueshme (p.sh. arsim dhe punësim) nga palët e treta. Udhëzuesit dhe procedurat standarde të operimit për zbatim të rregullores për ri-integrim janë miratuar në muajin maj. Mbi 95% e fondit prej 3.2 milion € është ndarë ose harxhuar në vitin 2013.

Profilin e migrimit duhet të përfshijë të gjitha të dhënat relevante rreth politikës së migrimit dhe duhet të freskohet rregullisht. Vetëdijesimi për profilin e migrimit si mjet i politikës së migrimit në mesin e zyrtarëve relevant duhet të përmirësohet. Në vitin 2013 ka ndodhur një ngritje e migrimit të parregullt nga Kosova në BE ku numri i qytetarëve të Kosovës që ju është refuzuar hyrja në Vendet Anëtare të BE-së është dyfishuar. Numri i dedikuar të qytetarëve të Kosovës me qëndrim ilegal në Vendet Anëtare është rritur përgjysmë. Numri i kërkesave për azil të paraqitura nga qytetarët e Kosovës është dyfishuar duke arritur numrin 20,215 ndërsa numri i aplikacioneve të refuzuara për ri-pranim është trefishuar (edhe pse nga një bazë e ulët). Kosova duhet të ndërmerr hapa të menjëhershëm dhe efektiv për të trajtuar këto dukuri.

Kosova duhet të ndërmerr hapa proaktiv drejt përmbjlljes së marrëveshjeve për ri-pranim me vendet e origjinës dhe/ose të transitit. Përdorimi i Sistemit për Menaxhimin e Rasteve të Ri-integrimit duhet të zgjerohet për të siguruar përcjelljen e duhur të asistencës së granteve dhe personave në fjalë. Komunitetet në përgjithësi nuk janë proaktive në ofrimin e qasjes në asistencë dhe informata e as në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme. Nevojitet trajnim i mëtejshëm për zyrtarët komunal për kthim. Transparenca e shpërndarjes së fondit për riintegrim duhet të përmirësohet. Më shumë kujdes duhet kushtuar fëmijëve të cilët nuk flasin asnjëherë nga gjuhët lokale. Arsimitimi i përmirësuar i të kthyerve vazhdon të mbetet faktor vendimtar për sigurimin e qëndrueshmërisë së procesit të riintegrimi.

Nuk ekziston një sistem funksional për largim me forcë; personat që gjenden duke qëndruar ilegalisht në Kosovë apo azilkërkuesit e refuzuar mund të kthehen vetëm vullnetarisht. Mungesa e dokumenteve të identifikimit si dhe mungesa e marrëveshjeve për ripranim me vendet e origjinës dhe/ose transitit, janë pengesa për largim të azilkërkuesve të pasuksesshëm.

Në përgjithësi, përparim i mirë është bërë rreth vizave dhe kontrollit kufitar nga Kosova duke përgatitur pjesën më të madhe të legjislacionit dhe duke u përqendruar në zbatimin e tij. Kosova ka avancuar mesatarisht në disa nga këto fusha. Autoritetet kanë demonstruar një përkushtim të qartë politik për të menaxhuar me sukses rrjedhat e migrimit, por nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të trajtuar shtimin e konsiderueshëm të emigrantëve të

parregullt në BE. Kosova duhet të shtojë përpjekjet për të lidhur marrëveshje për ripranim me vendet e origjinës së migruesve dhe/ose të transitit. Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida në zhvillimin e analizës sistematike të rrezikut për të parandaluar dhe zbuluar aktivitetet e jashtëligjshme ndërkufitare në mënyrë efektive.

4.3.2. *Shpëlarja e parave*

Vlerësimi i rrezikut për shpëlarje të parave dhe financim të terrorizmit është miratuar nga qeveria në muajin dhjetor. Për të ndërtuar një mekanizëm gjithëpërfshirës për menaxhim të rrezikut dhe trajtuar rreziqet e identifikuara, qeveria ka hartuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për parandalimin dhe luftën kundër ekonomisë joformale, shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare (2014-18). Për të monitoruar zbatimin e Strategjisë dhe planit të saj të veprimit duhet përgatitur raportet tremujore mbi gjendjen. Raporti i parë mbi gjendjen është hartuar në muajin maj të vitit 2014 dhe ka përfshirë informata relevante dhe statistika lidhur me krimet financiare dhe ekonomike.

Në muajin dhjetor është emëruar Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik. Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF) ka emëruar zyrtarët ndërlidhës në doganat e Kosovës dhe administratat tatimore për të përmirësuar këmbimin e informatave dhe bashkëpunimin operativ ndërmjet zyrave. Në muajin shkurt, Kosova ka paraqitur kërkesën për anëtarësim të saj në Grupin Egmont, me sponsorizim të NJIF-ve nga Finlanda, Senegali dhe Sllovenia. Anëtarësimi i NJIF-it të Kosovës është diskutuar në seancën plenare të Grupit Egmont në qershor, pas një vizite në vendngjarje në muajin prill.

Statistikat e besueshme për shpëlarje të parave mbesin sfiduese për shkak të fragmentimit të tyre. Sipas raportit vjetor 2013 për statistika të harmonizuara (bazuar në mekanizmin gjurmues të zhvilluar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2013), ka pasur gjithsej 56 raste ndaj 207 personave për veprën penale të shpëlarjes së parave në vitin 2013. Janë zgjidhur gjithsej 25 raste ndaj 116 personave. Të dhënat për dënimet përfundimtare, megjithatë, nuk janë në dispozicion.

Në përgjithësi, është bërë një përparim i kufizuar në luftën kundër shpëlarjes së parave. Tani janë vendosur strukturat legjislative dhe operative. Megjithatë, rezultatet në këtë fushë duhet të përmirësohen dukshëm. Kosova ende ka duhet të demonstrojë rezultate të prekshme në luftën kundër krimeve ekonomike dhe financiare.

4.3.3. *Droga*

Kosova vazhdon të ketë bashkëpunim të mirë me EULEX-in, BE-në dhe vendet fqinje dhe angazhohet në mënyrë aktive në operacionet e përbashkëta ndërkombëtare kundër drogave. Policia e Kosovës (PK) ka bashkëpunuar në 21 hetime të përbashkëta ndërkombëtare kundër drogave, 13 raste me EULEX-in dhe pesë me agjencitë tjera të Kosovës. PK-ja po kalon nga qasja e orientuar në konfiskim drejt hetimeve më afatgjata dhe më të hollësishme. Kapacitetet e PK-së për parandalim dhe hetime në përgjithësi konsiderohen si të mjaftueshme.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër narkotikëve (2012 – 2017) është duke vazhduar. Kosova vazhdon të përdoret kryesisht për transit dhe ruajtje të heroinës dhe marijuanës. Numri i hetimeve në vitin 2013 është rritur si dhe ka pasur një rritje të rasteve të posedimit të drogës, por një rënie e konsiderueshme në rastet e konfiskimit të drogës. Kjo është shumë e habitshme pasi që rrugët e trafikimit nuk janë ndërruar ndërsa numri i konfiskimeve të drogës në vendet fqinje është rritur. Kosova ka një shkallë shumë të ulët të konfiskimeve krahasuar me rajonin si tërësi dhe një shkallë relativisht të vogël të dënimeve të hetimet penale të ndërlidhura me drogën.

Nuk ekziston një bazë e të dhënave për shfrytëzuesit e drogës në tërë Kosovën. Rezultatet e anketës së parë të përgjithshme me popullsinë (5 000 të anketuar) tregojnë të dhëna për llojet e drogave të përdorura në Kosovë dhe për shkallën e problemit. Kjo është një bazë e mirë për hartim të politikave më shumë të bazuara në dëshmi për të luftuar përdorimin e drogave. Numri

i rasteve të posedimit të drogës është rritur në 428 në vitin 2013, nga 348 sa ishte në vitin 2012. Një program me metadon është duke u zbatuar në tërë Kosovën; afro 100 veta i janë nënshtruar trajtimit gjatë periudhës së raportimit. Sa i përket parandalimit, PK-ja ka organizuar fushata informuese, përfshirë edhe shpërndarjen e fletushkave dhe bisedat në shkolla.

Raporti Kombëtar për Drogat i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë bashkë me përfaqësuesit e shoqërisë civile është dorëzuar në Qendrën Evropiane Monitoruese për Droga dhe Varësi nga Droga (EMCDDA). Kosova ka intensifikuar bashkëpunimin e saj EMCDDA. Megjithatë, ajo nuk ka një observator funksional për droga apo një pikë kontaktuese kombëtare.

Në përgjithësi, ka pasur një përparim të kufizuar në luftën kundër trafikimit të drogës. Numri i hetimeve është shtuar, por niveli i dënimeve mbetet i ulët. Niveli i konfiskimit të drogave ka rënë dhe është ndër më të ulët në rajon. Viteve të fundit, Kosova ka filluar të merret me sfidat në këtë fushë duke e shtuar kapacitetin e saj në mënyrë të dukshme. Rezultatet deri më tani, kanë qenë të kufizuara sa i përket hetimeve të suksesshme, aktakuzave, e sidomos dënimeve aktuale, në veçanti kur bëhet krahasim me fqinjët. Kosova duhet të bëjë veprime të vendosura për të trajtuar trafikimin e drogave në kufijtë e saj.

4.3.4. Policia

Policia e Kosovës vazhdon të shihet si institucioni më i besueshëm për sundim të ligjit në Kosovë. PK ka zhvilluar strategjinë e saj të parë të trajnimeve (2014-18) duke u përqendruar në fushat si përmirësimi i kapacitetit dhe zhvillimi i ekspertizave të reja dhe avancimi i bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e jashtme ndërkombëtare .

Drejtoria për mbrojtje të dëshmitarëve është themeluar brenda PK-së (13 anëtarë) dhe vazhdon të përkrahet nga BE-ja dhe ekspertët e EULEX-it. Në pajtim me ligjin për mbrojtje të dëshmitarëve, komisioni për mbrojtje të dëshmitarëve që përbëhet nga kryeprokurori i shtetit, drejtuesi i njësitit të hetimeve në PK dhe drejtori i drejtorisë për mbrojtje të dëshmitarëve, është themeluar në shtator të vitit 2013. Kosova duhet të nënshkruajë marrëveshjen për zhvendosjen e dëshmitarëve.

Mbi 800 fëmijë janë intervistuar në shtatë dhomat në dispozicion për intervista të përshtatshme për fëmijët. Departamenti i trajnimit në PK ka shpërndarë udhëzues për intervista të përshtatshme për fëmijët në stacionet dhe zyrat rajonale. Udhëzuesit duhet të integrohen në kurrikulën e trajnimit të akademisë për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Strategjia e komunikimit dhe plani i veprimit (2014-16) i Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës është përgatitur. Dokumentet synojnë të promovojnë punën policore për gratë dhe të merren me sfidat me të cilat gratë ballafaqohen gjatë karrierës së tyre në polici. Policia në komunitet po përdorët në mënyrë më aktive por ka dhënë rezultate të kufizuara.

Bashkëpunimi ndërmjet inspektoratit të pavarur policor (IPK) dhe njësitit disiplinor të PK-së vazhdon të jetë i mirë. Nga shtatori i vitit 2013 deri në korrik të vitit 2014 (IPK) ka shqyrtuar 217 ankesa që kanë rezultuar me 19 arrestime, 57 suspendime dhe nëntë transferime. 165 policë janë shpallur fajtorë duke u bazuar në 120 rastet në të cilat njësi disiplinor i PK ka konstatuar që ekzistojnë shkelje.

Në muajin mars, Kosova ka nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim policor me Malin e Zi, duke e rritur numrin e marrëveshjeve policore me vendet e treta në gjashtë vende. Kosova ka dërguar Zyrtarë Ndërlidhës nga Policia e Kosovës në Austri, Francë dhe Turqi. Në vitin 2013, Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në zbatim të ligjit (ILECU) ka pasur gjithsej 3608 këmbime informatash me vendet tjera në rastet ndërkufitare. Bashkëpunimi Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit duke përfshirë Kosovën vazhdon të pengohet nga dallimet rreth statusit të Kosovës. Nuk ka një marrëveshje operative ose strategjike ndërmjet Kosovës dhe Europol-it. UNMIK-u është pikë formale kontakti me Interpol-in.

Policimi i udhëhequr nga intelijenca mbetet i dobët. Sistemi Informativ i tanishëm i Policisë së Kosovës nuk përfshin informatat e dorëzuara nga zyrtarët e PK-së dhe nuk kontribuon në

analiza efektive që janë thelbësore për policimin e bazuar në inteligjencë për të ekspozuar dhe hetuar krimin e organizuar. Nuk ka kapacitet për të ndërtuar një pamje të përgjithshme strategjike të gjendjes së krimit të organizuar në Kosovë. Një model funksional i inteligjencës (grumbullim efektiv, analizim dhe shpërndarje informatash) do të ndihmonte në krijimin e një pasqyre gjithëpërfshirëse të krimit të organizuar, me hollësi për kërcënimet dhe trendët në rrjetet dhe grupet kriminale.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë përparim dhe është mesatarisht e avancuar në fushën e policimit. Por sfida mbetet paraqitja e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, bashkëpunimit të mëtejshëm me autoritetet tjera për zbatimin e ligjit dhe zbatimin e policimit të bazuar në inteligjencë. Kosova duhet të nënshkruajë një marrëveshje për zhvendosje të dëshmitarëve.

4.3.5. *Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit*

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit kundër **krimit të organizuar** (2012-17) është duke vazhduar. Që nga 15 qershori, Kosova ka marrë përsipër nga EULEX-i udhëheqjen prokurorisë speciale për tu marrë me rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Prokurorët e EULEX-it nuk ndërmarrin më hetime të reja përveç në rrethana të jashtëzakonshme. Si rregull, panelet e kombinuara tani kanë shumicën e gjyqtarëve vendor ku kryeson gjyqtari vendor. PK ka hartuar raportin e saj të parë për lerësimin e kërcënimeve nga krimet serioze dhe të organizuara. Departamenti i PK-së kundër Krimit të Organizuar ka rritur bashkëpunimin dhe operacionet e përbashkëta me agjencitë tjera, përfshirë Policinë Kufitare dhe Doganat e Kosovës.

Një këmbim proaktiv i informatave ndërmjet PK-së dhe agjencive tjera në identifikimin e trendëve dhe profilizimin e trafikantëve të mundshëm duhet sistematizuar. Ligji mbi Përgjimin mbetet për tu miratuar. Kosova as nuk ka bazë të të dhënave për dosjet penale e as sistem të integruar për menaxhimin e rasteve. Mekanizmi gjurmues i themeluar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2013 ka filluar të gjurmohet përparimin në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe harton raporte tremujore.

Sa i përket konfiskimit të pasurisë, kryeprokurori i shtetit ka lëshuar një udhëzim në janar, duke përfshirë një udhëzues të thjeshtësuar për prokurorët që të identifikojnë përfitimet materiale të krimit dhe të kërkojnë konfiskim. Ai gjithashtu ka caktuar pikat kontaktuese të konfiskimit në secilën zyrë të prokurorisë themelore. Mekanizmi gjurmues i zhvilluar nga këshilli prokuroria përfshin edhe bazën e të dhënave e cila regjistron informata si aktivitetet e prokurorit për konfiskim të pasurisë. Në dhjetor të vitit 2013 është themeluar zyra e Koordinatorit Kombëtar për Zbatimin e Ligjit për Krime Ekonomike. Koordinatori i raporton drejtpërdrejt këshillit prokurorial si dhe shërben si përfaqësues i Kosovës në “Camden Asset Recovery Inter-Agency Network”. Nga mesi i vitit 2013, Departamenti i PK-së kundër Krimit të Organizuar ka ndërmarrë veprime për të përmirësuar gjurmimin e pasurive dhe shfrytëzuar hetimet financiare.

Megjithatë, mungesa e konfiskimeve të pasurisë mbetet brengë serioze. Agjencitë për zbatimin e ligjit në Kosovë përkohësisht konfiskojnë pasuritë por këto shumë shpesh nuk rezultojnë me konfiskim të përhershëm. Në vitin 2013 vetëm 33 asete në vlerë prej gjithsej 1.5 milion € janë konfiskuar nëpërmjet vendimit të gjykatës. Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar ka organizuar vetëm shtatë ankande, të cilat kanë gjeneruar diç mbi 32 000 € më pak se në vitin 2012. Numri i konfiskimeve të urdhëruara mbetet i ulët ndërsa prokuroria pak i shfrytëzon urdhrat për ngrirje të pasurisë. Afati prej 72 orësh sipas Kodit të procedurës penale i përcaktuar për urdhrin për ngrirje të pasurisë pengon seriozisht ngrirjen efektive të pasurisë.

Sa i përket trafikimit me qenie njerëzore, koordinatori kundër trafikimit ka filluar një varg organizimesh për vetëdijesim dhe informim publik (‘hapi sytë’). Në vitin 2013, drejtorja e PK-së për hetime të trafikimit me qenie njerëzore ka shpartalluar shtatë grupe kriminele të

përfshira në trafikim me qenie njerëzore. PK ka identifikuar 13 viktime dhe katër viktime potenciale; njëmbëdhjetë viktimave u është ofruar strehim.

Numri i përgjithshëm i vendimeve të gjykatës në rastet e trafikimit me qenie njerëzore mbetet i ulët. Kosova vazhdon të mbetet vend origjine, transiti dhe destinimi të trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual dhe fuqisë punëtore. Trafikimi i fëmijëve dhe shfrytëzimi i fëmijëve për qëllim të lypjes së lëmshës mbetet i lartë. PK mundohet të mos ndërhyjë në rastet e lypjes së lëmshës nga fëmijët. Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, sidomos lidhur me kompensimin për viktimat dhe financimin e qëndrueshëm për strehimoret. Duhet të zhvillohet një qasje gjithëpërfshirëse, shumë-disiplinore e orientuar kah viktimat e trafikimit ndërsa identifikimi i viktimave duhet të përmirësohet edhe më tutje. Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe përpjekjet për të përmirësuar masat e parandalimit efektiv duhet gradualisht të rriten. Duke marrë parasysh këto elemente, Kosova duhet të vlerësojë zbatimin e strategjisë së saj të tanishme dhe planit të veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore (2011-14) para se të miratojë ato të reja. Kurset e trajnimit për gjyqtarët dhe prokurorët që merren me rastet e trafikimit duhet të përmirësohen. Palët e tjera të interesit si policia kufitare apo inspektorët e punës duhet të trajnohen rreth procedurave ekzistuese standarde të operimit.

PK ka një njësi operative që merret me **krimet kibernetike**.

Sa i përket **luftës kundër terrorizmit**, një operacion i madh me angazhim të rreth 1 000 policëve u zhvillua në muajin gusht 2014 kundër 40 individëve që janë raportuar të kenë luftuar me kryengritësit islamik në Siri. Për shkak të rritjes së numrit të luftëtarëve nga Kosova që shkojnë në Siri për tu trajnuar për aktivitete paramilitare, Kosova ka përgatitur një ligj që ndalon qytetarët e saj nga bashkimi në konflikte të armatosura jashtë territorit të saj. Ligji nuk është miratuar në Kuvend për shkak të shpërbërjes së tij në muajin maj. Kosova do të duhet të ngrish kapacitetin e saj për të parandaluar radikalizmin, përfshirë zhvillimin e masave përkatëse për të trajtuar dukurinë e luftëtarëve të huaj. Kosova gjithashtu duhet të përmirësojë bashkëpunimin me vendet fqinje për të luftuar terrorizmin.

Në përgjithësi, është bërë përparim në luftën kundër krimit të organizuar. Kosova është në fazën e hershme të paraqitjes së rezultateve. Sa i përket krimeve financiare dhe ekonomike, agjencitë për zbatimin e ligjit ngurrojnë të fillojnë me hetime financiare; prokurorët nuk janë proaktiv në shfrytëzimin e dispozitave të konfiskimit. Si rezultat, numri i konfiskimeve dhe sequestrimeve të përhershme me urdhër nga gjykata vazhdon të jetë i ulët. Ka mungesë ekspertize në mesin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në fushat e specializuara si krimi financiar dhe mashtrimet në prokurim, që janë thelbësore për të trajtuar korrupsionin në mënyrë adekuate. Frikësimi dhe mbrojtja e dëshmitarëve vazhdon të jetë një brengë serioze. Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit është thelbësor në luftimin e infiltrimit kriminal në sistemin politik, ligjor dhe ekonomik. Autoritetet duhet të tregojnë një qasje ‘zero tolerancë’ në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

4.3.6. *Mbrojtja e të dhënave personale*

Strategjia për mbrojtjen e të dhënave personale 2014-17 është miratuar në muajin janar. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e së Dhënave Personale është funksionale dhe është zhvendosur në një ndërtesë të qeverisë, duke mundur më shumë financim për aktivitetet e saj kryesore. Agjencia ka vazhduar të ngritë vetëdijen për punën e saj dhe mbulimi mediatik i aktiviteteve të saj është përmirësuar dukshëm duke rezultuar me një rritje të ankesave të dorëzuara në Agjenci. Janë themeluar marrëdhëniet e punës me zyrtarët për mbrojtje të të dhënave të emëruar në institucionet e pushtetit qendror. Është zhvilluar sistemi i TI-së për regjistrim, kështu që nuk ka pengesa teknike për të pranuar njoftime nga kontrolluesit e të dhënave rreth dosjeve të të dhënave dhe aktiviteteve të shqyrtuara apo të kryera nga ata. Janë angazhuar tre punonjës shtesë dhe numri i inspektimeve në vendngjarje është shtuar edhe jashtë Prishtinës, që është një zhvillim pozitiv. Qeveria shpesh konsultohet me agjencinë në lidhje me disa draft akte ligjore. Agjencia ka qenë aktive në nivel ndërkombëtar dhe ka

vazhduar të ndërtojë marrëdhënie të ngushta pune me vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ekziston nevoja për të hartuar dispozita të përgjithshme dhe specifike për sigurinë e të dhënave dhe të sigurohet zbatimi i tyre. Në këtë kontekst, mungesa e vazhdueshme e kompetencës së TI-së brenda agjencisë është një çështje që duhet trajtuar shpejtë. Një qasje më proaktive nga agjencia dhe qeveria është e nevojshme për të siguruar emërimin e zyrtarëve për mbrojtje të të dhënave nëpër komuna. Brengat për shfrytëzim të përbashkët të të dhënave, në veçanti në sektorin e zbatimit të ligjit, duhet të trajtohen shpejtë. Konsultimi i agjencisë rreth draft legjislacionit duhet të përmirësohet edhe më tutje për tu siguruar që të gjitha draft aktet ligjore, në veçanti kodet e procedurës, të rishikohen, duke marrë parasysh brengat për mbrojtjen e të dhënave.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë një përparim, por ende është në një fazë të hershme kur është fjala te zbatimi i dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo mbetet një fushë në zhvillim e sipër të ekspertizës në Kosovë. Burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare duhet të sigurohen për agjencinë për mbrojtjen e të dhënave personale që ajo të mund të trajtojë, në mënyrë proaktive, sfidat e reja, në veçanti çështjet e sigurisë së të dhënave dhe të sigurojë zbatimin e masave përkatëse.

SHTOJCA STATISTIKORE

TË DHËNAT STATISTIKORE Kosovë

Të dhënat bazike	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Popullsia (mijëra)	1)	:	2 181	2 208p	1 799b	1 816	:
Sipërfaqja e përgjithshme e vendit (km ²)		10 887	10 887	10 887	10 887	10 887	10 887

Llogaritë kombëtare		2001	2009	2010	2011	2012	2013
Bruto produkti vendor (BPV) (milion €)		1 624	4 070	4 402	4 814	5 059	5 327
BPV (euro për kokë banori)		:	2 329	2 480	2 672	2 799	2 935
BPV (në Standarde të Fuqisë Blerëse (SFB) për kokë banori)		:	:	:	:	:	:
BPV (në Standarde të Fuqisë Blerëse (SFB) për kokë banori), në raport me mesataren e BE (EU-28 = 100)		:	:	:	:	:	:
Rritja reale e BPV-së: ndryshimi nga viti i kaluar i vëllimit të BPV-së (%)		:	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4
Shtimi i vendeve të punës (të dhënat për llogaritë kombëtare), relative me vitin e kaluar (%)		:	:	:	:	:	:
Rritja e produktivitetit të punës: rritja në BPV (çmimet konstante) për person të punësuar, në raport me vitin e kaluar (%)		:	:	:	:	:	:
Rritja e kostos së njësisë së punës, në raport me vitin e kaluar (%)		:	:	:	:	:	:
** Ndryshim 3 vjeçar (T/T-3) në indeksin e rritjes së kostos së njësisë nominale të punës (2005 = 100)		:	:	:	:	:	:
Produktiviteti i punës për person të angazhuar: BPV (në SFB) për person të angazhuar, relative ndaj mesatares së BE-së (EU-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto nga sektorët kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)	2)	:	15.1	17.1	17.5	14.9	:
Industria (%)	2)	:	18.9	17.3	16.6	20.5	:
Ndërtimtaria (%)	2)	:	9.5	10.1	9.9	8.2	:
Shërbimet (%)	2)	:	56.5	55.6	56.1	56.4	:
Shpenzimet e konsumit final, si pjesë e BPV (%)		:	103.7	102.6	103.3	105.2	104.0
Formimi i kapitalit të fiksuar bruto, si pjesë e BPV (%)		:	27.8	29.6	30.7	26.0	24.8
Ndryshimet në inventar, si pjesë e BPV (%)		:	3.4	3.4	3.3	2.9	2.8
Eksporti mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV (%)		:	17.1	19.9	19.6	18.2	17.4
Importi mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV (%)		:	52.0	55.5	56.8	52.4	49.0

Industria	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2010 = 100)		:	:	:	:	:	:

Shkalla e inflacionit dhe çmimet e shtëpive	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Indeksi i çmimeve të konsumit (CPI), ndryshimi në raport me vitin paraprak (%)		:	-2.4	3.5	7.3	2.5	1.8
**Ndryshimi vjetor në indeksin e çmimeve të shtëpive me deflacion (2010 = 100)		:	:	:	:	:	:

Bilanci i pagesave	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Bilanci i pagesave: llogari rrjedhëse gjithsej (milion €)		228	-374	-516	-658	-380	-339
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: bilanci tregtar (milion €)		-646	-1 652	-1 752	-2 059	-2 073	-1 992
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: shërbime neto (milion €)		10	232	187	266	346	308
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: të hyrat neto (milion €)		141	62	67	114	154	122
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: transferet aktuale (milion €)		723	983	982	1 021	1 192	1 222
Nga të cilat qeveria transferon (milion €)		809	323	320	322	402	342

**mesatarja e lëvizjes mbrapa 3 vjeçare të bilancit të llogarisë rrjedhëse, në raport me BPV-në (%)	:	9.1	11.0	11.5s	11.0s	9.2s
**Ndryshim pesëvjeçar në pjesën e eksporteve botërore të mallrave dhe shërbimeve (%)	:	:	:	:	:	:
Investimet e huaja direkte neto brenda vendit (IHD) (milion €)	:	276.9	331.1	378.2	213.3	241.5
Investimet e huaja direkte (FDI) jashtë vendit (milion €)	:	10.5	34.7	15.7	15.8	17.5
nga të cilat IHD e ekonomisë raportuese në 28 vendet e BE-së (milion €)	:	2.3	1.0	0.0	5.2	10.1
Investimet e huaja direkte (FDI) në ekonominë raportuar (milion €)	:	287.4	365.8	393.9	229.1	259.4
nga të cilat IHD e 28 vendeve të BE-së në ekonominë e raportuar (milion €)	:	183.8	217.9	205.3	123.2	118.0
**Pozita e investimeve ndërkombëtare neto, në raport me BPV (%)	:	12.1	10.0	2.8	5.1	:

Financat publike	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Deficiti/suficiti i përgjithshëm i qeverisë, në raport me BPV (%)	:	:	:	:	:	:	:
Borxhi i përgjithshëm qeveritar, bruto në raport me (%)	:	:	:	:	:	:	:

Treguesit financiar

	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Borxhi i jashtëm bruto i tërë ekonomisë, në raport me BPV (%)	:	:	7.6s	7.4s	6.6s	7.9s	:
Bruto borxhi i jashtëm i gjithë ekonomisë, në raport me eksportet totale (%)	:	:	44.5s	37.1s	33.9s	43.5s	:
Furnizimi me para: M1 (kartëmonedhat, monedhat, depozitat brenda nate, milion €)		971	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M2 (M1 plus depozitat me maturitet deri në dy vite, milion €)		1 096	:	:	:	:	:
Furnizimi me para: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion €)		:	:	:	:	:	:
Kredidhënia totale nga institucionet monetare financiare për banorë (e konsoliduar) (milion euro)		26	1 289	1 459	1 698	1 763	1 806
**Ndryshimi vjetor në detyrimet e sektorit financiar (%)	:	:	:	:	:	:	:
**Rrjedha e kredive private, konsoliduar, në raport me BPV (%)	:	:	:	:	:	:	:
**Borxhi privat, konsoliduar, në raport me BPV (%)	:	:	:	:	:	:	:
Shkalla e interesit: shkalla e parasë ditë pas dite, për vit (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e interesit në kredi (një vit), për vit (%)	3)	:	14.08	14.31	13.69	13.78	11.07
Shkalla e interesit në depozita (një vit), për vit (%)	3)	:	3.97	3.38	3.71	3.60	2.39
Shkalla e këmbimit të euros: mesatarja e periudhës - 1 euro = ... monedhë nacionale		1	1	1	1	1	1
Indeksi i shkallës efektive të këmbimit (2005=100)		:	:	:	:	:	:
**ndryshim 3 vjeçar (T/T-3) në indeksin tregtar të kursit efektiv të këmbimit, 42 vende (2005 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e aseteve rezervë (përfshirë arin) (milion euro)		286	501	585	491	760	724

Tregtia e jashtme në mallra

	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Vlera e importit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)		:	1 934	2 158	2 437	2 462	2 422
Vlera e eksportit: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)		:	165	296	306	267	273
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion €)		:	-1 768	-1 862	-2 131	-2 195	-2 149
Mënyrat e tregtisë (indeksi i çmimeve të eksportit / çmimeve të importit * 100) (numri)		:	98	125	97	87	97
Hisja e eksporteve në 28 vendet e BE-së në vlerën e totalit të eksportit		:	44.4	45.5	45.5	41.1	43.5
Hisja e eksporteve në 28 vendet e BE-së në vlerën e totalit të importit (%)		:	42.0	41.0	41.5	42.6	44.8

Demografia	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Shkalla e rritjes së natyrshme (ndryshimi natyral): numri i lindjeve minus vdekjet (në 1 mijë banorë)		:	12.5	:	11.4bp	11.3	:
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave: vdekjet e fëmijëve nën moshën një-vjeçare për 1000 lindje të gjalla		:	9.9	8.8	12.1e	11.4	:
Jetëgjatësia në lindje: meshkuj (vjet)		:	:	:	68.0e	74.1	:
Jetëgjatësia në lindje: femrat (vjet)		:	:	:	71.9e	79.4	:

Tregu i punës

	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Shkalla e veprimtarisë ekonomike për personat 20–64 vjeç: hisja e popullsisë 20–64 vjeç që është ekonomikisht aktive (%)		:	:	:	:	:	:
*Shkalla e punësimit për personat 20–64 vjeç: hisja e popullsisë 20–64 vjeç të punësuar (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e punësimit të meshkujve 20–64 vjeç (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e punësimit të femrave 20–64 vjeç (%)		:	:	:	:	:	:
Shkalla e punësimit të punëtorëve të moshuar (55-64): hisja e popullsisë në moshë 55-64 në punësim (%)		16.7	27.9	:	:	25.8	:
Punësimi sipas sektorëve kryesor							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)		6.2	6.2	:	:	4.6	:
Industria (%)		16.9	15.5	:	:	19.0	:
Ndërtimtaria (%)		8.6	7.9	:	:	9.5	:
Shërbimet (%)		68.3	67.5	:	:	65.0	:
Shkalla e papunësisë: hisja e fuqisë punëtore të papunë (%)		57.1	45.4	:	:	30.9	30.0
Shkalla e papunësisë te meshkujt (%)		51.8	40.7	:	:	28.1	26.9
Shkalla e papunësisë te femrat (%)		69.9	56.4	:	:	40.0	38.8
Shkalla e papunësisë te rinia: hisja e fuqisë punëtore 15–24 vjeç të papunë (%)		80.0	73.0	:	:	55.3	55.9
Shkalla e papunësisë afatgjate: hisja e fuqisë punëtore që ka qenë e papunë për 12 muaj apo më tepër (%)		47.6	37.1	:	:	59.8	68.9

Kohezioni social

	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Mëditjet dhe pagat mesatare nominale (valutë kombëtare)		:	:	:	:	:	:
Indeksi i mëditjeve dhe pagave reale (indeksi mëditjeve dhe pagave nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2000 = 100)		:	:	:	:	:	:
*Braktisja e hershme e shkollës dhe trajnimeve: hisja popullore 18–24 vjeç me më së shumti shkollim të mesëm të ulët që nuk vijojnë më mësim apo trajnime (%)		:	:	:	:	:	:

Standardi i jetesës

	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Numri i automjeteve të udhëtarëve në raport me madhësinë e popullsisë (për një mijë persona)		:	:	90.6p	111.2e	111.3	125.0
Numri i parapaguesve të telefonisë mobile në raport me madhësinë e popullsisë (për një mijë persona)		:	369.2	442.3	543.7	532.5	:

Infrastruktura

	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linjat funksionale për 1000 km ²)		:	30.6	30.3	30.6	30.6	31.0
Gjatësia e autostradave (kilometra)		0	0	0	38	60	80

Inovacionet dhe hulumtimet

	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Shpenzimet publike në arsim në raport me BPV (%)		:	3.6	3.8	4.1	4.0	:
*Bruto shpenzimet vendore për R&D në raport me BPV (%)		:	:	:	:	:	:
Hisja e ekonomive familjare që kanë qasje në internet në shtëpi (%)		:	:	:	57	:	:

Mjedisi	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
* Emetimet e gazrave serrë, ekuivalent me CO2 (1990=100)		:	:	:	:	:	:
Intensiteti i energjisë së ekonomisë (kg nafte ekuivalent për 1000 euro BPV me 2000 çmime konstante)		:	:	:	:	:	:
Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtërishme në % të bruto-konsumit elektrik (%)		:	:	:	:	:	:
Hisja rrugore e transportit të mallrave brenda vendit (% e ton-km) (%)		:	:	:	:	:	:
Energjia	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Prodhimi primar i gjitha produkteve energjetike (mijëra TOE)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi primar i naftës së papërpunuar (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi primar i thëngjillit të fortë dhe linjtit (1,000 TOE)	(4)	:	7 842	7 960	8 212	8 028	8 219
Prodhimi primar i gazit natyror(1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Net importi i të gjitha produkteve energjetike (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Bruto konsumi i energjisë brenda vendit (1,000 TOE)		:	:	:	:	:	:
Gjenerimi elektrik (mijëra GVVh)		:	5.3	5.5	5.7	5.9	6.2
Bujqësia	Shën.	2001	2009	2010	2011	2012	2013
Indeksi i mallrave dhe shërbimeve në vëllimin e prodhimit bujqësor (çmime të prodhuesit) (viti i kaluar = 100)		:	:	:	:	:	:
Sipërfaqja e punuar bujqësore (1,000 ha)		:	262	242e	243e	276	295p
Bagëtia: gjedhe të gjalla (1,000 krerë, fundi i periudhës)		347	344	357e	362e	314	321p
Bagëtia: derra të gjallë (1,000 krerë, fundi i periudhës)		75	51	51e	51e	56	49p
Bagëtia: dele të gjalla dhe dhi të gjalla (1,000 krerë, fundi i periudhës)		230	217	229e	247e	123	160p
Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit në fermë (gjithsej qumësht i papërpunuar) (1,000 tonë)		:	:	:	:	:	:
Të korrat: drithërat (përfshirë orizin) (1,000 tonë)		459	411	431e	435e	442	556p
Të korrat: panxharsheqeri (1,000 tonë)		:	:	:	:	:	:
Të korrat: perimet (1,000 tonë)		169	130	239e	247e	117	185p

: = nuk është në dispozicion

b = ndarje në seri

e = vlerë e përafërt

p = e përkohshme

s = vlerësim i përafërt i Eurostat

* = treguesi Europe 2020

** = Treguesi i Procedurës së Çekuilibrit Makroekonomik (MIP)

Fusnotat:

- 1) 2011: të dhënat bazohen në të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 dhe shifrat e përafërta të cilat Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) i ka për tri komunat veriore të cilat nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë si dhe rritjen natyrore për periudhën 15 prill - 31 dhjetor 2011.
- 2) Bazuar në NACE Rev. 1.1.
- 3) Përfshinë tarifën për disbursim të ngarkuar nga bankat.
- 4) Mijëra tonë.